



Kosovë

Raporti Vjetor 2004

Parimet e Rregullimit Ekonomik
në Kosovë

Prill 2005

Parathënie nga Kryesuesi

Viti 2004 ishte një vit historik për vendosjen e zhvillimeve të ardhshme në Sektorin e Energjisë së Kosovës. Miratimi prej Kuvendit, dhe shpallja pasuese prej PSSP-së, e tre Ligjeve për “Energji”, “Energji Elektrike” dhe “Rregullatorin e Energjisë”, vendosën kornizën për themelimin e një sektori konkurrues dhe të qëndrueshëm të energjisë, i cili garanton sigurinë e furnizimit për të gjithë qytetarët e vet, dhe përforcon ngritjen dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Objektiva të tilla mund të arrihen më së miri me anë të shfrytëzimit optimal të rezervave të rëndësishme të linjitit cilësor që ndodhen në Kosovë. Rregullimi luan një rol të rëndësishëm në zhvillime të tilla, duke lehtësuar strukturën e duhur institucionale dhe organizative që nevojitet të jetë në vend, me qëllim që të tërhiqen investime private masive, të nevojshme për shfrytëzimin e këtyre burimeve natyrore.

Rregullimi Ekonomik është një ndër funksionet më të rëndësishme të shtetit modern. Gjatë dekadës së fundit, edhe Shtetet Anëtare, edhe Komisioni Evropian, kanë përkushtuar përpjekje dhe burime të konsiderueshme në zhvillimin e strukturave të duhura rregullative, e posaçërisht, në Sektorin e Energjisë. Ky proces mund të shihet si pjesë e tre lëvizjeve:

- Modernizimi i administratës publike (“ri-shpikja e qeverisë”);
- Përfundimi i monopoleve (liberalizimi); dhe
- “Evropianizimi” i ekonomive (“treg i vetëm”) dhe harmonizimi i politikave (p.sh., mjedisi, konkurrenca, energjia, burimet e pashtershme, etj.)

Në mënyrë të qartë, rregullimi ka ndikim të rëndësishëm mbi çmimin, cilësinë dhe qasjen ndaj shërbimeve dhe prodhimeve, të siguruara në sektorin e Energjisë si dhe në investimet dhe vendimet menaxhuese, duke ndikuar fuqishëm edhe mbi mirëqenien dhe konkurrencën.

Që nga viti 2002, KE ka filluar përpjekjet për të zgjeruar “Acquis Communautaire” për Energji në Evropën Juglindore. Si pasojë e detyrimeve të veta ndërkombëtare, rrjedhojë e dy Memorandumeve të Mirëkuptimit të “Procesit të Athinës” dhe negociatave të vazhdueshme të Traktatit detyrues sipas ligjit, duke themeluar “Komunitetin e Energjisë së Evropës Juglindore”, UNMIK-u shpalli Ligjin e miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi Rregullatorin e Energjisë, dhe më 30 qershor 2004 themeloi Zyrën e Rregullatorit të Energjisë si një Autoritet të pavarur.

Në vitin e parë të punës të vet, ZRrE-ja është fokusuar në sigurimin e aftësive teknike, ekonomike dhe ligjore që nevojiten për të hartuar dhe menaxhuar sisteme të suksesshme rregullative për industrinë e energjisë. ZRrE-ja është plotësisht e vetëdijshme për sfidat e shumta me të cilat përballlet sektori i energjisë në Kosovë, veçanërisht me pozitën e dobët financiare të ndërmarrjeve komunale, dhe si prioritet i parë është vendosur që të ndihmohen dhe të stabilizohen ato. Përveç këtyre përpjekjeve, ZRrE-ja në vitin 2004 ka ndërmarrë një shqyrtim të hollësishëm të çmimeve në sektorin e Ngrohjes Qendrore dhe ka arritur që të ulë çmimet në një mesatare prej 12%. Me ndihmën e këshilltarëve, pjesa më e madhe e punës, u përqendrua në përgatitjen e artikujve të legjislationit dytësor. Kosova po përfiton nga programet e Donatorëve të ndryshëm ndërkombëtarë dhe një detyrë madhore e ZRrE-së, ishte që të kontribuonte në studime të shumta në sektorin e energjisë, me informacione dhe



komente rregullative. Në kryerjen e të gjitha detyrave të lartpërmendura, personeli i ZRrE-së i rekrutuar kohëve të fundit, gjatë vitit 2004 ka bërë përpjekje të jashtëzakonshme dhe është përsosur duke filluar nga një lakore e rrëpirë e të mësuarit. Dëshiroj të falënderoj kolegët e mi për përpjekjet e tyre të suksesshme, tashmë të komentuara pozitivisht prej palëve të tjera të përfshira, dhe uroj që t'i shohim me vetëbesim sfidat madhore me të cilat përballet ZRrE-ja gjatë 2005-ës.

Nick F. Frydas

Tabela Përmbajtëse

1. Hyrje	11
1.1 Sfondi i Kornizës së Përgjithshme	11
1.2 Rregullimi i Sektorit të Energjisë – Rëndësia e Konkurrencës.....	12
1.3 Procesi i Athinës – Roli i Tregjeve Rajonale.....	15
1.4 Zhvillimi Historik dhe Themelimi Institucional i Sektorit të Energjisë në Kosovë	16
1.5 Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve Kryesore të ZRrE-së në vitin 2004.....	19
2. Themelimi dhe Mandati i ZRrE-së	20
2.1 Korniza Ligjore dhe Rregullative	20
2.2 Mandati i ZRrE-së	21
2.3 Struktura Organizative dhe Personeli i ZRrE-së.....	23
2.4 Shpenzimet dhe Buxheti i ZRrE-së.....	25
2.5 Sistemi i teknologjisë informative (IT), Pajisjet dhe Mjetet e tjera të ZRrE-së	28
2.6 Lista e Projekteve, Aktiviteteve, Ndihma e Donatorëve për ZRrE (2004-2005).....	29
2.7 Sfidat dhe projektet kyçe për ZRrE-në për vitin 2005	32
3. Rregullimi i Sektorit të Energjisë në Kosovë	33
3.1 Përshkrim i shkurtër i Sistemit të Energjisë.....	34
3.2 Përshkrim i shkurtër i Sistemit të Ngrohjes Qendrore.....	38
3.3 Statistikat Kyçe të Sektorit të Energjisë	39
3.4 Bilanci i energjisë dhe planifikimi afatgjatë	45
3.5 Legjislacioni Dytësor Kryesor (Rregulla, Dekrete, Kode) që do të nxirren nga ZRrE-ja	46
3.6 Mbrojtja e të Drejtave të Konsumatorëve – Direktivat Administrative	47
3.7 Metodatat e Rregullimit.....	49
3.8 Linjat-ndërlidhëse dhe Menaxhimi i Kongestionit	62
3.9 Prospektet dhe Çështjet e Sistemeve të Transmetimit dhe Shpërndarjes.....	63
3.10 Linja 400 kW me Shqipërinë.....	65
3.11 Termocentrali i ri për djegien e Linjtit	65
3.12 Prodhimi i fiksuar – Hidro Centralet.....	68
4. Zhvillimet e ardhshme në Sektorin e Energjisë në Kosovë.....	69
4.1 Ndarja e KEK-ut – Themelimi i OST-së.....	69
4.2 Inkorporimi i NP-ve (KEK-u dhe Kompanitë e NQ-së)	70
4.3 Emërimi i Konsumatorëve të Privilegjuar – Hapja e Tregut.....	71
4.4 Perspektivat për Burimet e Energjisë së Ripërtitëshme	72
4.5 Perspektiva e Liberalizimit të Sektorit të Energjisë së Kosovës	73
4.6 Procesi i Athinës	73
4.7 Detyrimet e Palëve Kontraktuese të Traktatit të KEEJL duke përfshirë Kosovën.....	77
4.8 Hartimi i Tregut Standard – Prospektet për Tregun e Energjisë Elektrike të Evropës juglindore (EJL) dhe Pozita e Kosovës në një Treg të tillë.....	78
5. Licencimi	93
6. Ngrohja Qendrore	94
6.1 Statusi Aktual dhe Kërkesat për Zhvillim	94
6.2 Legjislacioni në Përgatitje e Sipër	98
6.3 Shqyrtimi (Përcaktimi) i Çmimit për vitin 2004-2005.....	99
7. Bashkëpunimi Lokal dhe Ndërkombëtar	101
7.1 Bashkëpunimi Lokal	101
7.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar	102

7.3 ZRrE-ja është bërë anëtare Shoqëruese e ERRA-s (Asociacionin e Rregullatorëve Rajonalë të Energjisë).....	102
7.4 Trajnimi i Stafit dhe Udhëtimet Studimore.....	103
8. Raporti Vjetor Financiar i ZRrE-së, Ndarja e Kontributeve nga BKK'04	104

Lista e Figurave dhe Tabelave

Fig. 1.1	Struktura Institucionale që ndikon në Sektorin e Energjisë së Kosovës
Fig. 2.1	Struktura Organizative e ZRRE-së (Statusi me 28 shkurt 2005)
Fig. 2.2	Ndarja e Kontributeve të BE-së për ZRrE (2004)
Fig. 2.3	Shpenzimet e përgjithshme të ZRrE-së (2004)
Fig. 2.4	Ndarja e Kontributeve të Donatorëve në vitin 2004
Tab.2.1	Qëllimet, Treguesit e Arritjeve dhe datat e parashikuara për aktivitetet kryesore të ZRrE-së në vitin 2005
Fig. 3.1	Rritja e Kërkesës për Energji Elektrike (2000 – 2010)
Tab.3.1	Sistemi Tarifor i KEK-ut (Gjendja e 31 Marsit 2005)
Tab.3.2	Karakteristikat Kryesore Teknike të tre (3) Sistemeve të NQ-së
Tab.3.3	Të dhënat e Konsumatorëve për tarifat e NQ-së
Tab.3.4	Kapacitetet kryesore të instaluar për Prodhimin e Energjisë në Kosovë
Fig. 3.2	Energjia e Instaluar me Shumicë
Tab.3.5	Prodhimi i Energjisë Elektrike në vitin 2004
Fig. 3.3	Prodhimi bruto për Njësi
Tab.3.6	Bilanci i Energjisë Elektrike (2004)
Fig. 3.4	Furnizimi me Energji Elektrike
Fig. 3.5	Kërkesa e Energjisë Elektrike
Fig. 3.6	Rënia e Energjisë së Dërguar në Sistemin e Shpërndarjes (SD), 2004
Fig. 3.7	Prodhimi vendor i Energjisë dhe Konsumi për muaj të vitit 2004
Tab.3.8	Të dhënat teknike kyçe për sistemin e Transmetimit (TS) dhe sistemin e Shpërndarjes (SD)
Tab.3.8	Numri i konsumatorëve sipas llojit të kategorisë dhe nivelit të Tensionit të kyçjes
Tab.3.9	Faktorët që Ndikojnë Zbatueshmërinë Financiare të KEK-ut – Faturim dhe Shkalla e inkasimit, humbjet e përgjithshme (2004)
Tab.3.10	Sipërfaqja e Ngrohur, Faturimi dhe Inkasimi i tre sistemeve të NQ-së (2003/2004)
Tab.3.11	Karakteristikat Teknike të (3) Sistemeve të NQ-së
Fig. 3.8	Bilanci i Energjisë: Prodhimi, Konsumi dhe Importi/Eksporti në vitin 2005 (MWh)
Fig. 3.9	Qasja “Ndërtimi i Blloqeve”
Fig. 3.10	Çmimi – Rregullimi i mbuluar
Fig. 3.11	Rrjeti i Transmetimit të Energjisë Elektrike (Qershor 2002)
Fig. 4.1	Institucionet e Komunitetit të Energjisë
Fig. 4.2	Struktura e Tregut të SMD
Fig. 4.3	Struktura e Tregut në Zonën një-çmimore
Fig. 4.4	Ndërlidhjet Ekzistuese dhe ato të ardhshme në Rajon
Fig. 4.5	Modeli Konceptual i Tregut të Rrjetit Grumbullues
Tab.8.1	Gjendja e të Hyrave të ZRrE-së (2004)
Tab.8.2	Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar i Kosovës për vitin 2004 (EUR)

Lista e Shkurtesave

UA	Udhëzim Administrativ (UNMIK)
IA	Instruksion Administrativ (UNMIK)
BMZ	Ministria Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (Bundesministerium für wirtschaftliche Zusammenarbeit und Entwicklung)
TNK (CBT)	Transmetimi Ndër-Kufitar (Cross Border Transmission)
CEER	Këshilli Evropian i Rregullatorëve të Energjisë (Council of European Energy Regulators)
CIDA	Agjencia Ndërkombëtare e Kanadasë për Zhvillim (Canadian International Development Agency)
NjQRr	Njësia Qendrore Rregulative (UNMIK/Shtylla e BE-së)
DANIDA	Agjencia Daneze për Zhvillim (Danish Development Agency)
KD	Konsumator i Drejtpërdrejtë
DFID	Departamenti për Zhvillimin e Jashtëm Ndërkombëtar (Britani e madhe) Department for Foreign International Development (United Kingdom)
NQ	Ngrohje Qendrore
DMM	Departamenti i Minierave dhe Mineraleve (NjQRr)
SD (DS)	Sistemi i Shpërndarjes (Distribution System)
ZPSSP	Zëvendës Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (të KB)
AER	Agjencia Evropiane për Rindërtim
KE (EC)	Komisioni Evropian (European Commission)
ECSEE	Komuniteti i Energjisë për Evropën Jug Lindore (Energy Community in South East Europe)
DE	Divizioni i Energjisë
ZeE	Zyra e Energjisë (NjQRr)
ZRrE	Zyra e Rregullatorit për Energji
ESTAP	Projekti për Asistencë Teknike në Sektorin e Energjisë (BB) (Energy Sector Technical Assistance Project)
BE	Bashkësia Evropiane
BEn	
GTZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Teknik (Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit)
HC	Hidrocentral
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
SPTOT	Sistemi i Pavarur i Transmetimit dhe Operatori i Tregut (Independent Transmission System and Market Operator (ITSMO))
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim (Kreditanstalt für Wiederaufbau)
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
MEF	Ministria për Ekonomi dhe Financa (IPVQ)
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave (IPVQ)
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (IPVQ)

MiM	Memorandumi i Mirëkuptimit
NORAD	Agjencia Norvegjeze për Zhvillim (Norwegian Development Agency)
ZKL	Zyra për Këshillim Ligjor (UNMIK)
ZeKM	Zyra e Kryeministrit
ZeKM/ZeE	ZeE që ka operuar nën ZeKM
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
NP	Ndërmarrje Publike
TC	Termocentral
MSHe	Marrëveshje e Shitblerjes së Energjisë
SE	Spektori i Energjisë
DSHP	Departamenti i Shërbimeve Publike
KRKShP	Komisioni Rregullativ i Kosovës për Shërbime Publike
TRE	Tregu Rajonal për Energji Elektrike
SDC	Zyra Zviceriane për Zhvillim (Swiss Development Co-operation)
SECI	Iniciativat Bashkëpunuese në Evropën Juglindore (Southeast European Cooperative Initiative) (USA)
EJL (SEE)	Evropa Juglindore (South East Europe)
SEEER	South East Europe Energy Regulator (Regullatori i Energjisë për Evropën Juglindore)
SEETEC	Komiteti i Përkrahjes Teknike për Sistemet e Energjisë Elektrike të Evropës Juglindore (Southeast Europe Electrical System Technical Support Committee) (Kanada)
ETSO	Operuesit Evropianë të Sistemeve Transmetues (European Transmission System Operators)
SETSO	Operuesit e Sistemeve Transmetuese të Evropës Juglindore (Southeast Europe Transmission System Operators)
NSh	Ndërmarrje Shoqërore
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (KB)
AT	Asistenca Teknike
DPTI	Departamenti i Përkohshëm për Regëti dhe Industri (UNMIK)
PeP	Përshkrimi i Punës
QPT (TPA)	Qasja e Palës së Tretë (Third Party Access)
TCT	Termocentral Termal
DShP	Departamenti i Shërbimeve Publike (UNMIK)
ST (TS)	Sistemi i Transmetimit (Transmission System)
OST (TSO)	Operues i Sistemit të Transmetimit (Transmission System Operator)
KB	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (United Nations Development Program)
UNOPS	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (United Nations Office of Project Services)
KSKB	Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (United Nations Interim Administration Mission in Kosovo)
BB (WB)	Banka Botërore (World Bank)
TI (IT)	Teknologji Informative (Information Technology)

“Mirëqenia e një populli, si dhe aftësia e tij për të konkurruar, kushtëzohet nga një karakteristikë e vetme e përhapur sociale: niveli qenësor i besimit në shoqëri.”

Francis Fukuyama



ERO Staff

1. Hyrje

Ky raport Vjetor i ZRrE-së është nxjerrë duke u bazuar në detyrimet e Nenit 10 të Ligjit 2004/9 mbi “Rregullatorin e Energjisë “. ZRrE-ja është një Autoritet i Pavarur Rregullativ, sipas paragrafit 11.2 të kornizës kushtetuese, i themeluar më 30 qershor të vitit 2004 sipas Ligjit 2004/9 dhe Rregullores 2004/20. Më shumë se botimin e një raporti vjetor tipik, ZRrE-ja në botimin e saj të parë, merr iniciativën që të paraqesë “status quo”-në e sektorit të energjisë në Kosovë dhe të vendosë parimet mbi të cilat do të rregullohet ai. Nëse nuk deklarohet ndryshe, Raporti Vjetor paraqet situatën dhe informatat në dispozicion, në fund të marsit, 2005.

1.1 Sfondi i Kornizës së Përgjithshme

Themelimi i ZRrE-së ndodhi brenda kornizës më të gjerë të harmonizimit të politikës energjetike në Evropën Juglindore. Vendet dhe juridiksionet pjesëmarrëse angazhohen që të miratojnë “Acquis Communautaire” në energji, konkurrencë, burime të pashtershme dhe në mjedis, një politikë që ka si objektiv themelimin e një Tregu të Integruar për Energji për të gjitha shërbimet dhe prodhimet brenda sektorit të energjisë. Aspirata është që, përmes konkurrencës, ekonomitë lokale do të rrisin efikasitetin dhe konkurrencën e tyre, do të maksimalizojnë shkallën e zgjerimit të tyre, do të arrijnë çmime më të ulëta për konsumatorët dhe mbi të gjitha, do të tërheqin investimet e nevojshme kapitale private.

Në emër të Kosovës, UNMIK-u në prill të vitit 2002, ka nënshkruar Memorandumin e Athinës për Mirëkuptim (MpM) mbi “Tregun Rajonal të Energjisë” (që më pas është quajtur Komuniteti i Energjisë i Evropës Juglindore - KEEJL), dhe versionin e rishikuar në dhjetor të vitit 2003. Me anë të kësaj, Kosova u bë partnere e barabartë dhe pjesëmarrëse në themelimin e KEEJL-së, gjë që është e një rëndësie parësore për zhvillimin e saj ekonomik, për shkak të rezervave favorizuese të saj të linjitit dhe pozitës ideale të Kosovës për shkëmbim të energjisë në rajonin e EKL. Kosova angazhohet që të bëhet eksportuese e energjisë pas vitit 2010 dhe që të forcojë edhe më shumë rolin e saj qendror në lehtësimin e qarkullimit të energjisë në rajonin e EKL-së.

UNMIK-u planifikon të nënshkruajë në emër të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ) të Kosovës, Traktatin që e detyron ligjërisht për të krijuar Komunitetin e Energjisë. Një ndër detyrimet pasuese të Palëve Kontraktuese të Traktatit (mes të tjerash), është zbatimi i “Acquis Communautaire” mbi energjinë, që detyron në mënyrë të veçantë zbatimin e Direktivave të KE-së nr: 2003/54 dhe 2003/55, dhe Rregulloreve të KE-së nr: 1228/2003 brenda gjashtë muajsh prej hyrjes në fuqi të Traktatit.

Si pasojë e këtyre detyrimeve, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP), më 30 qershor 2004, nxori Rregulloren nr: 2004/20, e cila themelon një Autoritet të Pavarur Rregullativ – ZRrE-në, në bazë të, dhe në përputhje me Nenet 23 dhe 25 të Direktivave të KE-së nr: 2003/54 dhe 2003/55.

ZRrE-ja është themeluar si një autoritet i pavarur, tërësisht i pavarur nga çdo Departament Qeveritar, që të ushtrojë rregullimin ekonomik në sektorin e energjisë (Energji Elektrike, Ngrohje Qendrore dhe Gaz Natyror), përmes lëshimit dhe monitorimit të licencave për aktivitetet e energjisë, dhënies së lejeve për ndërtimin e objekteve të reja të energjisë, aprovimit të metodologjive të çmimeve dhe tarifave për aktivitetet që nuk i nënshtrohen tregut, nxjerrjes së legjislacionit dytësor që rregullon sektorin, monitorimit të ndarjes efektive dhe zhvillimit të konkurrencës në sektorin e energjisë, dhe përmes zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Mandati i ZRrE-së nuk është këshillimor, por ekzekutiv, me autoritet të fortë dhe pavarësi të plotë në të gjitha çështjet e mësipërme.

1.2 Rregullimi i Sektorit të Energjisë – Rëndësia e Konkurrencës

Energjia është e një rëndësie supreme për çdo ekonomi kombëtare, pasi ajo është faktori themelor i kostos së prodhimit për shumë ndërmarrje dhe shërbime publike të domosdoshëm për mirëqenien e gjithë konsumatorëve. Energjia është e lidhur me sektorë që i shkaktojnë ekonomisë shpenzime të jashtme, si p.sh: siguria e ambientit, por edhe ajo gjeo-politike e çdo vendi. Për këto arsye, edhe legjislacioni Evropian për energji, edhe ai Kosovar, vendosin si objektiva primare:

- Sigurinë e Furnizimit;
- Mbrojtjen e Mjedisit;
- Zhvillimin e balancuar dhe të qëndrueshëm ekonomik;
- Prodhueshmërinë dhe konkurrencën e ekonomisë, dhe themelimin gradual të tregut konkurrues me uljen e kostos së energjisë për konsumatorët si objektiv.

Energjia është një sektor i intensitetit të lartë kapital dhe i planifikimit afatgjatë për ndërtim të infrastrukturës dhe objekteve të nevojshme. Cilësia e shërbimeve, mbrojtja e mjedisit, por gjithashtu në afat të gjatë, edhe formimi i çmimeve të energjisë, varen prej investimeve të përshtatshme në sektor. Një pjesë e infrastrukturës, kryesisht rrjetet e energjisë, kanë për synim sigurimin e “shërbime publike” të përbashkëta për të gjithë konsumatorët, mbi baza jo-diskriminuese (parimi i Qasjes së Palës së Tretë – QPT). Sektorë të tjerë, si prodhimi me shumicë dhe furnizimi me shumicë ose pakicë, duhet të jenë të hapur ndaj konkurrencës së lirë. Bashkë-ekzistenca e aktiviteteve të menduara si “monopole natyrore”, dhe aktivitetet e hapura ndaj konkurrencës, në kombinim me kërkesat e larta teknike që nevojiten për funksionimin e sektorit për të garantuar siguri të vazhdueshme të furnizimit, justifikojnë kompleksitetin e lartë të strukturës dhe institucioneve që rregullojnë sektorin e energjisë.

Siç është përmendur më sipër, në njërin anë faktorët e jashtëm, shpenzimet dhe çështjet strategjike të lidhura me energjinë, dhe në anën tjetër bashkë-ekzistenca e aktiviteteve të menduara si “monopole natyrore” (rrjetet) dhe aktivitetet e hapura për konkurrencë (prodhim dhe furnizim), apelojnë për “rregullim administrativ” të sektorit. Arsyet e lartpërmendura shpjegojnë edhe arsyen pse ky rregullim tradicionalisht ka qenë gjithmonë rregullim parandalues “ex-ante”, dhe jo kontroll “ex-post” dhe auditim si në aktivitetet e tjera ekonomike. Disa skema administrative janë zhvilluar për t’u marrë me problemet e lartpërmendura, megjithatë ndarja e roleve mes Qeverisë (strategjia dhe politika e energjisë) dhe rregullimi i sektorit nga një Autoritet i pavarur, përbëjnë atë që sot është normë në më shumë se 70 vende në mbarë botën.

Koncepti i heqjes së të drejtave ekskluzive të ndërmarrjeve publike monopolizuese të integruara vertikalisht, dhe futja e konkurrencës në sektorin e energjisë, ka filluar të pushtojë mendjet e krijuesve të politikave të BE-së dhe Shteteve të Bashkuara, që prej vitit 1980. Kjo është paraprirë nga një periudhë e gjatë pjekurie si në të arriturat teknike, edhe në kapitalizimin e sektorit të energjisë elektrike, periudhë në të cilën industria dëshmoi fillimin e ligjit të “zvogëlimit të kthimit të të ardhurave”. Për shumë vjet, sektori i energjisë në shumicën e vendeve të industrializuara, është karakterizuar me zgjerimin e elektrifikimit me kërkesë të rritur, gjë që ka justifikuar një strukturë monopolizuese, ku çmimet mesatare të rregulluara janë mbajtur mbi kostot anësore, dhe bazuar në ekonomitë e shkallëzimit dhe mundësisë, arriti uljen e vazhdueshme të çmimeve. Një gjendje e tillë e lumtur e tregtisë, zgjati deri në vitet 1970 dhe 1980, kur ndikimet direkte dhe indirekte të krizave të naftës, destabilizuan të gjithë strukturën. Këtyre ngjarjeve u duhen shtuar shqetësimet sociale në rritje, rreth ndikimit në mjedis të centraleve qendrore të mëdhenj elektrikë, të cilët detyruan shumë ndërmarrje që të brendësojnë shpenzimet e jashtme të zvogëlimit të ndikimit mjedisor. Akumulimi i kapitalit të investuar dhe madhësia e aktiviteteve, kanë shtyrë

shumë ndërmarrje monopoliste të përballen me një situatë ku shkalla e rritjes së shpenzimeve anësore të elektricitetit, e tejkaloi shumë shkallën e rritjes të çmimeve mesatare të lejuar nga rregullatorët ose qeveritë për t'u tatuar, duke e lënë të pambrojtur strategjinë e biznesit të monopolit klasik të përhapjes dhe rritjes.

Gradualisht është shfaqur një strategji e re për ndërmarrjet e energjisë elektrike, bazuar në hamendjet që ekonomitë e shkallëzuara nuk ishin më të rëndësishme për centralet qendrore të energjisë. Paradigma e re është bazuar në alternativat e prodhimit dhe furnizimit në sasi të vogël, që ndodhen në pronësi të pavarur.

Ky model e zhvendos rrezikun vendimeve të investimeve nga konsumatorët (nën një monopol të rregulluar), tek prodhuesit e pavarur. Deri në vitet 1980 është bërë e qartë që me qëllim që të arrihet efikasitet më i lartë dhe përmirësim i cilësive të shërbimeve, ka qenë e nevojshme që të paraqitet konkurrenca në sektor një koncept është përshpejtuar gjatë viteve 90', për shkak të faktit se konkurrenca ishte baza për krijimin e një Tregut të vetëm Evropian. Konkurrenca i inkurajon firmat që të vlerësojnë me më efikasitet çdo shërbim të prodhuar. Në veçanti, nëse shpenzimet e përgjithshme apo ato fikse duhet të mbulohen, është e dëshirueshme që ato të mbulohen në mënyrë jo-proporcionale me shërbimet për të cilat kërkesa është relativisht e pandikuar prej çmimit. Firmat që veprojnë në tregje konkurruese, i vendosin çmimet në këtë mënyrë, pasi kjo ka për qëllim maksimalizimin e përfitimeve të tyre. Paraqitja e suksesshme e konkurrencës do të çojë në një industri më efikase. Prodhuesit do të përdorin më mirë centralet e tyre me qëllim që të ruajnë ose zgjerojnë numrin e klientëve që mund të mbulojnë. Rregullimi efektiv i shërbimeve të rrjeteve të ndara, gjithashtu do të inkurajojë edhe uljen e çmimeve. Furnizuesit do të ndërveprojnë me më efikasitet me klientët dhe do të ofrojnë shkallë më të gjerë të shërbimeve dhe marrëveshjeve kontraktuese. Për këtë arsye, për një afat të gjatë, një shkallë e mjaftueshme e konkurrencës, do të bëjë që çmimet të jenë mesatarisht, më të ulët se sa do të ishin në një treg të rregulluar. Një monopol i rregulluar do të vendoste çmime më të larta, dhe kjo do të ulte mirëqenien e konsumatorëve.

Karakteristikat unike të sektorit të energjisë, kryesisht domosdoshmëria e vazhdimsisë së sigurisë së furnizimit, mbrojtja e mjedisit, koncepti i përbashkët i "transportuesit" të rrjeteve të energjisë dhe detyrimet e shërbimeve publike, kanë kërkuar vendosjen e një kornize specifike rregullative në të cilën mund të veprojnë konkurrenca dhe ndërmarrjet private. Kjo kornizë është finalizuar nga Direktivat e Komisionit Evropian për Energji Elektrike dhe Gaz (2003/54 – 2003/55) dhe Rregullorja Evropiane për qasje dhe përdorim të rrjeteve ndërlidhëse dhe tregtisë ndërkufitare (1228/03), të cilat janë në fuqi tani.

Në shumë vende të Evropës faza tranzicionale nga struktura monopoliste e sektorit në kushtet e konkurrencës së hapur dhe të lirë, ka dëshmuar një proces të ngadalshëm dhe të dhimbshëm. Ky problem ka qenë më akut në rastet e ndërmarrjeve publike të integruara vertikalisht. Me qëllim që të lehtësohen hyrjet e reja në treg, disa vende kanë prezantuar masat e përkrahjes aktive dhe asimetrike të konkurrencës. Në çdo rast, tranzicioni është proces dinamik që kërkon masa të vazhdueshme të matura mirë dhe varet kryesisht nga iniciativa legjislative. Padyshim se ka pasur shumë probleme gjatë tranzicionit për të hyrë një mjedis konkurrues, i cili zakonisht mund të lidhet me kushtet e zbatimit të papërshtatshëm të strukturës së liberalizuar ose gabimeve në adoptimin e mekanizmave tranzitorë. Në shumë raste, problemet ishin të lidhur, ose, si rezultat i drejtpërdrejtë i monitorimit të papërshtatshëm të konkurrencës në treg, fakt ky që lejoi ekzistencën e pushtetit të tregut (dhe abuzimit të tij) nga ndërmarrjet përgjegjëse.

Pas më shumë se 10 vjet përvojë me hapjen e sektorit të energjisë ndaj konkurrencës, shumë vende tani kanë prezantuar një kornizë pak a shumë të ngjashme rregullative për një treg të liberalizuar energjie, që përbëhet nga:

- Një autoritet i pavarur Rregullativ me një mandat minimal monitorimi dhe promovimi të zhvillimit dhe veprimit të tregut, aprovimin e çmimeve për aktivitetet jashtë tregut, lëshimin e urdhërave, rregullave dhe masave për qasjen jo diskriminuese të palëve të treta në rrjetet e energjisë;
- Një Veprues i Pavarur i Sistemit të Transmetimit për rrjetet elektrike ose tubacioneve të gazit, i cili gjithashtu merr kohën e vërtet të veprimit të Tregut të balancuar, si dhe Operuesi i Marrëveshjeve të Tregut ku që të dy (mund të jenë një subjekt) kanë karakter monopolizues dhe i nënshtrohen kontrollit të rregullatorit. Për shkak të “kostove në nivel” shumë të larta që kërkojnë, shërbimet e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, ngrohjes dhe/ose gazit) merren si “monopole natyrore” (për shkak të ekonomive të shkallës dhe qëllimit, dhe dis-ekonomive të dyfishimit) dhe për këtë arsye në mungesë të konkurrencës i nënshtrohen kontrollit të çmimeve të rregulluar;
- Tregjet Konkurruese në Prodhimin me shumicë dhe në Furnizim;
- Tregjet e Organizuara Financiare për Energji, të cilat paralelisht veprojnë me tregjet e kontratave dypalëshe dhe që kontribuojnë në menaxhimin e rreziqeve financiare për shkak të rrezikut të paqëndrueshmërisë të lartë të çmimeve të energjisë;

Në anën tjetër, paraqitja e konkurrencës, nuk nënkupton çrregullimin e plotë të furnizimit të energjisë ose një qëndrim plotësisht “jo-ndërhyrës” ndaj rezultateve të tregut në lidhje me çmimet dhe shërbimet për konsumatorët. Në fakt, Direktivat e BE-së kërkojnë monitorim nga afër të tregut dhe mundësinë për të paraqitur një numër të detyrimeve kryesore në kompanitë e energjisë (“detyrimet e shërbimeve publike”), në lidhje me shërbimet publike. Këto detyrime mund të përfshijnë “shërbime universale” (e drejta e të gjithë konsumatorëve për t’u lidhur dhe furnizuar) mbrojtja e konsumatorëve në nevojë, mbrojtja e konsumatorëve të fundit (transparenca e kushteve kontraktuese dhe qasje e garantuar për të kundërshtuar marrëveshjet), etj. Këto përkujdesje janë veçanërisht të rëndësishme gjatë periudhës së tranzicionit nga një monopol plotësisht i rregulluar, në një situatë ku tregu vendos tiparet e rëndësishme, siç janë çmimi dhe vendimet për investime. Roli i Autoritetit Rregullativ të pavarur është shumë i rëndësishëm në përkthimin e detyrimeve të shërbimeve publike, të vendosura prej Qeverisë në politikën e tregut dhe në aprovimin e nivelit të duhur të kompensimit për zbatimin e saj.

A përfiton Kosova nga zhvillimi i liberalizimit dhe paraqitjes së konkurrencës? Kësaj pyetjeje më mirë mund t’i përgjigjen pikëpamjet e objektivave strategjike të Qeverisë, siç është shprehur në Letrën e Bardhë të vitit 2003:

- Energjia është identifikuar si punëdhënësi më i rëndësishëm industrial dhe mbështetësi më shpresëdhënës i zhvillimit të menjëhershëm ekonomik;
- Për shkak të rrethanave historike dhe konfliktit, ekziston një gjendje shumë e varfër e objekteve dhe infrastrukturës të energjisë, e cila jo vetëm që kërkon sasi të qëndrueshme të kapitalit për rehabilitim, por gjithashtu nga pikëpamja e sigurisë së furnizimit, është bërë urgjente ndërtimi i kapaciteteve të reja të prodhimit dhe shpërndarjes. Financimi publik si dhe vlerësimi i kreditit të ndërmarrjes (KEK), nuk janë në pozitë që të ngrenë kërkesa të tilla kapitale, për këtë arsye është nevojë e qartë që të bëhet thithja e investimeve kapitale private;
- Kosova duhet të jetë e vetëmjaftueshme në prodhimin e energjisë elektrike dhe të ngrohjes, dhe Kosova duhet të bëhet një eksportues i rëndësishëm në Tregun Rajonal duke pasur si prioritet shfrytëzimin e rezervave të pasura të linjitit, si lëndë djegëse me shpenzim të ulët;

- Rritja e konkurrencës dhe e efikasitetit të ekonomisë kombëtare dhe themelimi i një konkurrence të shëndoshë, si parakusht për uljen e çmimeve të energjisë për të gjithë konsumatorët.

Parakushti kryesorë për tërheqjen e kapitalit privat, është ekzistimi i kornizës transparente rregullative, që i lejon një operuesi efikas që të marrë të ardhura të kënaqshme nga investimet të tij. Kështu, duhet të ekzistojë një konkurrencë e vërtetë dhe jo diskriminuese, kujdestar i së cilës bëhet Autoriteti i pavarur Rregullativ, meqë Qeveria për shkak të pozitës si pronare e pasurisë publike, nuk mund të veprojë si Rregullator i kësaj industrie. Edhe në rastin e pronësisë jo-publike të ndërmarrjes, autoritetet e pavarura rregullative, kanë përparësi mbi departamentet ministrore, për shkak se ofrojnë një nivel më të mirë të vazhdimësisë së politikës, kombinojnë me sukses një shkallë të gjerë kombinimesh, ata mund të gjykojnë të lirë nga ndikimet politike, dhe mund të zhvillojnë nivele të larta të ekspertizave speciale.

Në vitin 2002, EBRD-ja ka anketuar investuesit privatë të sektorit të energjisë. Investuesit thanë që katër prej pesë faktorëve që çojnë në investime të pakënaqshme, janë të lidhur me mungesën e paanshmërisë dhe angazhimit në sistemit të ri rregullativ.

Brenda kornizës së globalizimit të sotëm të ekonomisë dhe lëvizjes së lirë të kapitalit, tërheqja e investimeve të kapitalit privat është një sferë e konkurrencës së intensifikuar ndërkombëtare në mes të vendeve. Liberalizimi i Tregut të Energjisë dhe integrimi në tregjet më të gjera rajonale (si EJR), konsiderohen si parakushte të nevojshme, të cilët do të tërheqin investuesit privatë dhe institucionet financiare të ngjashme. Vazhdimësia e politikave që veprojnë në mënyrë mbrojtëse për ndërmarrjet monopolizuese të energjisë, përforcon besimin se liberalizimi i tregut nuk është bërë në kushte të njëjta për anëtarët e rinj që veprojnë si drejtues për investimet private, me pasojë humbjen e përparësisë konkurruese të tyre. Një situatë e tillë është vëzhguar në disa raste, ku investuesit privatë kanë hezituuar të hyjnë në sektor, për shkak të mbrojtjes së tepruar të ndërmarrjeve monopolizuese, e që si pasojë kanë ulur zhvillimin ekonomik dhe sigurinë e furnizimit. Vendet që kanë përqafuar me entuziazëm politikën e liberalizimit, kanë pasur sukses në thithjen e investimeve private dhe gjithashtu kanë përmirësuar efikasitetin e ndërmarrjeve funksionuese, të cilat tani i janë ekspozuar konkurrencës. Rezultati pozitiv në shumicën e rasteve të deritanishme, përveç disa dështimeve të famshme (Kalifornia), përkrahin parashikimin për arritjen e efikasiteteve më të larta ekonomike në sektorin e energjisë. Është dëshmuar se paraqitja e konkurrencës mund të çojë në çmime më të ultë, zgjerimin e zgjedhjes dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit për konsumatorët e energjisë. Rezultatet e para të vendimit për të hapur tregun për konkurrencë në Evropë, ishin pozitive. Nga fundi i vitit 2003, çmimet e energjisë elektrike për shfrytëzuesit industrialë mbetën 15% më të ultë se në vitin 1995. Kjo shifër përfshin rritjet e fundit të tregut me shumicë të lidhura me çmime më të larta të thëngjillit dhe vajit si dhe të shpenzimeve të mbështetjes (subvencionimit) për energjinë e ripërtëritshme.

Si përfundim, si në sferat e investimeve dhe konkurrencës së ekonomisë në Kosovë, ashtu edhe në integrimin në tregun më të gjerë rajonal, roli i liberalizimit të tregut të energjisë është shumë themelor duke ditur se pa të, do të ishte vështirë të thithen investimet e kapitalit privat.

Një Autoritet i pavarur Rregullativ i cili vendos kornizë korrekte “ex-ante” dhe ka liri të veprimit nga ndikimet politike, vepron si “Garantues Institucional” që ofron besimin e kërkuar në tregjet financiare për të financuar investimet e nevojshme të infrastrukturës.

1.3 Procesi i Athinës – Roli i Tregjeve Rajonale

Siç u përmend më lart, ekzistimi i fuqisë së tregut (dhe abuzimi i tij) nga ndërmarrjet funksionuese ose pozitë sunduese të furnizuesve tradicionalë, mund të përbëjë një pengesë

madhore për hyrjen në treg të pjesëmarrësve të rinj dhe zhvillimin e konkurrencës. Mënyra më e sigurt që të zgjidhet ky problem, është zhvillimi i një kornize rregullative të harmonizuar në nivel rajonal, një fakt që do të ndalojë copëzimin e tregut dhe shfaqjen e oligopoleve që përpiqen të keqpërdorin pozitën e tyre dominuese, do të lehtësojë konkurrencën, do të lejojë shfrytëzimin e ekonomive të vërteta të zhvillimit dhe do të lehtësojë investimet private.

Paraqitja e tregjeve të vetme të energjisë elektrike dhe të gazit përqark Evropës, është bërë për të lejuar pjesëmarrësit e tregut që të tregtojnë sa më lehtë energjinë elektrike dhe gazin, nëpër Evropë ashtu si brenda një sistemi liberal dhe konkurrues kombëtar. Eventualisht, për këtë arsye, të gjithë operuesit e sistemit duhet të përdorin supozimet dhe mekanizmat e njëjta për të menaxhuar rrjetet e tyre dhe përdoruesit e rrjetit do të përballen me infrastrukturë të vetme. Bashkëveprimi më i madh në mes të operuesve të sistemit për të kaluar kufijnjtë e rrjeteve politike dhe të transmetimit, të pangarkuar me mundësinë e konfliktit të interesit në lidhje me aktivitetet e tjera të tregut konkurrues, formojnë një element kyç për arritjen e këtij qëllimi. Ky qëllim do të kërkoj zgjedhje për një numër të pyetjeve të vështira teknike dhe institucionale.

Realiteti i rrjeteve të sotme të energjisë elektrike në Evropë, është se Shtetet Anëtarë nuk janë të lidhur siç duhet mes njëri-tjetrit. Si vazhdim disa vende tashmë kanë adoptuar rregulla të përbashkëta të harmonizuara që, në disa raste, shkojnë përtej atyre të parashikuara në paketën e re (Direktivat 2003/54 & 55). Për këtë arsye, zhvillimi i tregjeve rajonale që përbëhen nga shtetet anëtare, lidhjet në mes të cilave janë mjaft të forta, mund të jetë një fazë e përkohshme e domosdoshme.

Brenda këtyre tregjeve rajonale, të cilat nuk duhet të përcaktohen thjeshtë sipas kriterëve gjeografike, pritet një harmonizim më i zhvilluar i qasjes rregullative për shumicën ose të gjitha problemet, duke përfshirë; shkallën e hapjes së tregut, përcaktimin e tarifave të transimisionit, rregullat e tregtisë bilaterale si dhe metodologjitë e manaxhimit të kongestionit që inkuadrojnë tregjet e stadartizuara *të një dite para ose të benda ditës*. Në disa raste, rregulloret që qevisin bilancin dhe shërbimet ndihmëse gjithashtu mund të jenë të harmonizuara deri në një shkallë. Në të vërtetë pritet që shërbimet ndihmëse gjithashtu mund të jenë të harmonizuara deri në një shkallë. Në të vërtetë pritet që sferat e tregjeve rajonale do të zhvillohen “organikisht” përmes bashkëpunimit në mes institucioneve në tregjet fqinje. Kështu, objektiva e një tregu të vetëm të brendshëm nuk do të jetë kompromis. Rregullimet e tregut që pengojnë tregtinë ose çrregullojnë konkurrencën në mes të rajoneve do të ndalohen.

KE ka ndërmarrë iniciativa për të harmonizuar politikat kombëtare përmes të ashtuquajturve “tregje rajonale” si për shembull në Skandinavi, Gadishulli Iberik, ishujt britanikë dhe Irlandë dhe në të ardhmen në vendet baltike. Brenda kësaj kornize krijohen përpjekjet për zhvillim të tregut rajonal në Evropën Juglindore – EJT, i ashtuquajtur “Procesi i Athinës” është përshkruar më poshtë në kapitullin 4.6.

1.4 Zhvillimi Historik dhe Themelimi Institucional i Sektorit të Energjisë në Kosovë

Në mes të vitit 2000, Departamenti i Shërbimeve Publike (DSHP) është themeluar nën UNMIK /Shtyllën e BE-së, duke nxjerrë Rregulloren e UNMIK-ut 2000/49. Sa i përket sektorit të energjisë, DSHP-ja ka pasur katër funksionet kryesore: (i) të propozojë dhe zbatojë Strategjinë e Përgjithshme / Politika, (ii) Mbikëqyrja e Veprimeve të Bizneseve NP-ve, (iii) Zhvillimi dhe koordinimi i Donatorëve, dhe (iv) Veprimi si Autoritetit Rregullativ (p.sh. vlerat, pagesat dhe shërbimet, specifikimet teknike dhe standardet, pasojat për mospërmbushje të kornizës rregullative etj.).

Pas themelimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) në qershor të vitit 2002, funksioni i mbikëqyrjes së bizneseve është transferuar në AKM. Funksioni Rregullativ mbeti nën shtyllën e BE-së në bazë të Rregullores e UNMIK-ut 2000/49. Përgjegjësitë për strategjinë dhe politikën e energjisë dhe koordinimin e donatorëve, praktikisht janë kryer nga AKM-ja deri në janar të vitit 2003, kur është themeluar Njësia Qendrore Rregulative (NJQRR) nën shtyllën e BE-së.

Në veçanti, Zyra e Energjisë (ZeE) u themelua si një njësi me shumë synime në CRU-në, duke përfaqësuar një embrion të tre organizatave të ndara të parashikuara në atë kohë:

- (i) Rregulatori Pavarur i Energjisë (që mbulon energjinë elektrike, ngrohjen qendrore dhe gazin natyror – kur të jetë i aplikueshëm);
- (ii) Njësia e Strategjisë dhe Politikës (si përgjigje e nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit për Tregun Rajonal të Energjisë Elektrike – MiM/TREE me 15 nëntor 2002 në Athinë¹, dhe një paraardhës i “Ministrit të Energjisë” së ardhshme ose ngjashëm kur “kompetencat e rezervuara” në sektorin e energjisë të transferohen nga UNMIK-u tek IPVQ-të);
- (iii) Agjencia për Efikasitetin e Energjisë.

NJQRR-ja ka luajtur një rol të trupit rregullativ për shumë sektorë (ujë, mbeturina, energji, miniera, transport (hekurudha dhe aeroport) dhe postë-telekomunikacion). Në mes të shatorit 2003, ZeE dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) janë inauguruar formalisht nga Udhëzime Administrative të ndara (UA) të nënshkruara nga ZPSSP-ja Shtylla e BE-së. ZRRE është themeluar nën NJQRR, me një shtrirje përgjegjësisë të kufizuara.

Me nxjerrjen e tri ligjeve (Për Energji, Energji Elektrike, për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë) me 30 qershor 2004, ZRRE-së i është dhënë roli final institucional dhe është ngarkuar me përgjegjësitë përkatëse të fushëveprimit të plotë.

Negociatat në mes të Shtyllës së BE-së dhe Zyrës së Kryeministrit (ZKM) në janar 2004 kanë rezultuar me vendimin që Kosova fillimisht nuk do të ketë një Zyrë të Energjisë nën ZKM. Kështu, është themeluar ZeE e re nën ZKM për strategji dhe politikë të energjisë dhe është transferuar tek ZKM-ja me 11 tetor 2004, duke u nënshkruar Protokolli i Transferim të Përgjegjësisë dhe Funksioneve në Sektorin e Energjisë nga UNMIK-u tek IPVQ-të, në përputhje me Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut, DIR/2004/21.

Pas zgjedhjeve në tetor 2004, u themelua Ministria e re për Energji dhe Miniera (MEM) nën IPVQ-të dhe ka filluar të operojë në Dhjetor 2004. Me këtë, të gjitha përgjegjësitë e ish ZeE-së /ZKM, janë transferuar tek MEM-i.

Si përmbledhje, themelimi institucional në sektorin e energjisë së Kosovës, sa i përket statusit deri në fund të shkurtit 2005 është si në vazhdim (Figura 1):

- **Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM)** nën IPVQ, në mes tjerash është përgjegjëse për politikën dhe strategjinë e sektorit të energjisë (përgatitja dhe zbatimi), zhvillimi i legjislacionit sekondar (duke përfshirë standardet teknike dhe normat), inspektorati i energjisë, burimet e energjisë së pashtershme dhe racionalizimi i përdorimit të energjisë, koordinimi i donatorëve dhe joshja e investimeve (“one-stop-shop”) – përfaqëson “Autoritetin Shtetëror të Energjisë” sipas MM të TRE;
- **Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE)**, që vepron sipas ligjit, UNMIK-u ka emëruar shumicën e anëtarëve të Bordit (UNMIK: 3 anëtarë – një ndërkombëtar dhe dy vendorë dhe IPVQ-të: 2 anëtarë të aprovuar nga Kuvendi dhe të emëruar nga PSSP-ja) – që përfaqësojnë

¹ Vëreni që Amandamenti n. 1 i MeM/TRE është nënshkruar me 09 Dhjetor 2003 nga UNMIK-u në Athinë.


“Agjencinë e Pavarur Rregullatore (MeM për TRE);

- **UNMIK / Shtylla e BE-së**, një nga katër shtyllave e UNMIK-ut në krye të Rindërtimit Ekonomik të Kosovës;
- **Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM)**, e kontrolluar nga UNMIK/Shtylla e BE-së, që mes të tjerave vazhdon të kryej mbikëqyrjen e biznesit të NP-ve (KEK-ut, Ibër Lepensit, hidro-elektron-Ujmani dhe tre kompanive të ngrohjes qendrore). Sipas rregulloreve të UNMIK-ut, AKM-ja mund të ristrukturojë KEK-un, të jep me qera objektet, jep kontratat për menaxhim, megjithatë, AKM-ja nuk mund të privatizojë objektet e KEK-ut; Njëjtë vlen edhe për NP-të e tjera.
- **Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve (KPMM)**, i themeluar në Janar të vitit 2005 me nxjerrjen e rregulloreve të UNMIK-ut 2005/2 – që përfaqëson “Agjencinë e Pavarur Rregullatore” në sektorin e Minierave;
- **Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)**, ndërmarrje e Kosovës për energji e integruar vertikalisht duke përfshirë mihjen e thëngjillit, prodhimin e energjisë, transmetimin dhe dispeçimin, shpërndarjen dhe furnizimin. KEK-u aktualisht i është nënshtruar inkorporatizimit dhe procesit të ndarjes ligjore dhe llogaritare, proces ky që do të përfundohej nga fundi i vitit 2005;
- **(3) Kompanitë e Ngrohjes Qendrore** të Prishtinës, Gjakovës dhe Mitrovicës (gjithashtu të integruara vertikalisht), pronat e të cilave gjithashtu janë nën përkujdesjen e AKM-së; KNQ-të e Gjakovës dhe Prishtinës janë në proces të inkorporatizimit;
- **Komuniteti i Donatorëve**, zyrat përfaqësuese të Agjencia Evropiane për Rindërtim (EAR), Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, (USAID), Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Banka Botërore (BB) dhe donatorët bilateral: Gesellschaft für Zusammenarbeit (GTZ) dhe Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), që të dyja nga Gjermania, SDC e Zvicrës, “Sida” e Suedisë, janë ende duke qëndruar në Prishtinë ende.²

Në Figurën 1.1, Shtylla e BE-së dhe MEM-i janë institucionet që prijnë. ZRRE-ja dhe KPMM janë dy organe të pavarura të ngarkuara për rregullimin ekonomik të sektorit të energjisë. Në fazën përfundimtare, që të dyja i raportojnë Kuvendit të Kosovës. Bordi menaxhues i ZRRE-së dhe i KPMM-së janë emëruar nga PSSP-ja, bazuar në emërimet përkatëse të bëra nga UNMIK-u dhe IPVQ-të. Bordet e Drejtorëve (BeD) të NP-ve janë të udhëhequr nga AKM-ja si i besuari i pronave të këtyre NP-ve, sidoqoftë, me anëtarët e UNMIK-ut dhe IPVQ-së. BiD të KEK-ut nuk ekziston ende në formën e vet përfundimtare, ndërsa Bordi i AKM-së nuk është formuar pas ndërrimit të Qeverisë.

² Njoftojmë se disa nga zyret e donatorëve kanë ndërprer operimin e tyre në Kosovë (p.sh. DANIDA e Danimarkës, NORAD e Norvegjisë, UNOPS / UNDP, DFID e BM etj.).

Figura 1: Struktura Institucionale që ndikon Sektorin e Energjisë së Kosovës



1.5 Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve Kryesore të ZRrE-së në vitin 2004

Në vitin 2004, ZRRE-ja ka kaluar nëpër ndryshime të shpejta përgjatë zhvillimeve të statusit dhe mandatit të saj. Aktivitetet kryesore të ZRRE-së, të cilat që janë të detajuara më poshtë në këtë raport, përfshijnë:

- Pjesëmarrjen në Procesin e Athinës dhe në organet dhe organizatat ndërlidhëse;
- Asistencë në përgatitjen e legjislacionit primar;
- Pjesëmarrja aktive e ZRRE-së në të gjitha aktivitetet e rëndësishme në sektorin e energjisë;
- Përgatitja dhe kompletimi i strukturës organizative të ZRRE-së;
- Përgatitja e përshkrimit të vendeve të punës dhe rekrutimi stafit të ZRRE-së;
- Trajnimi i stafit ekzistues dhe atij të ri të ZRRE-së (udhëtimet studimore në Shqipëri, Republikën Çeke, Slloveni, Lituani dhe Suedi);

- Përgatitja e drafteve të legjislacionit sekondar siç janë: Rregullat për Licencim, Rregullat për vënie të çmimeve dhe tarifa, Rregullat për Shkycje, Rregullat për Zgjidhjen e çështjeve Kontestuese, Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Skema e Taksave;
- Koordinimi i projekteve vazhdues të donatorëve;
- Përgatitja e koncepteve korporatizuese dhe projekteve për përkrahje të donatorëve në vitin 2005, dhe mobilizimi i donatorëve;
- Përgatitja e dokumenteve të brendshme të ZRRE-së: Statuti, Kodi i Sjelljes dhe Etikës, Vendimet, Urdhrat, Udhëzimet;
- Shqyrtimi i çmimeve në sektorin e NQ-së
- Aprovimi i Bilancit Vjetor të Energjisë së KEK-ut;
- Nxjerrja e vendimeve të përkohshme në lidhje me shkycjen dhe legjislacionin e Konsumatorëve të KEK-ut;
- Pjesëmarrja në ristrukturimin e sektorit (ZRR-eja është e ngarkuar me ndarjen e menaxhimit dhe llogarive të ndërmarrjeve të integruara vertikalisht - Ligji).

2. Themelimi dhe Mandati i ZRR-e-së

2.1 Korniza Ligjore dhe Rregullative

Me 30 Qershor 2004 janë nxjerrë Ligji për Energji, Ligji për Energji Elektrike dhe Ligji për Rregullatorin e Energjisë. Këto ligje mbështesin integrimin e Kosovës në sferën e Ekonomisë së Evropës me pikësynim të hyrjes së saj në Unionin Evropian; pjesëmarrja e Kosovës në të gjitha marrëveshjet e ndërlidhura ndërkombëtare që Kosova është pjesëtare ose mund të bashkohet dhe harmonizimin gradual të legjislacionit të Kosovës me legjislacionin për energji të Bashkësisë Evropiane.

Ligji për Energji definon parimet themelore për strategjinë e energjisë dhe programet e energjisë në Kosovë me qëllim që të garantoj furnizim të energjisë të sigurt, serioz, qëndrueshëm dhe cilësor si dhe të promovojë:

- Përdorim efikas dhe ekonomik të resurseve të energjisë;
- Investime në sektorin e energjisë dhe respekt për mbrojtjen e mjedisit në aktivitetet e energjisë;
- Ofroj kushtet për zhvillimin e tregut të moderuar të energjisë dhe të siguroj konkurrencë në këtë treg të energjisë sipas principeve të përgjithshme të mos-diskriminimit, transparencës, barazisë dhe respektit për mbrojtjen e konsumatorëve;
- Kohezioni ekonomik dhe social i Kosovës.

Ligji për Energji Elektrike themelon kushtet për përmbushjen e prodhimit, transmetimit, shpërndarjet, furnizimit, tregtisë, importit, eksportit, dhe tranzitit të energjisë elektrike; organizimi i qasjes në rrjete, dhe organizimi i tregut të energjisë elektrike me qëllim që të:

- Arrihet një treg konkurrues dhe i qëndrueshëm për energji elektrike;

- Garantohen kushtet të sigurta, të besueshme, efikase dhe të përhershme të furnizimit me energji elektrike;
- Të siguroj që, kur është e mundur teknikisht dhe ekonomikisht, që të gjithë konsumatorët e fundit gëzojnë shërbim universal, që është e drejta për tu furnizuar me energji elektrike të sasisë së specifikuar brenda Kosovës me një çmim të arsyeshëm.

Me miratimin e **Ligjit për Rregullatorin e Energjisë**, ZRrE-së i është dhënë roli institucional si një autoritet rregullator i pavarur në sektorin e energjisë (Energji Elektrike, Ngrohje Qendrore dhe Gaz Natyror) dhe bazat që kërkohen për të gjithë sferën e veprimit të tij.

Qëllimet e **Ligjit për Rregullatorin e Energjisë** janë që të themelohet një kornizë rregullative për sektorin e energjisë që do të siguroj:

- Funksionimin transparent dhe jodiskriminues të një tregu të energjisë bazuar në principet e një tregu të lirë dhe përmbushje të aktiviteteve të energjisë të cilat i nënshtrohen detyrimeve të shërbimeve publike;
- Krite të hapura dhe transparente për lëshimin dhe monitorimin e licencave për aktivitetet e energjisë dhe dhënien e lejeve për ndërtimin e instalimeve të reja;
- Që çmimet për aktivitetet e energjisë të cilat janë të rregulluara (rrjetet, shërbimet e furnizimit publik dhe detyrimet e shërbimit publik) të jenë transparente të arsyeshme dhe të caktuara në bazë të metodologjisë së tarifave të lëshuara nga ZRrE-ja;
- Që asnjë ndërmarrje e energjisë të mos keqpërdorë pozitën dominante dhe që të parandalohen praktikant anti-konkurrese;
- Që, kur është e mundur teknikisht dhe ekonomikisht, të gjithë konsumatorët duhet të kenë të drejtë që të kyçin objektet e tyre në rrjetet dhe marrin furnizim universal të energjisë;
- Konsumatorët dhe të licencuarit janë të mbrojtur me procedura adekuate për zgjedhjen e çështjeve kontestuese;
- Që interesat në mes të konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë janë të balancuara në mënyrë adekuate;
- Zbatimi i masave të duhura në sektorin e energjisë të përforcojnë kohezionin social dhe ekonomik në tërë Kosovën;
- Që standardet e mbrojtjes së mjedisit gradualisht të përmirësohen;
- Siguria e furnizimit të energjisë elektrike, ngrohjes, dhe gazit natyror përmes mirëmbajtjes dhe ndërtimit (përmes autorizimit por nëse duket e nevojshme edhe përmes procesit tenderues) të kapaciteteve të nevojshme të prodhimit dhe transmetimit dhe infrastrukturës së rrjetit duke përfshirë kapacitetin ndërlidhës.

2.2 Mandati i ZRrE-së

Ligji 2004/9 “për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë” ka themeluar një Zyrë tërësisht të Pavarur të Rregullatorit për Energji dhe ka definuar kompetencat ekzekutive të tij, detyrat dhe funksionet e ZRrE-së, kushtet për lëshimin e licencave për kryerjen e aktiviteteve të energjisë, procedurat për dhënien e lejeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, kriteret për rregullimin e rrjeteve dhe çmimeve të shërbimit publik dhe aprovimin e tarifave, dhe kushtet për furnizim të energjisë.

Sipas principeve të përgjithshme ZRRE-ja është përgjegjëse për themelimin dhe zbatimin e kornizës rregullative për sektorin e energjisë në Kosovë, me qëllim që të arrihet pajtueshmëri me detyrimet e Traktatit të KEEJL-së dhe harmonizimit me “Acquis Communautaire” për energji, për të siguruar qasje jodiskriminuese të të gjithë shfrytëzuesve të rrjetit të energjisë me çmim që reflektojnë shpenzimet e vërteta ekonomike, dhe për të promovuar efikasitet ekonomik me ofrimin e shenjave të duhura, afat gjata dhe afat shkurtër të çmimeve.

Për të arritur këto qëllime ZRRE-ja ka të drejtë të:

- Jep, modifikon, suspendon, transferon, tërheq, mbikëqyr dhe kontrollon përmbushjen e licencës;
- Vendos principet “ex-ante” të çmimeve dhe metodologjitë dhe si pasojë aprovon tarifat për shërbimet e rregulluara të energjisë (qasjen dhe shfrytëzimin e rrjeteve, furnizimin publik, detyrimet e shërbimit publike etj);
- Jep leje për ndërtimin dhe veprimin e kapaciteteve të reja të prodhimit dhe sistemeve të gazsjellësve duke përfshirë linjat e gazit dhe ato të energjisë elektrike;
- Nxjerr tenderë për ndërtimin dhe veprimin e kapaciteteve të reja të prodhimit, në rast se procesi i autorizimit nuk prodhon kapacitete të reja dhe sigurimi i furnizimit është i kërcënuar;
- Monitoron formën ligjore shpërbërës, organizimin, marrjen e vendimeve, dhe llogaritë e ndërmarrjeve të energjisë. Këtë rol ZRRE-ja do ta përmbush përmes lëshimit të licencave për aktivitetet e ndara të ndërmarrjeve, aprovimin e tarifave dhe aktiviteteve të ngjashme brenda sferës së ZRRE-së. Funkcioni i monitorimit mbulon gjithashtu monitorimin e tarifave, zgjedhjen e kontesteve, kualitetin e shërbimeve, standardet e përmbushjes, etj.;
- Merr, aprovon, dhe kontrollon përshtatjen me të gjitha kodet dhe rregullat teknike duke përfshirë rregullat e rrjetit, shpërndarjen, matjen, kyçjen dhe shfrytëzimin e sistemit dhe rregullave të tregut; vendos rregullat për qasje dhe menaxhim të kongestionit të lidhjeve të linjave dhe gazsjellësve;
- Lëshon aktet e përgjithshme, aktet individuale, dhe legjislacionin sekondar dhe zbaton dispozitat e Ligjeve dhe legjislacionet e tjera të ndërlidhura si dhe vendos gjopa për kundërvajtje.

Gjatë përmbushjes së aktiviteteve ZRRE-ja:

- Jep pëlqimin e vet për ndarje, bashkim, ose zbritje për kapitalin fillestar të ndërmarrjeve të energjisë që posedojnë licenca dhe leje për shfrytëzim të pronës së përdorur për përmbushje të aktiviteteve të licencuara. Ky aktivitet mund të qoj në çrregullime të furnizimit të qëndrueshëm për shkak të borxheve të ndërmarrjeve të energjisë; zbaton sjelljet monopoluese ose grabitëse, si dhe ka ndikim të drejtpërdrejt në konkurrencën e sektorit të energjisë;
- Monitoron sjelljen e ndërmarrjeve të energjisë në treg dhe posaçërisht abuzimin e pozitës dominuese ose keqpërdorimin e metodave të çmimeve, me qëllim që të ruaj dhe promovoj konkurrencën në ndërmarrjet e energjisë;
- Merr vendime në lidhje me klasifikimin e linjave të energjisë elektrike, tubacionit të ngrohjes, tubacionit të gazit, dhe objekteve të tyre ndihmëse, brenda rrjetit të shpërndarjes ose transmetimit, dhe për të ju ofruar qasje brenda kushteve të propozimeve nga ndërmarrjet përkatëse të shpërndarjes dhe transmetimit;

- Shqyrton kërkesat nga ndërmarrjet e energjisë për kompensim të shpenzimeve standarde të pambuluara dhe merr vendime në lidhje me shumën dhe metodën për kompensimin e tyre;
- Vendosin detyrimet për shërbimet publike ashtu siç kërkohet nga qeveria (shoqërimin e çmimeve të disa shërbimeve si “Shërbim Universal”, “Furnizues i fundit për të Zgjedhur”, energjia e ripërtëritshme, tarifa “mbijetesë”, etj.);
- Lëshon vërtetime për origjinën e energjisë elektrike, të prodhuar nga resurset e energjisë së ripërtëritshme nga hedhurinat dhe nga ko-gjenerimi i energjisë elektrike dhe ngrohjes.
- Ndikon në rregullat e Veprimit të Sistemit për alokimet në mes të aseteve kyçese “të thella” dhe të “cekta”, legjislacion sekondar për promovim të shfrytëzimit efikas të energjisë dhe shfrytëzim të energjisë së ripërtëritshme, strategji të energjisë të përgatitura nga MEM) dhe raportet vjetore dhe ato afatgjate të bilancit të energjisë të përgatitura nga OST-ja.
- Mirëmban regjistrin publik të lëshuar, modifikuar, liçensat të ndërprera , të tërhequra, vërtetimet e lëshuara të origjinës, kodet e aprovuara dhe zgjedhjet kontesteve;

Ligji i Rregullatorit të Energjisë e themelon bordin e ZRrE-së (5 anëtar) si organ ekzekutiv për vendimmarrje për të drejtuar ZRrE-në dhe definojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tij. Bordi është përgjegjës për aprovimin e politikave operative dhe statutet , që të miratoj (me shumicë votash) me procedura të konsultimit publikë të gjitha legjislacionet sekondare, rregullat, urdhëresat dhe dekretet e lëshuara nga ZRrE-ja, për të organizuar dhe mbikëqyrur aktivitetet menaxhuese, mbikëqyr buxhetin dhe menaxhimin financiar, dhe aprovon raportet dhe gjendjet financiare të ZRrE-së.

Para fillimit të secilit vit kalendarik ZRrE-ja përgatitë Projekt Dokumentin i cili përfshinë përshkrimin e përgjithshëm të projekteve që do të ndërmerren për vitin e ardhshëm dhe i dorëzon ato në Kuvend për shqyrtim së bashku me raportin financiar. ZRrE-ja përgatitë buxhetin vjetor. Llogarit e ZRrE-së i nënshtrohen auditimit nga auditor të jashtëm të emëruar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Për çdo vit ZRrE-ja raporton në Asamblenë e Kosovës dhe tek PSSP-ja. Raporti duhet të bëhet publik. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të saj ZRrE-ja bashkëpunon me ndërmarrjet e energjisë, ministritë (posaçërisht MEM), shoqatat dhe institucionet e ndryshme në Kosovë.


2.3 Struktura Organizative dhe Personeli i ZRrE-së

Që nga fundi i shkurtit 2005, ZRrE-ja ka ofruar punësim për 18 anëtarë të stafit, nga të cilët 9 kanë qenë nga BKK, 7 nga buxheti i Shtyllës së BE-së dhe 2 të përkrahur nga donatorët (KfW dhe Sida). Kur të plotësohet numri i personelit (p.sh. kah mesi i 2005), ZRrE-ja do të ketë të punësuar 25 anëtar të stafit, nga të cilët 15 në buxhetin e BKK-së, 8 në buxhetin e shtyllës së BE-së dhe 2 nga donatorët. Përkrahja e Shtyllës së BE-së dhe BKK-së do të kërkohet deri atëherë kur ZRrE-ja të jetë në pozitë që të vetëfinancohet ekskluzivisht nga taksat e licencave dhe gjatë.

Përgatitja shkollore e personelit të ZRrE-së është: nga 18 anëtarët e punësuar të ZRrE-së, 13 anëtar të personelit janë me diploma universitare, 5 të padiplomuar, prej të cilëve 4 janë ende duke studiuar. Nga të diplomuarit: 5 janë elektor-inxhinierë, 2 inxhinierë mekanikë, 4 ekonomistë dhe 2 juristë.

Struktura organizative e ZRrE-së është e paraqitur në Figurën 2.

Figura 2: Struktura Organizative e ZRrE-së (Statusi me 31 mars 2005)



ZRrE-ja ka 4 njësi funksionale (“departamente”), me përgjegjësitë themelore si në vazhdim:

1. **Departamenti për Licencim dhe Jurisprudencë:** objektivat kryesore të tij janë të dyfishta:
 - i. Përgatitja e të gjitha llojeve të Licencave dhe autorizimeve për themelimin dhe veprimin e ndërmarrjeve të energjisë dhe mbikëqyrjen e tyre, monitorimin e pajtueshmërisë me kushtet e Licencës dhe me vendimet relevante të ZRrE-së, dhe
 - ii. të japë përkrahje ligjore Kryesuesit dhe stafit të ZRrE-së dhe të përfaqësoj ZRrE-në në procedurat administrative. Departamenti siguron korrektësinë ligjore të vendimeve dhe të rezolutave të ZRrE-së.
2. **Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve:** objektiva kryesore e tij është që të përfaqësoj interesin e Konsumatorëve, të hulumtoj ankesat e konsumatorëve dhe të ko-eproj me organizatat legjitime që përfaqësojnë konsumatorët. Njësia do të krijoj

Forumin për Zgjedhjen e Kontesteve për ankesat tipike. Ata këshillojnë njësitë e tjera të ZRrE-së që janë përgjegjëse për përgatitjen e Standardeve që duhet të përmbushin të Licencuarit, në lidhje me veprimet që merren në interes të konsumatorëve. Njësia është përgjegjëse për hulumtimin dhe matjen e opinioneve të konsumatorëve, interesave dhe kënaqshmërisë me shërbime.

3. **Departamenti për Furnizim të Energjisë dhe Strukturë të Tregut:** është përgjegjës për zbatimin e elementeve të reja të konkurrencës dhe merret me çështjet e modelimit (të sistemit), pyetjet teorike rregullative në lidhje me veprimin e tregut. Qëllimet e njësive janë që të bëjnë analizat e informatave adekuate të grumbulluara në lidhje me kapacitetin dhe balancën e energjisë në të gjitha segmentet e Industrisë së Energjisë. Nëse është e nevojshme, i propozon masat, rregulloret e reja që sigurojnë qëndrueshmëri të furnizimit me energji, balancim energjetik dhe konkurrencë efektive. Njësia analizon pyetjet për strukturën dhe ristrukturimin e tregut.
4. **Departamenti për Çmime dhe Tarifa:** objektiva kryesore është që të përgatisë pozitën e ZRrE-së në lidhje me metodologjinë e tarifave, strukturën e aktiviteteve të ndryshme të rregulluara dhe të analizoj dhe propozoj tek Bordi i ZRrE-së për aprovim, tarifat e dorëzuara nga ndërmarrjet. Departamenti është përgjegjës për procesin e shqyrtimit të çmimeve, që të formoj udhëzimet për grumbullimin dhe dorëzimin e të dhënave kontabël të rregulluara të kërkuara nga ndërmarrjet, kjo do t'i mundësojë një vlerësim të duhur të tarifave të dorëzuara dhe vendosjen e shkallës së të ardhurave të lejuara.

Grupi Këshillues Teknik përbëhet nga ekspert të lëmit të energjisë elektrike, ngrohjes qendrore dhe ekonomisë/financave, detyrë e të cilëve është që të ofrojnë përkrahje “horizontale” për të gjitha departamentet dhe të këshillojnë Kryesuesin e Bordit të ZRrE-së.

Si shtesë, ZRrE-ja mbështetet nga Zyra Administrative: që ofron përkrahje sekretariale, operative, logjistike, dhe TI për Kryesuesin dhe për stafin e ZRrE-së, duke menaxhuar, operuar me dokumentacion, prokurim dhe buxhet, dhe sistem menaxhues të arkivimit.

2.4 Shpenzimet dhe Buxheti i ZRrE-së

Të hyrat dhe shpenzimet e ZRrE-së

Në vitin e parë të veprimit të saj, ZRrE-së nuk ka pasur të hyra nga Licencat ose nga vënia e taksave të tjera dhe për këtë arsye është varur nga 3 burime të financimit


- Asistenca nga Shtylla e BE-së;
- BKK-ja; dhe
- Donatorët.

Gjatë tërë vitin 2004, ZRrE-së ka operuar nën NJQRR të Shtyllës së BE-së. Është vlerësuar që Shtylla e BE-së ka dhënë për buxhetin e ZRrE-së 147,800EURO. Megjithatë, ky ka qenë vetëm një kontribut parcial për shpenzimet operative të ZRrE-së. Shtylla e BE-së ka mbuluar shpenzimet e pagave për stafin ndërkombëtar dhe atë lokal të kontraktuar nga shtylla e BE-së, shpenzimet e udhëtimeve të krijuara nga ky staf, dhe janë mbuluar disa shpenzime të kostos së veprimit (Figura 2.2). Për shembull, shtylla e BE-së ka mbuluar shpenzimet e qerasë së ndërtesës ku është e vendosur ZRrE-ja, si dhe shpenzimet e mirëmbajtjes dhe shërbimeve publike të ndërtesës. Sipas praktikave të Shtyllës së BE-së, ZRrE-ja nuk ka alokim të vet të buxhetit në buxhetin e përgjithshëm të buxhetit të shtyllës së BE-së. Në rrethanat e burimeve të kufizuara, ZRrE-ja

duhet të hyjë në konkurrencë me organizatat e tjera që marrin përkrahje nga Shtylla e BE-së siç është AKM-ja, njësitet e tjera të NJQRR-së (p.sh. DMM, ZRrUM etj.) si dhe me vet Shtyllën.

Shpenzimet e tjera të ZRrE-së janë mbuluar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK'04) dhe nga donatorët. Në vitin 2004, ZRrE –ja e ka pasur alokimin e vet nga BKK'04, megjithatë ende brenda kornizës së përgjithshme të alokimit të buxhetit të NJQRR-së. Që nga gushti i vitit 2003, propozimi për buxhetin e ZRrE-së nga BKK-së për vitin 2004 është dorëzuar në Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF) nga menaxhimi i NJQRR-së. Aprovimi i BKK'04 për ZRrE fillimisht është publikuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2003/41 dhe është vlerësuar në shumën totale prej 253,714 EUR (por shihni më poshtë zbritjet).

Figura 2.2: Ndarja e Kontributit të Shtyllës së BE-së për ZRrE (2004- € 147,800.00)



Shpenzimet totale të ZRrE-së në vitin 2004 janë vlerësuar përafërsisht 793,180 EURO. Këtu përfshihet veprimi dhe shpenzimet e rregullt të ZRrE-së (pagat, shpenzimet fletëngarkese, udhëtimet, qeraja, prokurimi, etj) plus shpenzimet e disa “projekteve” specifike të llojit të Asistencës teknike (pagesë për Shërbime Konsultative) që janë mbuluar nga donatorët. Në buxhetin e përgjithshëm të ZRrE-së, BKK 2004 ka kontribuar përafërsisht me 15.6%, ndërsa 18.6% është mbuluar nga Shtylla e BE-së, dhe pjesa e mbetur 65.7% nga donatorët (Figura 2.3).

Përkrahja e donatorëve në vitin 2004 nuk mund të definohet në mënyrë precize pasi që kanë qenë disa projekte që kanë zgjatë gjatë disa viteve (2003-2005). Është vlerësuar që përafërsisht 520,000 EURO i janë dhënë ZRrE-së në formë të asistencës teknike (AT). Kontribuuesit kanë qenë Sida e Suedisë, GTZ & KfW të Gjermanisë dhe USAID i SHBA-ve (Figura 2.4). AT-ja përfshinë shpenzimet e personelit (pagat) për dy anëtarët e stafit të mbuluara nga Sida dhe KfW, si dhe përkrahja e jashtme për Sektorin e Ngrohjes Qendrore nga Sida dhe për zhvillimin e legjislacionit sekondar nga USAID (për më shumë detale në lidhje me asistencën e donatorëve shikoni Paragrafin 2.6).

Në vitin 2004, Shtylla e BE-së nuk është paraqitur si donator në ZRrE pasi që ZRrE-ja ka operuar si pjesë integrale e Shtyllës së BE-së / NJQRR.

Figura 2.3: Totali i shpenzimeve të ZRrE-së në vitin 2004 (793,180.00 €)





Figura 2.4: Ndarja e Kontributeve nga Donatorët në vitin 2004



Menaxhimi i Financimit publik

Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Kryesuesit të ZRrE-së dhe në bashkëpunim me stafin tjetër të ZRrE-së, shfrytëzimi i fondeve të buxhetit të KK-së është planifikuar dhe monitoruar.

Për qëllim të planifikimit të shfrytëzimit të buxhetit, ZRrE-ja përgatitë planin financiar si dokument “real”, i cili në mënyrë të rregullt bën azhurnimin bazuar në shpenzimet aktuale dhe vlerësimet më të fundit të shpenzimeve të ardhshme. Duke vepruar kështu, ZRrE-ja i jep prioritet detyrave të rëndësishme madhore strategjike, dhe megjithatë, kujdeset që të mirëmbaj nivel adekuat të parave të gatshme që nevojiten për veprimet e përditshme.

ZRrE-së përgatitë raporte dhe bën analiza për shpenzimet tri herë në vit. Një tjetër arsye për të vepruar kështu, është që t'i prezantohet MFE-së praktika e cila konfirmon mundësinë e buxhetit në katër pjesët e vitit. ZRrE-ja mirëmban të gjithë dokumentacionin financiar në mënyrë profesionale, duke përfshirë azhurnimet e rregullta dhe përcjelljet e ndryshimeve dhe ofron raporte dhe informata tek MEF atëherë kur kërkohet. Gjithashtu, ZRrE-ja përkujdeset për saktësinë dhe plotësimin e dokumentacionit financiar dhe bashkëpunon tërësisht me MFE-në në lidhje me pagesat, rrjedhjen e parave, parat e gatshme, alokimin fondeve etj. Në lidhje me menaxhimin e financimit publik, ZRrE-së në mënyrë strikte përcjell dhe punon në përputhje me Ligjet në zbatim dhe Urdhëresat Administrative të aprovuara nga Ministria e Shërbimeve Publike dhe MFE-ja, posaçërisht:

- Ligji për Menaxhim të Financimit Publik dhe Përgjegjësitë (Ligji Nr. 2003/2);
- Ligji për Prokurim Publik në Kosovë (Ligji Nr. 2003/17);
- Rregullorja e UNMIK-ut për Shërbim Civil të Kosovë (Rreg. 2001/36).

Prospektet për Financimin e ZRrE-së në të ardhmen

Përkrahja nga BKK-ja dhe Shtylla e BE-së do të kërkohet deri atëherë kur ZRrE-ja të jetë në pozitë që të vetëfinancohet tërësisht nga taksat e licencave vjetore dhe vënia e taksave. Donatorët (Sida, KfW, AER, BB, USAID) do të mbështesin duke ofruar asistencë teknike për projektet prioritare, megjithatë, kjo nuk mund të përfshijë përkrahjen për shpenzimet operative të ZRrE-së. Çështja e vetëfinancimit të ZRrE-së është qartas e ndërlidhur me gjendjen e tanishme financiare të ndërmarrjeve të rregulluara të energjisë – të licencuarve, dhe mundësisë së tyre që të paguajnë taksat vjetore ZRrE-së. Natyrisht, kontribuuesi më i madh do të jetë KEK-u, përderisa tri (3) Kompanitë e NQ-së vetëm në një masë të vogël. Sipas planit për Kthim të përgatitur nga KEK-u /ESBI, i cili është i aprovuar nga bordi i Përkohshëm Mbikëqyrës i udhëhequr nga AKM-ja në shkurt 2005, KEK-u do të bëhet një kompani financiarisht e shëndosh në vitin 2006, megjithatë, në skenarët më optimist kjo mund të jetë e mundur vetëm nga fundi i vitit 2006. Megjithatë, dhe si pasojë, është më se e mundur që ZRrE-së do ti duhet që të kërkojë edhe nga BKK-ja dhe nga shtylla e BE-së gjithashtu për vazhdimin e përkrahjes buxhetore për vitin 2006.

Biznes Plani i parë i konsoliduar i ZRrE-së do të përgatitet nga mesi i vitit 2005. Do të mbulojë periudhën e 5 viteve të ardhshme të veprimit të ZRrE-së (2006-2010). Çështja e buxhetit do të adresohet si një nga parakushtet e rëndësishme për qëndrueshmërinë e veprimeve të ardhshme të ZRrE-së.

2.5 Sistemi i teknologjisë informative (IT), Pajisjet dhe Mjetet e tjera të ZRrE-së

Deri në fund të vitit 2004, në dispozicion të ZRrE-së kanë qenë njëzet kompjuterë tavoline me performancë të lartë (high-performance) dhe katër kompjuterë lap-top. Të gjithë PC-të janë të kyçur në Rrjetin e EUMIK-ut, duke ofruar kështu qasje në arkivat e përbashkëta dhe qasje “24-orëshe” në internet. Një nga PC-të është përdorur gjithashtu si server i arkivit të PC-ve të ZRrE-së. Sa i përket pajisjeve shtesë kompjuterike, janë gjithashtu 2 shtypës me ngjyra dhe 9 shtypës bardh e zi, 1 skaner, 1 fotokopje, 5 lap-top, 14 flash- memorie, 1 kamerë dixhitale dhe një projektor, të gjitha pajisje të ZRrE-së dhe NJQRr-së.

Sistem Standard operativ dhe softueri “Office” janë të instaluar në të gjithë kompjuterët, si dhe disa programe të tjera për analiza financiare dhe të sistemit të rrymës. Për komunikim me internet, “Microsoft Exchange” dhe “Outlook” dhe për menaxhimin e arkivimit të dhënave, janë përdorur softuerët profesionalë të “Adobe 6.1”, për të cilët ZRrE-ja ka poseduar 10 licenca në

vitin 2004. I tërë softueri është i licencuar dhe sistemi është i siguruar me softuerë “anti virus” i cili është i siguruar me “firewall” dhe përtërihet rregullisht.

Me qëllim të mos ndërhyrjes në /ose të korrupsionit të sistemit, asnjë nga shfrytëzuesit nuk lejohet që të instalojë softuerë shtesë në sistem. Çdo ripërtëritje e softuerit ose intervenim në sistem është e mundur vetëm nga Administratori i Sistemit, duke respektuar procedurat e përshkruara.

Është në përgjegjësi të stafit të dedikuar të ZRrE-së, Zyrtarit për Menaxhimin e të dhënave, që të mirëmbajë rregullisht “Share Drive”-in e përbashkët të ZRrE-së dhe të zhvillojë më tej dosjet dhe nëndosjet, të sigurojë mbrojtjen e duhur dhe të menaxhojë sigurinë e dosjeve të “Share Drive”-it të ZRrE-së.

ZRrE-ja ka krijuar faqen e saj të internetit (website) “www.ERO-ks.org”, ku sipas Ligjit të gjitha vendimet e saj, duhet të publikohen së bashku me lajmet e tjera, si aktivitetet dhe shpalljet publike. Ripërtëritja dhe zhvillimi i website-it është gjithashtu detyrë e sektorit të IT-së të ZRrE-së.

Në vitin 2004, ZRrE-ja ka blerë pajisje lëvizëse (pajisje IT dhe inventar për zyra) në një shumë prej përafërsisht 78,000 EURO, e cila është ofruar nga BKK-ja 04.

Në përgjithësi, pajisjet e përdorura nga ZRrE-ja përfshijnë ato që janë blerë nga BKK-së (2003-2004) si dhe ato të blera nga Shtylla e BE-së (1999-2004). Sa i përket pajisjeve të shtyllës së BE-së, ato përfshijnë pajisje për zyrë, ngrohës me gaz, ventilator, pajisje të IT-së, pajisje për komunikim etj. Pas shpërbërjes së NJQRR-së, ZRrE-ja ka bërë një kërkesë për të transferuar një pjesë të pajisjeve të NJQRR/shtyllës së BE-së në ZRrE.

Së fundi, ZRrE-ja posedon 4 automjete që aktualisht përdoren nga stafi i saj, automjetet janë blerë nga strukturat e mëhershme të – DSHP-së (Njësia Qendrore Fiskale dhe /ose të dhuruara). Shumica e këtyre automjeteve tashmë janë amortizuar tërësisht ose janë në kushte shumë të vështira teknike.

2.6 Lista e Projekteve, Aktiviteteve, Ndhimë e Donatorëve për ZRrE (2004-2005)

Në 2004

Projektet madhore të ZRE së, të mbështetura nga donatorët, ku ZRE-ja ka qenë i përfitues i drejtpërdrejtë, përfshijnë:

- Sida (Suedeze): AT, “Këshilltar për Kryesuesin e ZRE-së për Ngrohje Qendrore në Kosovë” (Gusht 2003 – janar 2005, me mundësinë e tanishme për vazhdim prej 12 muajve – deri në fund të vitit 2005); këshilltar ndërkombëtar ÅF (Suedi), takimi përfundimtar për Shqyrtimin e Projektit (faza e parë): 9 shkurt 2005, duke përfshirë:
 - o Detyra 1: Përkrahje ditore për kryesuesin e ZRE-së dhe ekspertin e NQ-së;
 - o Detyra 2: Përkrahje në zhvillimin e legjislacionit sekondar përkatës;
 - o Detyra 3: zbatimin e legjislacionit të votuar të programit subvencionues për të varfërit.
- GTZ & KfW (Gjermani): AT, ndihma afatgjate e një eksperti në ZRE, në pozitën e Ushtruesit të Detyrës së Kryesuesit të ZRE-së (janar - shtator 2004) dhe Këshilltarit të Lartë Teknik për Kryesuesin e ZRE-së (tetor 2004 – dhjetor 2004), aktualisht e vazhduar deri në korrik 2005, konsultant: DECON (Gjermani);

- USAID (USAID): AT, “Përkrahje për zhvillimin e legjislacionit sekondar”, , kohëzgjatja: që nga tetori 2004 me mundësi të vazhdimit deri në vitin 2006, me program të punës për të kompletuar dhe ndihmuar ZRE-në në përgatitjen e drafteve të dokumenteve të brendshme dhe artikujve të zgjedhur të legjislacionit dytësor, posaçërisht:
 - o Statuti i ZRE-së
 - o Kodi i etikës dhe i sjelljes
 - o Rregulla për Shkyçje
 - o Rregulla për Licencim
 - o Manuali i Veprimeve

Në vazhdim janë edhe dy projekte shtesë me ndikim indirekt në punën e ZRrE-së:

- CIDA (Kanada), Projekti SEETEC: AT “Strategjia dhe Plan i përkrahjes për Ristrukturimin e Funksioneve të Transmetimit” (tetor 2004 – shkurt 2005);
- BB (ESTAP II): AT “Shqyrtimi i Politikës, Kornizës Rregullative, Ligjore dhe institucionale për Pjesëmarrjen e Sektorit Privat në Sektorin e Energjisë në Kosovë” (shkurt 2004 - shkurt 2005).

Projektet në vitin 2005

Në vitin 2005, përveç aktiviteteve të lartpërmendura të mbështetura nga Sida, KfW, USAID dhe Shtylla e BE-së që do të vazhdojë në vitin 2005, projektet madhore të ZRrE-së (si Përfitues i drejtpërdrejtë) përfshijnë:

- Shtyllën e BE-së në UNMIK: AT, “Përkrahje për Zhvillimin e Legjislacionit Sekondar”, , data e fillimit: Janar 2005, kohëzgjatja: 3 muaj kalendarik, me programin e punës që ti asistojnë ZRE-së në hartimin e temave të përzgjedhura të legjislacionit sekondar, posaçërisht:
 - o Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji
 - o Çmimoren për ZRE-në
 - o Rregullën për zgjedhje të kontesteve
 - o Elementet kyçe për metodologjinë e tarifave
- ARE: AT, “Përkrahje për ngritjen institucionale të Zyrës së Rregullatorit për Energji”;
- BB (ESTAP III): AT, “Zhvillimi i tarifave të transmetimit të energjisë elektrike, tarifave me pakicë dhe Mekanizmi i Dhënies së Subvencioneve për konsumatorët e varfër”, buxheti i alokuar: 0.6m US\$, data e fillimit të planit: qershor 2005, data e përfundimit: brenda 8 muajve kalendarik.

Projektet shtesë në ekzekutim gjatë vitit 2005 që do të ndikojnë punën e ZRE-së do të jenë:

- BB (ESTAP III): AT “Themelimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) në Kosovë”, buxheti i alokuar: 0.8m US\$, data e fillimit të planit: qershor 2005, data e përfundimit: brenda 12 muajve kalendarik;
- AER: AT me qëllim të korporatizimit, të KEK-ut, kompanive të NQ-së në Prishtinë (Termokos) dhe Gjakovë;
- AER: AT me qëllim të mbështetjes dhe zbatimit të fazës së mëtutjeshme të themelimit të OST-së, duke përcjellë studimin e lartpërmendur të BB-së nën ESTAP III “Themelimi i OST-së”

Projekti i AER-it “Përkrahje e Ndërtimit Institucional të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë” takimi për fillimin e punës: 15 shkurt 2005; vlera e kontratës: përafërsisht. 1m EURO; kohëzgjatja: 12 muaj kalendarik) është projekti më i rëndësishëm, me qëllim kryesor ngritjen e kapacitetit institucional të ZRE-së, duke zhvilluar një kornizë stabile dhe të shëndoshë rregullative të nevojshme për të lehtësuar veprimin e tregut bazuar në principet e objektivitetit, transparencës dhe jo-diskriminimit brenda procesit të ECSEE.

Detyrat (7) kryesore përfshijnë:

Detyra 1: Aktivitetet për themelimin operacional të ZRE-së

- Përgatitja e procedurave për mbajtjen e Regjistrit Publik
- Ndihmohet ZRE-ja në definimin e masave të detyrueshme administrative dhe të gjobave administrative, të cilat duhet ti vendos ZRE-ja për të licencuarit të cilët i thejnë kushtet dhe konditat e licencës.
- Themelimi i sistemit të brendshëm të kontabilitetit, i cili është esencial në fazën fillestare të veprimeve.
- Asiston ZRE-në në përgatitjen e projekt dokumenteve dhe raportit financiar vjetor.

Detyra 2: Zhvillimi i modelit të tregut dhe rregullave të tregut

Konsultantët do të zhvillojnë një kornizë të plotë për zbatimin e Modelit të tregut me shumicë (treg i thjeshtë), i cili do të jetë në përputhje me ligjet e Kosovës, Direktivat e BE-së dhe Traktatin e Komunitetit të Energjisë.

Detyra 3: Tarifat, vënia e çmimeve dhe rregullimi i çmimeve

- Përgatitje e Rregullores për vendosjen e çmimeve dhe tarifave
- Zhvillimi i Metodologjive të tarifës
- Plani i zbatimit të Rregullores dhe metodologjisë
- Asistimi i ZRE-së në analizën e çmimeve

Detyra 4: Licencat

- Zhvillimi i kërkesave për të dhëna nga Licencuesit
- Asiston ZRE-në në lëshimin e Licencave për bizneset e reja / ndërmarrjet e energjisë

Detyra 5: Asistencë për ZRE-në në lëshimin e Autorizimeve dhe Lejeve dhe themelimin e sistemit të monitorimit të përmbushjes së tyre

- Asistencë në lëshimin e autorizimeve dhe lejeve
- Monitorim i përmbushjes
- Themelimi dhe monitorimi i rregullimit cilësor:

Detyra 6: Kodet Teknike/Operative

- Opsionet për kode
- Skicimi i Kodeve Teknike
- Shqyrtimi nga Rregullatori dhe aprovimi i kodeve teknike

Detyra 7: Trajnimi

- Vlerësimi i nevojave për trajnime
- Zhvillimi i programit trajnues gjithëpërfshirës
- Mbajtja e trajnimit

2.7 Sfidat dhe projektet kyçe për ZRrE-në për vitin 2005

Viti 2005 është viti i parë i plotë i veprimit të ZRrE-së, pas nxjerrjes së ligjit për themelimin e ZRrE-së.

Në përgjithësi siç është tipike për një rregullator të ri, ZRrE-ja do të fokusohet në zhvillimin dhe miratimin e dokumenteve të brendshëm dhe legjislacionit sekondar në sektorin e energjisë, procedurat e brendshme, stafit dhe trajnimit gjithëpërfshirës. Disa qëllime specifike, rreziqet e ndërlydhura dhe datat e planifikuara janë dhënë në tabelën 2.1.

Tabela 2.1: Qëllimet, Rreziqet dhe Datat e Planifikimit të aktiviteteve Kryesore të ZRrE-së në vitin 2005

Qëllimi specifik	Indikatorët e Përbushjes (Rreziqet)	Data e objektivit ³
Kompletimi i rekrutimit të stafit të ZRrE-së	I gjithë stafi (25) i rekrutuar	Maj 2005
Miratimi i dokumenteve interne të ZRrE-së	Statuti i ZRrE-së, Kodi i Etikës dhe Sjelljes	Korrik 2005
Adoptimi i Rregulloreve Sekondare ashtu siç përcaktohet në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë	Të gjithë artikujt përkatës (Rregulla për Licencim, Rregulla për çmime dhe Tarifa, Rregulla për Procedurën e zgjedhjes së kontesteve, Rregulla për Shkyçje dhe Rikyçje të Energjisë, Skema e Taksave dhe Kushtet e Përgjithshme për Furnizim të Energjisë) janë aprovuar nga Bordi i ZRrE-së	Korrik 2005
Metodologjitë e Tarifave për Energji Elektrike dhe Ngrohje Qendrore të përgatitura dhe të nxjerra nga ZRrE-ja	Metodologjitë e Tarifave janë lëshuar nga ZRrE-ja (Rr: i temë e avancimit të konsulentëve të AER-it)	Shtator 2005
Procedurat interne për ZRrE janë zhvilluar dhe implementuar	Manuali i veprimeve të ZRrE-së (dokument në rritje) i hartuar dhe përvetësuar	Drafti i parë, Prill 2005
Procedura e autorizimit për ndërtim të termocentralit të ri është përcaktuar në detaje	Procedura e përcaktuar nga ZRrE-ja në bashkëpunim me palët tjera të ndërlydhura (MEM, KPMM etj.)	Shtator 2005
Të gjitha ndërmarrjet e energjisë në Kosovë janë licencuar në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret	Numri i Licencave të lëshuara për ndërmarrjet e energjisë (Rr: lëndë e promovimit të përgjigjeve nga Ndërmarrjet dhe progresi i inkorporatizimit/shpërbërjes së KEK-ut)	Fillon: Dhjetor 2005
Atmosferë e përmirësuar e investuesve privat në sektorin e energjisë në Kosovë	Rekomandimet e studimit të implementuar të BB/ESTAP II, p.sh. të integruar në legjislacionin primar dhe sekondar	Sa më shpejt që është e mundur
Kodet e tjera teknike dhe Urdhëresat e përcaktuara me Ligj janë aprovuar nga ZRrE-ja	Numri / lloji i kodeve të aprovuara: p.sh. Kodi i Rrjetës, Kodi i Shpërndarjes, Kodi i Standardeve të Energjisë Elektrike, Kodi për Mbrojtjen e Konsumatorëve, Kodi i pajisjeve Elektrike, Kodi i Standardeve të Energjisë Elektrike, Kodi i Tregtisë, dhe Kodi i Matjes (Rr: i nënshtrohen progresit të ndërmarrjeve të cilat duhet të përgatisin dhe dorëzojnë kodet e tilla në ZRrE për komente dhe aprovim)	Fillon: vjeshtën e 2005
Është aprovuar hartimi i	Në përputhje me udhëzimet për hartim të tregut "rajonal" të	Vjeshtë 2005

³ Reflekton vlerësimin më të mirë të ZRrE-së, bazuar nga supozimet që Bordi i ZRrE-së është themeluar deri në prill të vitit 2005.

Qëllimi specifik	Indikatorët e Përbushjes (Rreziqet)	Data e objektivit ³
tregut standard "kombëtar" të energjisë elektrike	ofruara nga KERrE (CEER), skicimi i tregut lokal është përgatitur dhe miratuar	
Kosova është një partner aktiv në zhvillimin e Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore (KEEJL)	Pjesëmarrje e rregullt e ZRrE-së në grupin punues të KERrE (CEER) (SEER), Bordi i rregullatorëve dhe iniciativat e tjera rajonale (ERRA, SECI, SEETEC, BB etj.), janë përgatitur raportet e ndryshme krahasuese 'benchmarking' dhe planet aksionare ashtu siç është përcaktuar në draft Traktatin e KEEJL	Tashmë i implementuar
Mekanizmi i Tregtisë Ndërkufitare (CBT) është implementuar në Kosovë	ZRrE-ja monitoron zbatimin e tij (Ligjit) (Rr: varësisht nga pranimi i KEK-ut në SETSO)	Sa më shpejtë që është e mundur
Kontributi i ZRrE-së në zbatimin e hershëm të projektit për termocentralin e ri, duke përfshirë: hapjen e një miniere të re, ndërtimi i një TC për djegien e linjtit, linja e re 400 kW me Shqipërinë, një qendër e re dispecimi në OST-s.	ZRrE-ja është një anëtar aktiv i komitetit përgatitor për projektin e Termocentralit të ri (Rr: bashkëveprimi me aksionarët lokalë, MEM, Shtyllën e BE-së (AKM-n), KPMM, ZLK, etj.	Fillon: sa më shpejtë që është e mundur
Menaxhimi i kongestionit (ngarkesës) / është vendosur alokimi i ndërlidhjeve	ZRrE-ja monitoron zbatimin e tij (Ligjit) (varësisht nga aprovimi përfundimtar i metodave nga CEER dhe pranimi i KEK-ut në SETSO)	Sa më shpejtë që është e mundur në 2005
Themelimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit (TSO) në 2005	Ndarja e asetëve (pajisjeve), themelimi legal i TSO, ndarja e funksioneve, ndarja e tarifave etj. ZRrE-ja monitoron menaxhimin dhe llogaritë e ndara (Ligji). (lëndë e progresit të konsultantëve të AER dhe BB/ESTAP III)	Fillon; mesi i vitit 2005
Procedurat e zgjidhjes së kontesteve, kryer nga ZRrE	Forumi për zgjidhjen e çështjeve kontestuese i operativës së ZRrE-së (me kohë i aprovuar nga rregulla përkatëse nga Bordi i ZRRE-së)	Fillon: mesi i vitit 2005 dhe për 8 muaj
Tarifat e KEK-ut janë të ndara, përgatitja në metodologjitë e reja të aprovuara dhe aprovimi nga Bordi	Tarifat e reja janë të ndara dhe të krijuara për (1) Prodhimin me shumicë, (2) Shërbimet ndihmëse, (3) Rrjeti – TSO dhe DSO dhe (4) çmimin me pakicë për konsumatorët dhe tarifën "lifeline" (lëndë e progresit të konsultantëve BB/ESTAP III)	Fillimi; mesi i 2005 dhe për 8 muaj
KEK-u është i ndarë sipas planit të KEEJL	KEK-u i integruar vertikalisht është ristrukturuar legalisht, disa kompani të reja janë krijuar, me sa duket: OST, Minierat, Prodhimi (1-2), Distribucion (OSD+Furnizim) (Rr: varësisht nga progresi i konsultantëve të AER-it dhe konsultantëve të BB/ESTAP III)	Fundi i 2005
Janë emëruar Konsumatorët e parë të Privilegjuar në sektorin jo-shtëpiak	ZRrE-ja emëron konsumatorët e privilegjuar bazuar në kriteret e definuar nga MEM-i (Rr: progresi në MEM dhe varësisht nga progresi i themelimit të OST-së, ndarja e tarifave dhe aprovimi i kodit të rrjetit)	Start: end 2005

3. Rregullimi i Sektorit të Energjisë në Kosovë

ZRE-ja është e ngarkuar për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike, ngrohjes qendrore dhe gazit. Megjithatë, aktualisht në Kosovë nuk ka rrjetë të gazit dhe as ndonjë treg të gazit, megjithatë, sektori i energjisë elektrike dhe Ngruhja Qendrore (NQ) mbeten dy sektorët e vetëm të energjisë praktikisht për t'u rregulluar nga ZRE-ja në të ardhmen e shkurtër dhe të mesme.

Megjithatë, përpjekjet për themelimin e tregut të integruar të gazit natyror në tregun e rajonit të ECSEE-së përfshinë zhvillimet e infrastrukturës rajonale të gazit natyror. Për shkak të rëndësisë strategjike për rajonin, një numër i projekteve ndërkombëtare janë duke u përgatitur ose duke u

planifikuar. Si pasojë disa studime të realizueshmërisë për projektet e tilla gëzojnë përkrahjen financiare të KE-së. Në mesin e projekteve më të rëndësishme për Kosovën është projekti i gazsjellësit Turqi-Greqi-Bullgari-Maqedoni-Kosovë-Serbi-Austri (nëpër Hungari dhe/ose Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci).

Sektori i minierave dhe mineraleve, sipas rregulloreve të nxjerra kohëve të fundit nga UNMIK-u në janar 2005, është subjekt i rregullimit të Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve (KPMM). Sektori i Lëndëve djegëse të lëngshme kontrollohet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), pasi që kompetencat e Bordit Mbikëqyrës të Karburanteve që ishte aktiv deri në vitin 2003 u transferuan tek NJQRR-ja dhe më vonë tek MTI-ja.

3.1 Përshkrim i shkurtër i Sistemit të Energjisë


Resurset Primare

Prodhimi i energjisë në Kosovë është i bazuar në depozitat e linjtit shumë kalorik, të vlerësuar për mbi 10 miliardë ton. Depozitat e linjtit kanë përmbajtje të ulët të sulfurit dhe një proporcion atrakti të mbulesës së dheut dhe linjtit (1.7 m^3 të mbulesës dheu për një ton të linjtit), e që e bën mihjen shumë ekonomike.

Janë dy Miniera Sipërfaqësore ajo e Bardhit dhe e Mirashit që kanë operuar që nga 1963/64. Prodhimi i tyre është kryesisht për të furnizuar dy termocentralet termale për djegien e linjtit (TCT “A” & “B”) me kërkesë përafërsisht 6.5 milion ton/vit linjit. Sipas parashikimeve, minierat ekzistuese do të jenë tërësisht të shteruara deri në vitin 2007/2009, varësisht nga intensiteti i prodhimit dhe rezervat aktuale të linjtit në sferën e minierave të përmendura. Studimet e ndryshme kanë konstatuar që fusha e re e linjtit në Sibovc që planifikohet të hapet drejt në veri të minierave ekzistuese, i ka rezervat e nevojshme të linjtit që të sigurojnë furnizimin afat mesëm dhe atë afatgjatë me karburante për të dy TCT ekzistuese si dhe termocentralet e reja të planifikuara për blerje pas 2010 (deri në 2,000 MW shtesë).

Kërkesa për Energji Elektrike

Figura 6: Skenari i rritjes së kërkesës të energjisë elektrike (2000-2015)



ESTAP-I i përkrahur nga BB i përfunduar në tetor 2002, ka përgatitur disa skenarë të kërkesës së energjisë elektrike deri në vitin 2015. Parashikimet e zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike (KEK) në dy vitet e ardhshme kanë qenë të lidhura me SRM (Skenari i Rritjes Mesatare) dhe SRL (Skenari i Rritjes së Lartë), kanë rezultuar në një vlerë të rritjes mesatare vjetore prej 4.0%/deri 5.6%/a, respektivisht, për periudhën 2000-2015 (të gjitha këto pa gaz natyror në Kosovë). Megjithatë, një skenar tjetër (SRM-NM) është zhvilluar për rastin e “vazhdimit të status-quo-së” të humbjeve të mëdha dhe inkasimit të ulët. Kërkesa aktuale e energjisë elektrike ka shkuar duke u rritur deri në 8.5%/a gjatë 2000-2004, e cila përputhet mire me këtë parashikim pesimist, që reflekton realitetin e rëndë në Kosovë.

Humbjet e energjisë elektrike (teknike dhe tregtare) janë të tmerrshme. Prej sasisë minimale të 41.1% (në 2002) pas konfliktit, janë ngritur në sasinë maksimale prej 46.0% në 2004, nga e cila 26.4% janë vlerësuar të mos jenë humbje teknike.

Në vitin 2004, sasia e energjisë së pa-faturuar është vlerësuar në përafërsisht 62.4 milion EURO dhe humbjet për shkak të inkasimit të dobët, në 30.2 milion EURO shtesë ose humbjet e përgjithshme deri në 92.6 milion EUR. Efektiviteti i dobët tekniko-financiare e KEK-ut pas konfliktit (2000-2004) ka shkaktuar humbjen e të hyrave në përafërsisht 413 milion EURO (Burimi: MEM). Këto shifra, për fat të keq, konfirmojnë që kërkesa e energjisë në Kosovë ka ndjekur realisht parashikimin më negativ të BB-së (shih figurën 3.1).

Prodhi i Energjisë

Pas konfliktit, sistemi i energjisë në Kosovë është bërë pjesë e cunguar e sistemit ish Jugosllavisë. Sektori i energjisë në Kosovë operohet nga ndërmarrja publike vertikalisht e integruar – KEK. Si pjesë integrale e KEK-ut, janë pesë biznese themelore: minierat e linjitet, prodhimi i energjisë, transmetimi dhe dispeçimi, rrjeti i shpërndarjes dhe furnizimi. Kapaciteti më i madh formal i instaluar i bruto prodhimit është 1,513 MW (pesë blloqet e Kosovës A TTC – 65, 125, 2x200 dhe 210 MW, dy njësitë e Kosovës B TTC – 2x339 MW, dhe 2x17.5 MW në HDC Gazivodë/Ujman). Megjithatë, që nga fundi i shkurtit 2004, jo më shumë se një bllok i Kosovës A (A5 –net prodhimi prej 120 MW), 2x270-290 MW në Kosovën B dhe 35 MW në HCC ose përafërsisht 715 MW kanë qenë në dispozicion për të arritur kërkesën e kulmit të përafërt me 900 MW). Përkundrejt eksportimit të tepricave të natës, jo-fleksibiliteti i një prodhimi energjie elektrike me diagramin bazë të ngarkesës(diagrami konstant),KEK-u për energjinë e kulmit mbështetet në sistemet fqinje të elektro-energjetike. Neto importi i KEK-ut në vitin 2004 ka qenë 11.3% (445 GWh ose 15 milion EURO). Së fundi, si rezultat i pamjaftueshmërisë së kapaciteteve operuese të gjenerimit, ka pasur ende nevojë për reduktime, 5 orë me dhe 1 orë pa energji, çka është praktikuar shumicën e dimrit 2004/2005.

Transmisioni dhe Distribucioni i Energjisë

Rrjetet e Transmetimit dhe Shpërndarjes në Kosovë vuajnë që shumë vite nga mungesa e investimeve dhe mirëmbajtja e duhur e infrastrukturës që nuk mund të arrij aktualisht disa kërkesa të standardeve teknike, veçanërisht rrjeti i shpërndarjes, ka mungesë të kapacitetit për mbulimin si duhet të të gjitha kërkesat. Rrjetet e Kosovës vuajnë nga mungesa e kapaciteteve adekuate për të siguruar furnizim me energji elektrike të qëndrueshëm dhe sigurt. Në shumë pjesë të rrjetit të transmetimit kriteri i besueshmërisë “n-1”, nuk mund të aplikohet, çka në praktikë rezultojnë me ndërprerje të furnizimit të konsumatorëve. Kapaciteti që mungon në rrjetin e transmetimit është gjithashtu arsye për vlera më të vogla se ato standarde të tensionit, veçanërisht në rajonin e Pejës. Studimi ESTAP i (BB, tetor 2002) ka paraparë si prioritet të lartë ndërtimin e

nënstacionit të kapacitetit deri 400/110kV për këtë regjion. ST-ja gjithashtu vuan nga mungesa e posedimit modern të kontrollit dhe grumbullimit i të dhënave dhe sistemet menaxhuese të energjisë (p.sh. SCADA, EMS) dhe sistemet e telekomunikacionit.

Gjendja e rrjetit të shpërndarjes është edhe më e keqe. Rrjeti i shpërndarjes vuan nga linja e pamjaftueshme dhe kapacitetet e trafostacioneve, për uljen e mëtejme të tensionit, në tërë territorin e Kosovës. Nganjëherë operohet në kushte shumë të vështira duke rrezikuar shëndetin e operuesve dhe konsumatorëve. Përveç përtëritjes dhe zgjerimit të SD-së, perspektiva për SD, parashihet me prokurimin e pajisjeve moderne për matje, që lejojnë menaxhimin e anës së ngarkesës, dhe instalimin e softuer-it të specializuar për grumbullim dhe procesim të sasisë së madhe të të dhënave që prodhohen nga veprimet e rrjetit. Aktualisht, deficit kritike i SD-së mbeten humbjet e mëdha (teknike dhe tregtare) dhe inkasimi shumë i ulët.

Ristrukturimi i KEK-ut

Në formën e tanishme të integritit vertikal, KEK-u nuk përmbush kërkesat për reforma të sektorit të energjisë, veçanërisht në aspektin e Traktatit të ardhshëm të ECSEE-së. Projekti në vazhdim i korporatizimit i AER-it për TSO-s, (shih pjesën 4.2) do të përcaktojë elementet bazë të strukturës së re ligjore dhe institucionale të KEK-ut, sërish, brenda sferës së mundësive të tanishme. Çështja e pasqaruar ligjore e statusit të pronës së KEK-ut që vazhdon të jetë në administrimin e AKM-së mbetet kritike. Kjo ka ndikime negative në mobilizimin e fondeve publike për projektet për zhvillimin e KEK-ut. KEK-u nuk ka kapacitet kreditor.

Tarifat

Tarifat e Energjisë Elektrike të KEK-ut janë ende të pandara. Sistemi tarifar (shih tabelën 3.1) dallohet në mes të:

1. (8) grupeve Tarifore (konsumatorëve) të diferencuara sipas nivelit të tensionit të furnizimit (110 kV, 35 kV, 10 kV dhe 0.4 kV);
2. Lloji i grupit të konsumatorit (p.sh. industri dhe shtëpiake, tregtare, ndriçim publik – të gjithë marrin energji në 0.4 kV);
3. Niveli i konsumit për konsumatorët shtëpiak me shpenzim (p.sh. nën ose mbi 800 kWh/muaj);
4. matja e kohës gjatë ditës (tarifat e Larta dhe të Ulëta kohore gjatë ditës);
5. Sezonet (Sezoni i Lartë dhe i Ulët).

Si shtesë, sistemi i tanishëm ofron status të veçantë për të ashtuquajturit konsumatorët e paktë “direkt”(të mëdhenj). Çmimet përfshijnë ngarkesat (kërkesa) e rëndësishme (për kW) dhe ngarkesat për energji Aktive (për kWh) dhe Reaktive (për kVARh), varësisht nga grupi i konsumatorëve.

Sistemi i tanishëm i zbatuar nga KEK-u, është fuqizuar në korrik 2000, pasi DSHP/UNMIK ka kërkuar nga KEK-u që të rifillojë me faturim dhe inkasim për energji elektrike. Në parim, janë prezantuar struktura tarifore dhe marrëdhëniet midis grupeve individuale të konsumatorëve industrialë, ashtu siç janë përdorur në ish Jugosllavi për Kosovën në vitet '90-të. Megjithatë, pas përfundimit të konfliktit nuk është kryer asnjë vlerësim i mjeteve themelore dhe rishqyrtim i kostos në kushtet e ndërrimit fundamental të strukturës së grupeve të konsumatorëve. Që atëherë, sistemi tarifar i KEK-ut praktikisht ka mbetur i pandryshuar. ZRE-ja do të bëjë një shqyrtim të plotë, të Tarifave me Pakicë dhe vendosjen të Tarifave të ndara të Transmetimit në mes të vitit 2005, çka pritet të përfundohet deri kah fillimi i vitit 2006.

Tabela 3.1: Sistemi Tarifor i KEK-ut (gjendja në Mars 2003)

Nr. i grupit Tarifor 1)	Niveli tensionit të furnizimit 2)	Elementet tarifore të përdorur në KEK. Kalkulimt e divizionit të furnizimit 2)	Njësia	Koha-e-Dites 3)	Sezona Dimrore 4)	Sezona Verore 4	SD/SV Fuqia
					(EUROc/Njësi)	(EUROc/Njësi)	(-)
1	110 kV	Fuqia e angazhuar	kW		1,150	895	1.28
		Energjia Aktive (P), nga e cila:	kWh	- Tarifa e lartë	2.68	2.11	1.27
			kWh	- Tarifa e ulët	1.34	1.09	1.23
		Energjia reaktive (Q)	kVArh		1.41	1.15	1.23
2	35 kV	Fuqia e angazhuar 5)	kW		1,278	959	1.33
		Energjia Aktive (P), nga e cila:	kWh	- Tarifa e lartë	3.20	2.56	1.25
			kWh	- Tarifa e ulët	1.60	1.28	1.25
		Energjia reaktive(Q)	kVArh		1.28	0.96	1.33
3	10 kV	Fuqia e angazhuar 5)	kW		1,278	959	1.33
		Energjia Aktive (P), nga e cila:	kWh	- Tarifa e lartë	3.52	2.81	1.25
			kWh	- Tarifa e ulët	1.76	1.41	1.25
		Energjia reaktive(Q)	kVArh		1.28	0.96	1.33
4	0.4 kV (amvisri nën 800 kWh/m dhe spitalet)	Fuqia e angazhuar 6)	kW		144	115	1.25
		i) Energjia Aktive (P),(P)	kWh	Një tarifor	3.99	3.20	1.25
		ii) Energjia Aktive (P), nga e cila:	kWh	- Tarifa e lartë	4.80	3.83	1.25
			kWh	- Tarifa e ulët	2.40	1.92	1.25
5	0.4 kV (amvisri mbi 800 kWh/m)	Fuqia e angazhuar 6)	kW		192	144	1.33
		i) Energjia Aktive (P)	kWh	Një tarifor	6.39	4.80	1.33
		ii) Energjia Aktive (P), nga e cila:	kWh	- Tarifa e lartë	7.67	5.75	1.33
			kWh	- Tarifa e ulët	3.83	2.88	1.33
6	0.4 kV Kategoria I	Fuqia e angazhuar	kW		852	631	1.35
		Energjia Aktive (P), nga e cila:	kWh	- Tarifa e lartë	5.11	3.83	1.33
			kWh	- Tarifa e ulët	2.56	1.92	1.33
		Energjia reaktive (Q)	kVArh		1.28	0.96	1.33
7	0.4 kV Kategoria II	Fuqia e angazhuar I *)	kW		253	189	1.34
		Fuqia e angazhuar II **)	kW		95	70	1.36
		i) Energjia Aktive (P)	kWh	Një tarifor	7.57	5.68	1.33
		ii) Energjia Aktive (P), nga e cila:	kWh	- Tarifa e lartë	9.47	6.94	1.36
8	Ndriqimi publik (0.4 kV)		kWh	- Tarifa e ulët	5.05	3.79	1.33
		Energjia Aktive (P),(P)	kWh	Një tarifor	8.21	6.31	1.30

Vërejtje: *) njehsorët një-tariforë, **) njehsorët dy-tariforë.

Janë 8 grupe tarifore të dalluar për nga niveli i tensionit (110 kV, 35 kV, 10 kV, 0.4 kV), grupi i konsumatorëve (p.sh. shtëpiakët, komercialët – të dy në 0.4 kW), dhe niveli i konsumit (p.sh. nën dhe mbi 800 kWh).

Konsumatorët furnizohen nga 4 nivelet e tensionit : 110 kV (përmes rrjetit të 7 të distribucioneve të KEK-ut, konsumatorët e brendshëm të KEK-ut (Mirashi, Bardhi, objektet e veçanta të KEK-ut (objekti i tharjes së thëngjillit dhe ai i ngrohjes industriale) dhe konsumatorët e mëdhenj "direkt": Fabrika Shar çimento, sistemi Trepça, Feronikeli i Glogovcit etj.), 35 kV dhe 10 kV (kryesisht objektet e industrisë dhe ato të tjera brenda 35/0.4 kV të tyre dhe 10/0.4 kV S/Ss), dhe 0.4 kV (komercialë, shtëpiakët).

Tarifa e lartë (TL: 8 e mëngjesit – 10 e mbrëmjes, Tarifa e Ulët (TU: 0 e mëngjesit- 8 e mbrëmjes dhe 10 e mbrëmjes – 12 e mbrëmjes, Një tarifor (NJT): 0e mëngjesit – 12e mbrëmjes.

Sezoni i Dimrit (SD): 1 Tetor - 31 Mars, Sezoni i Verës (SV): 1 prill - 30 shtator.

Në rast kur një "maksigraf" është instaluar (i cili regjistron 15 min. matjet dhe regjistron vlerën më të lartë të fuqisë brenda muajt), fuqia e angazhuar (ose e ashtuquajtura gjithashtu ngarkesa)

paguhet në përputhje me atë vlerë. (në fund të muajit, p.sh. kur njehsorët lexohen përsëri, maksigrafi kthehet në “zero”).

Kur nuk ka maksigraf të instaluar, kërkesa e ngarkuar kalkullohet nga sasia e energjisë së konsumuar në Tarifën e Lartë të ndarë për 100.

Vërehet që konsumatorët komercial të cilët konsumojnë sasi të konsiderueshme të energjisë reaktive. Atyre ju kërkohet që të mirëmbajnë shpenzimet minimale phi të 0.95.

Konsumatorët pa njehsor të duhur të energjisë elektrike janë të ngarkuar me vlerën fikse varësisht nga konsumi i energjisë së vlerësuar në muaj: (i) më pak se 400 kWh/m - 20 EURO, (ii) në mes 400 dhe 800 kWh/m - 36 EURO, mbi 800 kWh/m - 61 EURO. Punëtorët e shpërndarjes të KEK-ut vizitojnë konsumatorin dhe llogarisin konsumin bazuar në llojin dhe numrin e përdorimit të pajisjeve shtëpiake dhe faktorët standard (teknik) të ko incidencës së përdorimit të këtyre pajisjeve.

3.2 Përshkrim i shkurtër i Sistemit të Ngrohjes Qendrore

Spektori i Ngrohjes Qendrore (NQ) në Kosovë është relativisht i ri dhe i limituar në vetëm 3 lokacione gjeografike (Prishtina, Gjakova dhe Mitrovica), ku furnizojnë vetëm 5 % të kërkesës për ngrohje në Kosovë. Ngrohja qendrore në Kosovë përdoret veçanërisht për ngrohjen e hapësirave dhe nuk përfshin furnizimin me ujë të ngrohtë, e cila është edhe arsyeja se pse ndërmarrjet e energjisë nuk operojnë gjatë gjithë vitit. Gjithashtu gjatë sezonit të ngrohjes (15 Tetor – 15 Prill), ndërmarrjet e ngrohjes operojnë me ndërprerje gjatë natës.

Edhe pse sektori i Ngrohjes është i vogël dhe ballafaqohet me vështirësi serioze, humbje (teknike dhe financiare) dhe nivel të ulët të pagesës, megjithatë luan një rol të rëndësishëm në strategjinë e energjisë në Kosovë, kryesisht për të zëvendësuar konsumin e pakontrolluar të energjisë elektrike për qëllim të ngrohjes së hapësirave .

Spektori i ngrohjes qendrore në Kosovë përbëhet nga tri sisteme të NQ-së që mbulojnë komunat e Prishtinës, Gjakovës dhe Mitrovicës. Karakteristikë e përbashkët e këtyre sistemeve është se përbëhen nga ngrohoret dhe rrjetet e shpërndarjes dhe janë kryesisht në “pronësi” dhe operohen nga kompani komunale të integruara vertikalisht, statusi ligjor dhe pronësor i të cilave është Ndërmarrje Publike (NP). Dy nga to (Termokosi, Prishtinë dhe Ngrohitorja, Gjakova) janë në proces të inkorporatizimit.

Prodhimi i ngrohjes bëhet në ngrohoret qendrore të pajisur me kaldaja që përdorin si karburant kryesisht mazutin dhe naftën (dizel D2) në masë më të vogël.

Rrjetet e shpërndarjes të përbëra nga rrjeti primar, nga ngrohitorja deri tek pika e furnizimit në nënstacion, dhe rrjet(et) sekondare, nga pika e furnizimit – instalimet e brendshme të ndërtesave.

Rrjetet e ngrohjes qendrore po transformohen nga sistemet e rrjedhjes konstante në atë të sistemeve të rrjedhjes variable.

Të dhënat kryesore teknike dhe të konsumatorëve për secilin sistem të NQ-së, janë dhënë në tabelat 3.2-3.3.

Kompani (Qyteti)	Kapaciteti i Instaluar (MW)	Rrjeti i Distribution		Gjenerimi i ngrohjes (MWh / year)			Ngrohja e Dërguar tek Konsumatorët SSh (MWh/y)		
		Gjatësia e Kanalit (km)	Nr. i nënstacioneve	2001 / 02	2002 / 03	2003 / 04	2001 / 02	2002 / 03	2003 / 04
TERMOKOS (Pristina)	2 x 58 = 116 1 x 29 = 29 2 x 7 = 14	28	243	83,174	71,585	96,790	62,380	53,689	72,593
Nëntotali	159	28	243	83,174	71,585	96,790	62,380	53,689	72,593
DHC (Gjakova)	1 x 20.0 = 20.0 1 x 18.6 = 18.6	12	62	16,530	17,901	18,274	13,224	14,321	14,619
Nëntotali	38.6	12	62	16,530	17,901	18,274	13,224	14,321	14,619
TERMOMIT (Mitrovica)	1 x 9.3 = 9.3 2 x 3.3 = 6.6 1 x 1.0 = 1.0	4	20	nn	nn	nn	nn	nn	nn
Nëntotali	16.9	4	20	nn	nn	nn	nn	nn	nn
Totali	214.5	44	325						

Tabela 3.2: Karakteristikat kryesore teknike të (3) sistemeve të NQ-së

Tabela 3.3: Të dhënat e konsumatorëve dhe tarifat e NQ-së

Kompania (Qyteti)	Grupi i Konsumatorëve	2001 /02		2002/03		2003/04		2004/05	
		Sipërfaqja e Ngrohjes (m ²)	Tarifa (€ / m ²)	Sipërfaqja e Ngrohjes (m ²)	Tarifa (€ / m ²)	Sipërfaqja e Ngrohjes (m ²)	Tarifa (€ / m ²)	Sipërfaqja e Ngrohjes (m ²)	Tarifa (€ / m ²)
TERMOKOS (Pristina)	Household	442,908	0.80	442,908	0.90	581,927	0.90	606,132	0.85
	Com. & Public	348,698	1.20	348,698	1.30	397,626	1.30	409,029	1.10
	Total	791,606		791,606		979,553		1,015,161	
DHC (Gjakova)	Household	42,260	0.80	36,400	0.80	42,778	0.80	56,548	0.82
	Com. & Public	39,208	1.20	48,542	1.20	52,590	1.20	56,409	1.25
	Total	81,468		84,942		95,368		112,955	
TERMOMIT (Mitrovica)	Household	-	-	-	-	-	-	-	-
	Com. & Public	13,000	1.20	13,000	1.20	13,000	1.20	13,000	1.20
	Total								

3.3 Statistikat Kyçe të Sektorit të Energjisë

Karburantet për Prodhimin e Energjisë

Lënda djegëse kryesore e përdorur për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë është thëngjilli - ligniti. Ekzistojnë dy minjera që furnizojnë termocentralet me lignit: Mirashi dhe Bardhi. Në vitin 2004, prodhimi total i thëngjillit për termocentralet ka qenë 5,758,369 ton.

Tabela 3.4 (dhe Figura 3.2): Kapacitetet kryesore për prodhimin e energjisë të instaluar në Kosovë

Centrali Prodhues	Blloku	Kapaciteti i instaluar	% Totale e Prodhimit
Kosova A			
	A1	65	4.3
	A2	125	8.3
	A3	200	13.2
	A4	200	13.2
	A5	210	13.9
Kosova B			
	B1	339	22.4
	B2	339	22.4
HC Ujmani			
	G1	17.5	1.2
	G2	17.5	1.2
Total		1513	




Tabela 3.5 (dhe Figura 3.3): Prodhimi i Energjisë Elektrike në 2004

Prodhimi i Energjisë Elektrike, 2004				
Centrali Prodhues	Blloku	Prodhimi Në [GWh]	Prodhimi %	Disponueshmëria Kohore %
Kosova A				
	A1	6.3	0.2	2.8
	A2	0	0.0	0
	A3	320.6	8.3	32.7
	A4	130	3.3	14.1
	A5	519.2	13.4	54.1
Kosova B				
	B1	1587.5	40.9	67.4
	B2	1207.4	31.1	53
HC Ujmani				
	HC	113.3	2.9	
ShA K.TH.	KTH	0.8	0.0	
Prodhimi total		3,885.1		




Tabela 3.6 (dhe Figura 3.4 dhe 3.5): Bilansi i Energjisë Elektrike (2004)

Të dhënat e elektricitetit për bilanci energjetik, viti 2004

ELECTRICITY		[GWh]
Furnizimi		
Importi		3268
Exporti		-2820
Importi Neto		448
Prodhimi (bruto)		3885
Konsumi vetanak i Centraleve		-401
Humbjet në Transmisioni dhe Distribucion		-1881
Humbjet në Transmision		-171
Humbjet në Distribucion		-1710
Energjia në Disponim		2051
TKF (Total Konsumi Final)		2051
Kërkesa		
Industri		248
Konsumatorët Direkt		72
Kons. Intern (konsumi vetanak) KEK		23
Industria e lidhur në 35 kV dhe 10 kV		153
Sektorët tjerë		1803
Komercial dhe publik		313
Armvisri		1490




Figura 3.6: Ndarja sipas Energjisë së shpërndarë Sistemit të Distribucionit (SD). 2004




Figura 3.7: Prodhimi Indingjen i energjisë elektrike dhe Konsumi gjatë muajve të vitit 2004 (MWh)




Tabla 3.7: Të dhënat kyçe teknike të Sistemit të Transmisionit (ST) dhe Sistemit të Distribucionit (SD)

Kapacitetet e Transmisionit të ST-s dhe SD-s	Niveli i Transformimit çkV]	Kapaciteti i Transmisionit çMVA]
Sistemi i Transmisionit	400/220	1200
	220/110	1000
	220/35	400
Sistemi i Distribucionit	110/35	788
	110/10	378
	35/10	813.7
	35/6	98

Gjatësia e rrjeteve të ST0 SD	Niveli i Tensionit (kV)	Linjat (km)	Kabllot (km)
Rrjeti i Transmisionit	400	183	0
	220	354	0
	110	625	0
Sistemi i Distribucionit	35	639.5	10.5
	10	3971	172

Tabela 3.8: Numri i konsumatorëve sipas llojit të kategorisë dhe nivelit të tensionit të kçjes

Type of Customers	Connected at the Voltage Line (kV)	Number of Customers
1. Non-household (Industry)	110	3
2. Non-household (industry)	35	13
3. Non-household	10	221
4. Non-household I category	0.4	744
5. Non-household II category (one tariff meters)	0.4	20,624
6. Non-household II category (two tariffs meters)	0.4	20,266
7. Public lighting	0.4	349
8. Household (two tariffs meters)	0.4	206,824
9. Household (one tariff meters)	0.4	59,614
10. Household (flat rate tariffs)	0.4	10,015
TOTAL		318,670

Vërejtje: Duke përjashtuar konsumatorët në enklavat Serbe

Tabela 3.9: Faktorët që ndikojnë në realizueshmërinë financiare të KEK-ut – shkalla e Faturimit dhe Inaksimit, Humbjet e përgjithëshme (2004)

Indicator	(GËh)	%	EUR (million)
1. Gross Consumption of DS	3665.7	100	
a. Cons. of customers (Energy billed of DS)	1956.2	53.4% of 1	121.47
Vlera e Inkasimit	1232.4	63% of a	76.52
b. Humbjet e Sistemit të Distribucionit	1709.5	46.6% of 1	51.2

Tabla 3.10: Sipërfaqja e Ngrohur, Faturimi dhe Inkasimi i (3) Sistemeve të NQ-së (2003/2004)

Sezona e Ngrohjes 2003/2004		Kapaciteti i Instaluar [MW]		Prodhimi Bruto [MWh]	Gjatsia e rrjetit të N. Q. [km]	Numri i Nënsta- cioneve
Ngrohja Qendrore (NQ)	Kazani		%			
Termokos, Prishtinë		159	74.1	96790	28	243
	1	58	27.0			
	2	58	27.0			
	3	29	13.5			
NQ Spitali, Prishtinë	1	7	3.3			
	2	7	3.3			
NQ Gjakova		38.6	18.0	18274	12	62
	1	20	9.3			
	2	18.6	8.7			
Termomit		16.9	7.9	nn	4	20
Spitali	1	9.3	4.4			
	2	3.3	1.5			
	3,4	4.3	2.0			
Totali		214.5	100	115064	44	325

Tabela 3.11: Karakteristikat Teknike të Sistemit të (3) NQ-ve

Sezona Ngrohëse 2003/2004	Hapsira Ngrohëse [m²]	Faturimi [Euro]	Inkasimi [Euro]	%
Konsumatorët				
Termokos, Prishtinë				
Amvisri	581 927	2,427,265	466,480	19.2
Komercial & Publik	397 626	2,095,427	1,345,649	64.2
Total	979 553	4,522,692	1,812,129	40.1
NQ Gjakova				
Amvisri	42 778	196,776	64,276	32.7
Komercial & Publik	52 590	413,676	229,055	55.4
Total	95 368	610,452	293,331	48.1
Termomit - Mitrovicë				
Amvisri	0			
	13 000			
Total	13 000			

3.4 Bilanci i energjisë dhe planifikimi afatgjatë

Ligji për Energji Nr. 2004/8 ashtu siç përcaktohet në Nenin 6, përcakton detyrimin për miratimin e Planifikimit Afatgjatë dhe Vjetor të KEK-ut (Bilanci i Energjisë) nga MEM-i, i cili është një institucion i ngarkuar me detyrën që të lëshoj rregullative përkatëse për kompletimin e Bilancit të Energjisë. Parashikimet i bilancit të energjisë sipas dispozitave të lartpërmendura të Ligjit, qofshin ato afatgjata ose vjetore, duhet të përgatiten nga OST-ja (TSO) dhe pas konsultimeve me ZRrE-në, i dorëzohen MEM-it për miratim përfundimtar.


Aktualisht, parashikimi për Bilancin Afatgjatë të energjisë, tashmë është bërë nga AT e BB-së (ESTAP I) dhe ka përfunduar në tetor 2002, për kohën e paraparë deri në vitin 2015.

Planifikimi afatgjatë është gjithashtu pjesë e dokumentit të "Rëndësisë së Lartë" (White Paper), të quajtur "Strategjia e Energjisë së Kosovës", themelet e së cilës tashmë janë përgatitur në fillim të vitit 2003. Me disa përmirësime të vogla muajve të ardhshëm, dokumenti duhet të miratohet nga Qeveria në mes të vitit 2005. Detyra më e rëndësishme është, se çdo Bilanc afatgjatë i miratuar i Energjisë, duhet të shqyrtohet në periudha të shkurtra kohore (p.sh. pas dy ose tri vjetësh).

ZRrE-ja (edhe pse nuk janë themeluar të gjitha kushtet që janë të përcaktuara në Kornizën Ligjore) dhe në bashkëpunim me KEK-u, ka përcaktuar një grup kriteresh të përkohshme për përgatitjen dhe dorëzimin e Bilancit Vjetor të Energjisë për vitin 2005. ZRrE-ja e ka dhënë pëlqimin e vet për versionin përfundimtar të Bilancit të Energjisë, në shkurt të vitit 2005. Njëkohësisht, ZRrE-ja ka shprehur shqetësimin e saj për disa elemente që mund të kenë ndikim jo të favorshëm në zbatim të bilancit të propozuar të energjisë. Megjithatë, bilanci i energjisë në fjalë është vështruar si më gjithëpërfshirësi i përgatitur nga KEK-u në periudhën e pasluftës në Kosovë.

Është menduar që rregullorja e re për Parashikimin e Bilancit të Energjisë, e cila do të nxirret nga MEM-i në të ardhmen e afërt, mund të krijojë kushte të favorshme për një Afat të gjatë dhe planifikim vjetor për furnizimin me energji në të ardhmen. ZRrE-ja do të vazhdojë të bëjë përpjekjet e saj më të mira për të përkrahur në të ardhmen, sistemin e energjisë në bashkëpunim me faktorët tjerë.

Figura 3.8: Bilanci i Energjisë së prodhuar, konsumi, Importi dhe eksporti (MWh) për vitin 2005



3.5 Legjislacioni Dytësor Kryesor (Rregulla, Dekrete, Kode) që do të nxirren nga ZRrE-ja

Që të implementohet Ligji për Rregullatorin, ZRrE-ja do të nxjerrë, miratojë dhe implementojë: Rregullat, Urdhëresat dhe Dekretet, (legjislacionin sekondar). Rregulla të tillë janë të definuar në Ligjin e Rregullatorit të Energjisë, si në vazhdim:

- **Statuti** (Rregull i cili udhëheq veprimin e ZRrE-së, duke përfshirë aktivitetet e zyrës, strukturën e zyrës, procedurat e punësimit të stafit drejtues dhe administrativ, dhe çështjet që lidhen me organizimin e punës);
- **Kodi i Etikës dhe Sjelljes** (dispozitat e aplikueshme për anëtarët e Bordit dhe punëtorët e tjerë, për të siguruar që ata përmbushin detyrat e tyre në mënyrë të ndershme dhe me aftësi, duke mënjeluar konfliktet aktuale të interesit ose ato që mund të shfaqen më vonë);
- **Rregulli i Licencimit** (kriteri për lëshimin, detyrimet dhe të drejtat e ndërmarrjeve të energjisë, dhe procedurat për monitorim që t'i mundësojë ZRRE-së të sigurojë konkurrencë efektive, jo-diskriminuese dhe funksionim efikas të tregut të energjisë);
- **Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji** (dispozitat e nxjerra për të përshkruar kushtet e furnizimit me energji për të gjithë konsumatorët, e drejta për “shërbim të barabartë” dhe standardet e shërbimit);
- **Rregulla për Shkyçje dhe Rikyçje të Energjisë** (dispozitat për të siguruar përmbushje transparente dhe jo-diskriminuese të shkyçjeve dhe rikyçjeve nga ndërmarrjet e energjisë, dhe mbrojtja e konsumatorëve përmes promovimit të qasjes së hapur të informatave për shkyçje dhe rikyçje në rrjete);

- **Rregulla për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve** (dispozitat në lidhje me zgjedhjen e kontesteve në mes konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë, operuesve të sistemit dhe ndërmarrjeve të energjisë, dhe në mes të dy ndërmarrjeve të energjisë);
- **Skema e Taksave** (definojnë metodën e pagesës së taksave vjetore dhe ngarkesave të tjera për lëshimin e licencave, lejeve, vërtetimeve dhe zgjedhjeve të mosmarrëveshjeve);
- **Rregulli për Çmime dhe Tarifa** (dispozitat që sigurojnë që kushtet dhe metodat e llogaritjes së çmimeve dhe tarifave për energji elektrike ose ngrohje janë objektive, transparente, dhe jo-diskriminuese).

Që nga fundi i shkurtit 2005, të gjitha rregullat e lartpërmendur janë duke u përgatitur. Tashmë janë përgatitur draftet e para nga ZRrE-ja, me ndihmën e ofruar nga konsultantët e ngarkuar prej USAID-it, AER, Sida dhe prej shtyllës së BE-së, dhe do të miratohen nga bordi i ZRrE-së me procedura të konsultimit publik të përcjella me seanca të dëgjimit publik.

Të gjitha Rregullat do t'u nënshtrohen procedurave të konsultimit publik, të publikuara në website-in e ZRrE-së, pastaj komentet mund të diskutohen me të gjitha palët e interesuara në takime publike dhe të miratohen në mënyrë transparente dhe të hapur, në mënyrë të pavarur nga ndikimet e jashtme politike, industriale ose të tjera ashtu siç janë paraqitur në Kapitullin 6 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

ZRrE-ja ka mandat për të aprovuar Kodet Teknike të nxjerra nga operatorët e rrjetit (të quajtur Kodi i Rrjetit, Kodi i Shpërndarjes, Kodi i Matjes, Kodi i Kyçjes dhe i Përdorimit, Kodi i NQ-së). Kodet kanë rregulla themelore dhe qarkore që themelojnë dizajnin minimal teknik, kyçjen dhe shfrytëzimin e rrjeteve, kërkesat operative, dhe standardet e energjisë. Në përputhje me Ligjin për Energji Elektrike, operatorët e rrjetit dhe të tjerë, do të përgatisin gjithë kodet, duke përfshirë kodin e standardeve të energjisë elektrike, kodin për përkujdesjen ndaj konsumatorëve, kodin për tregti dhe rregullat për qasje, dhe më pas do të shqyrtohen dhe aprovohen nga ZRrE-ja. Ky proces përbën një burim shqetësimi për ZRrE-në pasi nuk ka filluar ende (edhe pse është menduar se përgatitja e Kodeve do të intensifikohet pas lëshimit të licencave). Me qëllim që të ndihmohet në procedura, ZRrE-ja aktualisht po bën përgatitje për një letër "skicë" për secilën nga kodet e lartpërmendura.

3.6 Mbrojtja e të Drejtave të Konsumatorëve – Direktivat Administrative

Direktivat e BE-së 2003/54/KE dhe 2003/55/KE formulojnë të drejtat e mbrojtjes së konsumatorëve:

- "Shtetet anëtare do të sigurojnë nivele të larta të mbrojtjes së konsumatorëve, veçanërisht për sa i përket transparencës në lidhje me kushtet dhe afatet e kontraktimit, informatat e përgjithshme dhe mekanizmat e zgjedhjes së kontesteve." (Neni 3(5))
- Shtetet Anëtare do të sigurojnë ...veçanërisht mbrojtjen ndaj **konsumatorëve të varfër**, duke përfshirë masat për t'i ndihmuar ata që të mënjanojnë shkyçjen. ... Shtetet anëtare mund të marrin masa për të mbrojtur konsumatorët e fundit në rajonet e largëta. (neni 3(5))
- Shtetet Anëtare do të sigurojnë që të gjithë konsumatorët shtëpiakë ... të gëzojnë shërbim universal, që është e drejta e tyre për t'u furnizuar me energji elektrike të kualitetit të specifikuar brenda territorit, me çmime të arsyeshme, të qarta dhe të krahasueshme në mënyrë transparente.

- ... Shtetet anëtare do t'u imponojnë kompanive të shpërndarjes detyrim që të kycin konsumatorët në rrjetet e tyre sipas afateve, kushteve dhe tarifave të vendosura në përputhje me procedurat e parashtruara në Nenin 23(2). (Neni 3(3))
- " Shtetet Anëtare do të sigurojnë që konsumatori i privilegjuar është në fakt në gjendje që të kalojë tek një furnizues i ri ".
- 'Asgjë në këtë Direktivë nuk duhet të parandalojë Shtetet Anëtare që të përforcojnë pozitën e tregut të konsumatorëve shtëpiakë, të vegjël dhe të mëdhenj, duke ju promovuar mundësitë e bashkimit të tyre vullnetar për të përfaqësuar këto kategori konsumatorësh.'

Masat e mbrojtjes së konsumatorëve janë përshkruar në Aneksin A të Direktivës 2003/54/KE.

Ligjet e Kosovës (Ligji i Energjisë, Ligji për Energji Elektrike, Ligji për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorëve), janë në përputhje me Direktivat e BE-së, dhe formulojnë të drejtat e konsumatorëve në Kosovë.

Të drejtat themelore të Konsumatorëve

Neni 3 i Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, rregullon të drejtat themelore të konsumatorëve:

- a) të drejtën për të mbrojtur interesin publik të konsumatorëve;
- b) të drejtën për shëndet, pajisje, dhe mbrojtje të jetës;
- c) të drejtën për mbrojtje ligjore të konsumatorëve
- d) të drejtën për informim dhe edukim të konsumatorëve
- e) të drejtën për tu organizuar në shoqatat e konsumatorëve me qëllim që të mbrohen interesat e konsumatorëve dhe të drejtën për përfaqësim të konsumatorëve në punë të organeve që merren me çështjet e interesit të konsumatorëve.

Neni 52 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë formulon të drejtat e konsumatorëve për shërbimet e energjisë:

52.1: të gjithë konsumatorët e fundit do të kenë të drejtë që të gëzojnë shërbime të njëjta të furnizimit me energji..., atëherë kur të jetë teknikisht dhe ekonomikisht e mundur.

52.3. të gjithë konsumatorët e fundit do të kenë të drejtë të kenë marrëdhënie transparente kontraktuese me furnizuesit e energjisë, sipas Kushteve të Përgjithshme të Furnizimit të Energjisë.

Mbrojtja e Konsumatorëve

Neni 29 i Ligjit për Mbrojtje të Konsumatorëve: Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, do të bëjë mbrojtjen e konsumatorëve duke detyruar zbatimin e këtij Ligji për prodhim, tregti ose të drejtë të shërbimeve.

Neni 2 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë: ...korniza rregullative për sektorin e energjisë do të sigurojë: ... e) që konsumatorët dhe të licencuarit, të jenë të mbrojtur me procedura të përshtatshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;

UA 2002/19 për Shkycjen e Shërbimeve të Energjisë Elektrike, dhe UA 2002/20 për Pagesë të Borxheve për Shërbimet e Energjisë Elektrike nuk janë në kontradiktë me direktivat e BE-së dhe Ligjet e Kosovës për mbrojtjen e Konsumatorëve.

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve (DMK) i ZRrE-së, është përgjegjës që të sigurojë aplikimin e legjislacionit të lartpërmendur për mbrojtjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë së Kosovës. DMK-ja është themeluar në mesin e muajit dhjetor 2004, dhe në mënyrë aktive është inkuadruar në detyrat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorëve:

- pjesëmarrje aktive në përgatitjen e drafteve të legjislacionit sekondar: Rregulli për Shkyçjen e Konsumatorëve, Rregulli për Procedurat e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, dhe Kushteve të Përgjithshme për Furnizim me Energji GCES;
- Analizimin e të dhënave të marra nga KEK-u, duke u fokusuar në ankesat e konsumatorëve;
- Pjesëmarrje aktive në shqyrtimin e procedurave të KEK-ut për: Shkyçje, Zgjidhje të Borxheve, Zgjidhje të Mosmarrëveshjeve, Dënime, Gjoha etj, për të siguruar që procedurat janë jo-diskriminuese dhe që të gjithë konsumatorët trajtohen në mënyrë të njëjtë;
- Koordinim i aktiviteteve me Zyrën për Mbrojtje të Konsumatorëve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në përpjekje për të themeluar Shoqatën e Konsumatorëve.

3.7 Metodat e Rregullimit

Para shqyrtimit të strategjive dhe metodave specifike të Rregullimit, ashtu siç do të aplikohen në sektorin e Energjisë në Kosovë, ja vlen që të përsëriten disa parime themelore që përbëjnë qëllimin dhe rolin e Rregullimit.

Një ndër interpretimet më të pranueshme të asaj se “çfarë është Rregullimi”, është thënia Selznickut⁴ për rregullimin, si: “një kontroll i qëndrueshëm dhe i fokusuar, i ushtruar nga agjencitë publike për aktivitetet që vlerësohen nga komuniteti”

Rregullimi është një çështje që ka interes të stimuluar në një mori të disiplinave – veçanërisht në ligje, inxhinieri, ekonomi, shkenca politike, sociologji, histori, psikologji dhe administrim shoqëror. Kjo është një temë që më shumë se çdo gjë tjetër ka nevojë për qasje shumë-disiplinore. Të japim një shembull: nëse ekonomistët do të shpiknin skema teknike superiore të rregullimit kjo do të ishte pak e dobishme nëse nuk do ti kushtohej vëmendje vërejtjeve të atyre shkencëtarëve politik dhe sociologëve të cilët i kanë theksuar arsyet se pse, në botën reale, këto skema nuk do të prodhonin rezultatin e pritur nga ekonomistët. Në të njëjtën mënyrë, duke parë mundësitë e zbatimit të këtyre skemave, do të merreshin në konsideratë këshillat e juristëve në lidhje me kufizimet e rregullave të ndryshme dhe proceseve të zbatimit.

Roli i Rregullatorëve

Rregullimi, veçanërisht në sektorin e energjisë, është mjet për të arritur rezultatin. Direktivat Evropiane 2003/54&55 për tregjet e energjisë elektrike dhe gazit theksojnë që Shtetet Anëtare kanë detyrë të përgjithshme që “në bazë të organizimit të tyre institucional të sigurojnë, që marrëveshjet për energji elektrike dhe gaz natyror, të operohen në përputhje me dispozitat e kësaj direktive, me qëllim që të arrihet një treg i qëndrueshëm dhe konkurrues për energji elektrike dhe gaz natyror”. Si pasojë shtetet anëtare japin përgjegjësi për një numër të vendimeve të autoriteteve “rregullative” ose “kompetente” të përcaktuara. Kjo implikon një detyrim të autoritetit rregullativ për t'i detyruar burimet e duhura njerëzore dhe financiare që të kryejnë detyrat e tyre dhe të kenë qasje në të gjitha informatat, për të cilat ka nevojë kompania, qofshin ato financiare ose teknike.

⁴ “P. Selznick” Focusing Organizational Research on Regulation, in R. Noll (ed) (Berkeley, Calif. 1985)

Ashtu siç është paraqitur më herët, efektet e monopoleve, në krahasim me konkurrencën e përkryer, janë: rezultate të dobëta, çmime të larta dhe transferim i të ardhurave nga konsumatorët tek prodhuesit. Një përgjigje për monpolet e mundshme, është që të përdoret konkurrenca (krijohet “tregu”) megjithëse aty ku ekziston një “monopol natyror”, ekziston edhe përpjekja rregullative për të imituar një ambient të “pseudo-konkurrencës”. Rrjetet e energjisë (transmetimi, shpërndarja, gazi dhe gazsjellësi), janë industri të para-shquara, ku ekonomitë funksionuese të shkallës dhe qëllimit, janë aq të gjera në procesin e prodhimit, sa që tregu përkatës mund të shërbehet me shpenzime më të vogla nga një firmë e vetme, për këtë arsye në mungesë të konkurrencës i nënshtrohen kontrollit rregullativ. Rregullatori do të përpiqet që të vendosë çmime të përafërta me koston e rritur, me qëllim që të inkurajojë monopoluesit natyror që të zgjerojnë prodhimin e tyre në një nivel që do ishin vënë nga kushtet konkurruese (“pseudo-konkurrenca”). Në anën tjetër aktivitetet e Prodhimit dhe Furnizimit të energjisë kanë relativisht nivel të “kostove të zhytura” për industritë e rrjetit dhe megjithatë mund të hapen ndaj konkurrencës, ku mjaft pjesëmarrës mund të bashkë-ekzistojnë dhe konkurrojnë për pjesëmarrje në treg brenda kushteve të njëjta dhe transparente. Për fat të keq, ligjet fizike që qeverisin energjinë nënkuptojnë që tregjet e energjisë dhe konkurrenca e përkryer, nuk ndodhin vetëm me deklarinë e tyre “të hapur”, por ata duhet të dizajnohen me kujdes dhe të monitorohen, zakonisht me ndërhyrje asimetrike nga Rregullatori. Edhe në rrjedhën e themelimit të tregut konkurrues të energjisë, intervenimi i rregullatorit vazhdon për shkak të shumë “dështimeve të tregut” që tregjet e energjisë i shfaqin si vijon:

- **Të jashtmet:** çmimi i produktit nuk reflekton koston reale në shoqërinë që e prodhon atë mall (për shembull kostoja e zbutjes së ndikimit në mjedis – ose kostoja e promovimit të energjisë së “gjelbër”)
- **Profitet e Paparashikuara:** një firmë për shembull do të fitojë një “rentë ekonomike” kur të gjejë një burim të furnizimit që është dukshëm më i lirë se sa ai në treg; apo me zotërimin e një pajisjeje që papritmas përshkallëzon në vlerë; Rregullimi mund të thirret atëherë kur dëshirohet qoftë për të transferuar profitet për taksapaguesit, ose për t'u lejuar konsumatorëve ose publikut që të përfitojnë nga parashikimet.
- **Vazhdueshmëria dhe Disponueshmëria e Shërbimit:** e drejta e “Shërbimit Universal” për mall publik siç është furnizimi i energjisë është rezultat i dëshiruar shoqëror (social) megjithatë në disa raste tregu mund të mos dëshirojë të ofroj atë me kosto të dëshiruara nga shoqëria. Rregullimi mund të ndërhyjë që të mbështesë shërbimet përmes subvencionimit të tërthortë të çmimeve, ose duke vënë çmime minimale në nivelet që lejojnë mbulimin e koston fikse (për shembull disponueshmërinë e kapacitetit të prodhimit që të sigurohet furnizimi).
- **Sjellja Anit-Konkurruese dhe çmimi grabitës:** Kjo ndodh kur një firmë (zakonisht me pozitë dominuese në një treg) vlerëson nën kosto, me shpresë të nxjerrjes së konkurruesve nga tregu. Qëllimi i rregullatorëve është që të mbështesin konkurrencën dhe mbrojnë konsumatorët nga efektet negative të dominimit të tregut, duke i larguar grabitësit ose format e tjera të sjelljeve jo-konkurrente.
- **Pamjaftueshmëritë e Informimit:** Tregjet konkurruese munden të funksionojnë si duhet vetëm nëse konsumatorët janë të informuar mjaft mirë për të vlerësuar prodhimet konkurrenca. Megjithatë tregjet e energjisë mund të dështojnë në dhënie të informatave adekuate për një numër arsyesh si; kostoja e prodhimit të informatave, parashikimi “paspara” i kohës reale të energjisë është informatë që është teknikisht e vështirë për t'u

dhënë, etj. Rregullatori, duke i bërë informatat shumë më të arritshme, të sakta dhe të lejueshme, mund të mbrojë konsumatorët nga informatat e pasakta dhe nga pasojat e tyre, si dhe mund të inkurajojë veprimin e tregjeve të shëndetshëm konkurrues.

Faktorët e tjerë të “Dështimeve” të tregut mund të përfshijnë çështje të “pamjaftueshmërisë dhe racionimit”, “Drejtësia e Shpërndarjes dhe Politika Shoqërore”, “Energjia e pabarabartë dhe pazarllëqet me të”, “Racionalizimi dhe Koordinimi” dhe “Planifikimi”. Të gjitha këto kërkojnë në një mënyrë ose tjetër intervenimin e Rregullatorit për të adresuar çështjen.

Në përmbledhje, autoritetet e Rregullatorit të Energjisë janë vënë në vend për të siguruar konkurrencën jodiskriminuese, efektive dhe funksionimin efikas të tregut duke ushtruar kontroll mbi sektorët (rrjetet) e “monopoleve natyrore”, duke ndihmuar në zhvillimin e një “tregu” përmes futjes në përdorim të mekanizmave të ndryshëm për të ndihmuar krijimin e një “tregu mjedisor”, që ata mund ta monitorojnë më pas dhe të ndërhyjnë për të korrigjuar “dështimet e tregut”.

Elementet Kyçe të një Sistemi Rregullativ të Besueshëm

Autoritet i fortë – Pavarësi: Një institucion Rregullativ “Tërësisht i pavarur” ka 3 dimensione:

- Pavarësinë në marrjen e vendimeve; ku asnjë subjekt qeveritar përveç gjyqit, nuk mund të anulojë vendimin e rregullatorit;
- Pavarësinë Financiare; ku rregullatori ka një burim të financimit të rezervuar dhe adekuat.
- Pavarësinë Menaxhuese; ku rregullatori ka autonomi mbi administrimin e brendshëm si dhe mbrojtje nga përjashtimi pa shkaqe të vërteta.

Kosova përfiton nga korniza Primare Ligjore që ofron për një Rregullator të fortë dhe të pavarur me një mandate të definuar si duhet dhe një qartësi të rolit në sektorin e energjisë.

Përgjegjësia: Pavarësia e qartë duhet të shoqërohet nga përgjegjësia, dhe subjekti rregullativ duhet të jetë përgjegjës për vendimet e tij. Vendimet e ZRrE-së nuk janë (dhe nuk duhet të jenë) përgjigje ndaj nevojave dhe animeve politike. Kjo do të ishte kontradiktore me arsyen primare për krijimin e sistemit rregullativ, në vendin e parë kryesisht, për të ofruar stabilitet, konsistencë, dhe drejtësi, kështu që investuesit mund të kryejnë investimet përderisa konsumatorët mund të besojnë që janë të mbrojtur nga monopoli. Megjithatë shqyrtimi i vendimeve rregullative duhet të bëhet nga gjykata e udhëhequr nga ligjet në Kosovë dhe natyrisht me ligj. PSSP-ja dhe Asambleja përmes raportit vjetor, monitorojnë progresin e liberalizimit të tregut.

Pavarësia Menaxhuese dhe Autonomia: Pavarësia në marrjen e vendimeve nënkupton që asnjë organ tjetër përveç, gjykatave nuk mund të anulojë vendimin e rregullatorit. Menaxhimi ZRRE-së i është besuar pesë anëtarëve të Bordit, të cilët miratojnë legjislacionin sekondar pas procedurave të konsultimit publik.

Pavarësia Financiare: është parakusht i autonomisë dhe Autoritetit Rregullativ duhet t'i jepen mjete financiare për të arritur objektivat e tij. Në rastin e ZRrE-së (një organizatë jo-përfituese), ligji ka parashikuar që asistencë nga BKK-ja, do të ofrohet për një vit pas themelimit të Bordit. Si vazhdim, kontributet më të mëdha për buxhetin vjetor janë ofruar nga Donatorët dhe Shtylla e BE-së, siç është paraqitur me detaje në kapitullin 2.4. Pas periudhës tranzitore është parashikuar

që buxheti vjetor i ZRrE-së, do të mbulohet kryesisht nga licencat vjetore të ndërmarrjeve të energjisë, megjithatë situata e tyre e dobët financiare është çështje shqetësuese.

Transparenca dhe Parashikueshmëria: vendosja e rregullave të definuar mirë “pas- para”, mos ndërrimi i rregullave të lojës ose nënshtrimi ndaj presioneve politike. ZRrE-ja do të nxjerrë vendime që janë të shpjeguar qartë transparentë.

Detyrat thelbësore të ZRrE-së

Në themelimin e tregut të energjisë, një parakusht është që të gjithë pjesëmarrësit e tregut të kenë hyrje të hapur në rrjetet e energjisë në baza jodiskriminuese. Rregullatori, një nga detyrat e tij kyçe, ka vendosjen e përgjegjësisë për mbikëqyrje të qasjes në rrjet; me adoptimin e kornizës së “rregullimit të qasjes së palës së tretë” (QPT) (CBT), përmes aprovimit të tarifave të qasjes në rrjet dhe kushteve (duke përfshirë “shërbimet balancuese”) për transmetim, shpërndarje dhe pajisje të ngrohjes dhe gazit. Rregullatori duhet që më herët të aprovojë metodologjitë për vendosjen e tarifave edhe për shfrytëzim të rrjetit edhe për shërbime balancuese. Gjithashtu do të ketë të drejtë që të kërkojë ndryshime në tarifat individuale në baza ex-post. Kapitujt e tanishëm dhe ata të ardhshëm, paraqesin metodologjitë specifike që ZRrE-ja mendon t'i përdorë për vendosjen e tarifave.

Si vazhdim ZRrE-së i është dhënë detyra nga legjislacioni primar (shih kapitujt 2.1, 2.2) për pikat në vazhdim:

- Vendosja e kriterëve dhe lëshimi i Licencave; (ky është mjeti kryesor në posedim të Rregullatorit, pasi përmes licencave që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e ndërmarrjeve të energjisë, mund të bëjë monitorimin dhe rregullimin e tyre);
- Vendosja e kriterëve dhe lëshimi i lejeve dhe autorizimeve; (për kapacitetet e reja të prodhimit, por edhe për linjat direkte dhe linjat e gazsjellësit);
- Monitorimi i sigurisë së furnizimit; (ZRrE-ja mund të nxjerrë tenderë për prokurimin e kapaciteteve të reja, nëse procedurat e autorizimit dështojnë të prodhojnë rezultate të mjaftueshme; gjithashtu ZRrE-ja do të vendosë mekanizmat e tregut, siç janë pagesat e kapacitetit ose kapaciteti i “biletave”, të cilat do të adresojnë problemin akut në Kosovë mbi pamjaftueshmërinë e kapacitetit); Në një rast të tillë, ZRrE-ja është përgjegjëse për organizimin, monitorimin dhe kontrollin e procedurave të tenderimit për prodhuesin e ri;
- Monitorimi i ndarjes së duhur menaxheriale, llogaritare dhe ligjore të operuesve të rrjetit, dmth. Operuesit të Sistemit të Transmetimit (i cili duhet të zbatohet 6 muaj pas hyrjes në fuqi të Traktatit të ECSEE-së), dhe Operuesit të Sistemit të Shpërndarjes, deri në vitin 2007;
- Menaxhimi dhe alokimi i kapacitetit ndërlidhës; (kjo do të bëhet ose nën skemën e koordinuar të tregut rajonal të EJL-së, ose nuk do të përfshihet në skemë në afat të shkurtër në Kosovë, si e drejtë e dhënë për të drejtat fizike vjetore, mujore dhe javore);
- ZRrE-ja aprovon standardet e planifikimit dhe ato operative të operuesve të rrjetit (gjithashtu aprovon Kodet), duke përfshirë skemat e llogaritjes së kapacitetit të përgjithshëm të transferuar;
- Mekanizmat që merren me kapacitetin e kongestionit brenda sistemit kombëtar; (ri-dispeçimi do të jetë pjesë e Shërbimeve Ndihmëse të vlerësuara sipas kostos, dhe të mbuluara përmes shoqërimit në tarifën e transmetimit);
- Monitorimi i kohës së marrë nga punët e transmetimit dhe shpërndarjes gjatë riparimeve dhe kyçjeve;
- Publikimi i informatave të duhura;

- Monitorimi i ndarjes efektive të llogarive, në mënyrë që të mënjanoen subvencionet e dyfishta dhe programi i pajtimit të ndarjes;
- Monitorimi i nivelit të transparencës dhe konkurrencës, duke siguruar mbrojtjen e konsumatorëve, monitoruar nivelet e shërbimit ose marrjen e masave për të mbrojtur konsumatorët në nevojë; (një masë e tillë do të jetë edhe themelimi i një tarife “jetësore”);
- ZRrE-ja zgjidh ankesat dhe mosmarrëveshjet dhe kundërshton veprimet e operuesve të sistemeve të shpërndarjes dhe transmetimit, në secilën nga çështjet e sipërpërmendura.

Strategjitë dhe Metodat Rregullative të ZRrE-së

Strategjia e ZRrE-së është e bazuar në “rregullimin ex-ante”, d.m.th. rregulla transparente, udhëzime dhe metodologji të arritura pas konsultimeve publike me ndërhyrje “ex post”, kur përshtaten me kërkesat Kombëtare dhe Evropiane, ose përmes mekanizmave “këmbëz” që do të jenë vendosur në rregullat dhe legjislacionin sekondar.

ZRrE-ja duhet të sigurohet që vendimet e saj janë implementuar nga ndërmarrjet e energjisë. Kjo duhet të reflektohet në kushtet për hyrje dhe dalje (Licencim), të drejtat dhe detyrimet, duke përfshirë edhe mjetet për zbatim, në mënyrë që ZRrE-ja të mund të vendosë disa sanksione për kompanitë që nuk përmbushin udhëzimet e saj në lidhje me çështjet p.sh. për ndarje ose transparencë. Legjislacioni sekondar i lidhur me rregullimin, do të vendosë qartë detyrimet për operuesit e rrjetit për të bashkëpunuar me autoritetin rregullativ për të implementuar vendimet e tij, si dhe do të bëhen të qarta dënimet ndaj veprimeve të tilla. Çdo procedurë e ankesës do të përcaktohet qartë. Dënimet që do të vihen prej ZRrE-së janë të përfshira në Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin, si dhe në legjislacionin sekondar të nxjerrë në përputhje me Ligjin. ZRrE-ja mund të vendosë dënime për ndërmarrjet e energjisë që:

- Punësojnë persona që nuk kanë kualifikimet e kërkuara me ligj;
- Dështojnë në përmbushjen e detyrave të tyre,
- Zbulojnë informatat konfidenciale në mënyrë jo të duhur;
- Nuk përmbushin masat e vëna nga ZRrE-ja me qëllim parandalimin e keqpërdorimit të pozitës drejtuese;
- Angazhohen në aktivitetet e energjisë ku nevojitet pasja e licencës dhe që nuk kanë licencë, ose që nuk përshtaten me kushtet e licencës;
- Ndërtojnë objekte të energjisë pa pasur leje;
- Vendosin çmime ose tarifa të nënshtruara për rregullim, të cilat nuk janë të aprovuara nga ZRrE-ja;
- Mirëmbajnë llogaritë e veta në mënyrë të papajtueshme me kërkesat e legjislacionit të aplikueshëm;
- Refuzojnë t’i japin ZRrE-së qasje në llogaritë e tyre;
- Refuzojnë të futen në kontratë për furnizim të energjisë ose të ofrojnë qasje në rrjet pa arsye të justifikueshme;
- Mënjanojnë, dëmtojnë ose pengojnë efektshmërinë e pajisjeve matëse;
- Futen në rrjet pa zbatuar kushtet përkatëse;
- Kryejnë veprime në kundërshtim me Ligjin, Ligjin për Energji Elektrike, Ligjin për Energji dhe rregullat përkatëse të nxjerra nga ZRrE-ja, ose rregullat përkatëse teknike, standardet, ose kodet.

Disa nga dënimet që mund të hasen, janë si vijon:

- letër publike për shefin ekzekutiv të Kompanisë së Energjisë në fjalë;
- Publikim i raporteve krahasuese që shfaqin përmbushje të pamjaftueshme nga kompania e energjisë në fjalë;
- Dënim financiar në rast të operuesve të rrjetit, zbritje e tarifës së qasjes në rrjet të lejuar nga ZRrE-ja;
- Në raste ekstreme kur është me rëndësi, ZRrE-ja mund të marrë në shqyrtim anulim të përkohshëm ose heqje të licensës së veprimit, që në fakt, do të thotë t'i kërkohej ish-poshuesit të licensës që të dorëzojë veprimin e rrjetit tek një kompani tjetër. Megjithatë, kushtet në të cilat mund të ndodhë kjo, duhet të qartësohen më herët (në Licencë), me qëllim që operuesit e rrjetit të mos ekspozohen ndaj rreziqeve të panevojshme rregullative.

Duke parë metodologjitë specifike që do të aplikohen në sektorët e ndryshëm të energjisë, parimet e ZRrE-së janë:

Rrjetet e Energjisë Elektrike (Transmetimi dhe Shpërndarja)

Tarifat për kyçje dhe qasje, të aplikuara objektivisht dhe pa diskriminim për të gjithë shfrytëzuesit e sistemit, si dhe metodologjitë që theksojnë llogaritjen e tyre, do të aprovohen dhe publikohen para hyrjes së tyre në fuqi. Tarifat e rrjetit do të reflektojnë shpenzimet, duke u bërë kështu një element nxitës. Rregullat e adoptuara nga OST-ja (TSO) për balancim të sistemit të energjisë elektrike, duhet të jenë objektive, transparente dhe jodiskriminuese, duke përfshirë rregullat për ngarkimin e shfrytëzuesve të sistemit të rrjetit për prishje të ekuilibrit të energjisë. Është e mundur që ngarkesat për ekuilibrin energjetik do të rregullohen dhe do të reflektojnë koston. Nëse është e nevojshme, ZRrE-ja do të ketë autoritetin që t'u kërkojë operuesve të sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes, që të modifikojnë afatet dhe kushtet, tarifat, rregullat, mekanizmat dhe metodologjitë e referuara më lart, për të siguruar që janë në proporcion dhe të aplikuara në mënyrë jodiskriminuese.


Në vendosjen e tarifave të rrjetit ZRrE-ja, do të ketë parasysh:

- Vlerën e kapitalit të kompanisë së rregulluar në të cilën duhet të fitohen rezultate dhe çdo shtesë në bazën e kapitalit në formë të investimeve të rrjetit gjatë periudhës së menduar; Përpilimin e regjistrit të plotë të pronave duhet të bëhet nga një auditor teknik i specializuar në mënyrë që të bëhet një nivel i drejtë i besimit mbi gjendja dhe vlerën e secilës pronë. Përveç metodologjisë së llogaritjes së “kostos historike”, ZRrE-ja me të gjitha gjasat ndoshta do të ndjekë, një kombinim të “Vlerësimit nga Tregu” dhe “Vlerave Moderne Ekuivalente të pronave”;
- Një shkallë të përshtatshme e kthimit (%) në kapital, duke llogaritur natyrën e ulët të rrezikut të bizneseve të rregulluara të rrjetit, por gjithashtu kushtet financiare lokale;
- Përmes të ardhurave vjetore dhe jetës ekonomike të aseteve, do të konkludohet mbi shkallën reale të amortizimit të këtyre aseteve;

- Kostot e veprimit të bizneseve të rregulluara; ZRrE-ja mund të vendosë të bëjë sërish një vlerësim “indirekt” të kostos, qoftë nga krahasimet ndërkombëtare, qoftë nga hartimi dhe funksionimi me karakteristika lokale të rrjetit “ideal”, siç janë dendësia e popullatës dhe topologjia.

Në figurën 3.9, është paraqitur një diagram skematik mbi mënyrën se si i krijon rregullimi të ardhurat e përgjithshme të lejuara

Fig. 3.9 Qasja e “Ndërtimit të blloqeve” (“Building Block”)



Në themelimin e metodologjive dhe aprovimin e tarifave, ZRrE-ja do të ndjekë parimet vijuese:

- Promovimin e efikasitetit (efikasitetin alokues dhe teknik)
- Lejimin e mbulimit të shpenzimeve (mbulim i shpenzimeve të arsyeshme dhe justifikuar + kthim i drejtë i investimit)
- Mbështetjen e konkurrencës (llogaritje jo-diskriminuese, e qëndrueshme dhe e parashikueshme, e thjeshtë për t’u llogaritur)

- Të jetë i pranueshëm për shoqëri (mbrojtë më të varfërt, drejtësi mes të konsumatorëve)

Efikasiteti kërkon vënien e çmimit për shpenzimet marxhinale pasi kjo ofron shenjë e duhur ekonomike, ndaj ZRrE-ja mendon të përdorë vënien e çmimeve për Shpenzimet Marxhinale Afat Gjata (ShMAGj). Një karakteristikë e industrisë së rrjetit, është që për shkak të tepricave të pandara në hartim (rrjetet janë të skicuar jo vetëm për të transportuar energjinë e konsumuar, por duhet të jenë në gjendje që të përballojnë kërkesën kulmore gjatë kohës së “kongestionit” – (“n-1” kriteri i sigurisë). Është e vështirë që ndonjë metodologji marxhinale e vënies së çmimeve, të mund të mbulojë plotësisht të ardhurat e kërkuara. Zakonisht mundësohet një “ngritje” për të bërë bashkërendimin e shumës së mbuluar, përmes ShMAGj-së dhe të ardhurave të përgjithëshme të lejuara.

Mjeti më i thjeshtë për regjimin e çmimeve, është në baza të kostos shtesë (i njohur edhe si shkalla e Kthimit (SHeK), ose rregullorja e Kostos së Shërbimit). Në një regjim të tillë, rregullatori vendos çmimet (zakonisht në baza vjetore – gjithashtu kjo mund të bëhet gjatë disa vjetëve në mënyrë të parashikuar) për një kompani të rregulluar, që të mbulojë shpenzimet e veta të veprimit dhe të kostove të përdorimit dhe kapitalit të shërbimit (duke nënkuptuar shpenzimet ekonomike të shfrytëzimit kapital dhe jo vetëm të zhvleftësimit, i cili është një marrëveshje përlllogaritëse), dhe përfshin shkallën e kthimit në kapital që është i mjaftueshëm për të përfshirë zëvendësimin dhe/ose zgjerimin e aseteve të kompanisë. Në SheK, rregullimi lejon kompanitë që të kalojnë përmes shpenzimeve të zgjedhura (O&M), të cilat merren si të nevojshme nga organi mbikëqyrës rregullativ, për të siguruar një nivel të përshtatshëm shërbimi për shfrytëzuesit. Si vazhdim i këtyre shpenzimeve, rregullatori gjithashtu u lejon kompanive që të realizojnë një tepriçë përfitimi të krahasueshme me asetet bazë ose kapitalin e investuar nga kompania në shërbim. Kjo rezulton në formulën vijuese të shkallës së Kthimit:

Formula tipike e Normës së Kthimit (Rate of Return):

$$Të\ hyrat_t = O\&M_t + Zhvleftësimi + \{ROR_t \times (RAB-Amortizimi)\}$$

Ku:

Të hyrat_t: të hyrat e përgjithshme të lejuara nga rregullatori

O&M: Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes së kompanisë së rregulluar

ROR: Norma e Kthimit (ose norma e profitit) e lejuar nga rregullatori

RAB: Asetet Bazë të Rregulluara


Sipas rregullorës tradicionale të Normës së Kthimit, tarifat e shërbimeve të rrjetit shqyrtohen rregullisht dhe duhet të jenë të rregulluara (procesi i quajtur “shqyrtimi rregullativ”) në nivele më të ulta, nëse ndërkohë janë arritur kursime (ulje) të shpenzimeve. Kështu, kompanitë e rregulluara të rrjetit përfitojnë vetëm nga ruajtja e shpenzimeve deri kur të zvogëlohet insistimi i rregullatorit për uljen e shpenzimeve. Nëse periudha rregullative është e shkurtër – 1 ose 2 vjet – , nxitja për uljen e shpenzimeve (dhe efikasitet më të lartë) është shuar pothuajse plotësisht. Si vazhdim, Norma e Kthimit (ROR), krijon nxitje për mbi-kapitalizim (tej-investim në asetet fikse) dhe mundësi për rritje të shpenzimeve kapitale.

Gjithashtu edhe tarifat e rrjetit duhet të reflektojnë koston në kuptim të gjerë, gjithsesi, kjo nuk do të thotë se duhet të ketë përputhshmëri të ashpër dhe automatike në mes të kostos së biznesit të rregulluar dhe të hyrave të mbledhura nga tarifat e rrjetit. ZRrE-ja dëshiron të nxisë rritjen e

efikasitetit dhe të inkurajojë investimet që janë në proces ose investimet në zgjerimin e rrjetit, posaçërisht në shpërndarje. Në kohën kur metodologjia e përgjithshme për vënien e çmimeve do të aprovohet, është e nevojshme të mbahet një diskutim i detajuar i nevojave për investim.

Në të ashtuquajturën " Rregullimi i Bazuar në Nxitje" (Incentive Based Regulation), objektivi primar është nxitja e zhvillimit të tregut konkurrues në tregjet monopoluese dhe të dobësohet lidhja mes kostove dhe tarifave. Për operatorin e rrjetit zgjidhen objektivat e performancës (efikasiteti i rritur) dhe nëse ato përmbushen, arrihet edhe zvogëlimi i shpenzimeve. Këto zvogëlime nuk duhet të pasqyrohen menjëherë tek konsumatorët (siç është në qasjen e ROR-it), por ndërmarrjeve do t'u lejohej që të mbajnë "përfitimin e ndërmjetëm" për 3 deri në 5 vjet (kohëzgjatja e "shqyrtimit rregullativ"), deri sa autoriteti të vendosë objektiva të reja të veprimtarisë. Ky ndikim është ilustruar më mirë në figurën e mëposhtme 3.10, e cila tregon se nëse një ndërmarrje e energjisë mundet "veprojë më mirë" seç është caktuar nga rregullatori, në fakt ajo realizon një normë kthimi shumë më të madhe.

Fig. 3.10 Rregullimi i "Çmimit Tavan"



Në Rregullimin e Bazuar në Nxitje, janë disa regjime të vënies së çmimeve, dmth:

- Në një "çmim Tavan" (price cap) të pastër, formula e kontrollit të çmimit përcakton çmim mesatar të lejuar të firmës, ndërsa të ardhurat e lejuara të firmës, janë produkt i këtij çmimi dhe prodhimit;

Formula Tipike e Çmimit “Tavan”:

Çmimi “Tavan” - çmim që lejon mbulimin e shpenzimeve të arsyeshme dhe profit të arsyeshëm,

$$\text{Çmimi}_t = \text{Çmimi}_{t-1} \times (1 + RPI_{t-1} - X_{t-1} + Q_t)$$

Ku:

RPI_{t-1} : Shkalla e inflacionit për vitin e mëparshëm

X_{t-1} : Përshtatja e faktorit të efikasitetit nga viti i kaluar; në shumë vende të zhvilluara ky faktor është kthyer në zero në periudhën e parë rregullative.

Q_t : Përshtatja e faktorit të lidhur me cilësinë e shërbimit për këtë vit

- Me një çmim “tavan” të thjeshtë, të ardhurat e lejuara të kompanisë përcaktohen drejtpërdrejtë nga një formulë kontrolluese që është e pavarur nga prodhimi;

Formula Tipike e të Ardhurave “tavan”:

Të ardhurat “tavan” – të ardhurat që konsiderohen të arsyeshme

$$\text{Të ardhurat}_t = \text{të ardhurat}_{t-1} \times (1 + RPI_{t-1} - X_{t-1} + Q_t)$$

Ku:

RPI_{t-1} : Shkalla e Inflacionit për vitin paraprak

X_{t-1} : përshtatja e faktorit të efikasitetit për vitin paraprak

Q_t : Përshtatja e faktorit të ndërlidhur me cilësinë e shërbimit për këtë vit

- Një “tavan” hibrid i të ardhurave është përzierje e një “tavani” të thjeshtë të të ardhurave dhe një çmimi të thjeshtë “tavan”, për shembull: Britania e Madhe përdor çmime hibride dhe të ardhura “tavan” për kompanitë dhe shpërndarjet
 - 50% e të ardhurave të lejuara janë fikse
 - 50% e shtimit mesatar të rritjes në njësi dhe konsumatorë
 - Raporti (Racio) lidhet me ndarjen e pritur mes shpenzimeve fikse dhe variabile

Formula Tipike e Tavanit Hibrid

$$R_t = R_{t-1} * (1 + CPI_t - X) * \{0.5 * \frac{D_t}{D_{t-1}} + (\frac{C_t}{C_{t-1}}) \frac{C}{C}\}$$

R = Të ardhurat

CPI = Indeksi i Çmimit të Konsumatorit

D = njësitet e shpërndara (kWh)

C = Konsumatori

ZRrE-ja ende nuk e ka marrë vendimin përfundimtar për tarifat e rrjetit. Regjimi i Normës së Kthimit (ROR), është qasje e thjeshtë, ndërsa mangësia kryesore e saj siç është përmendur më parë, është mungesa e nxitjeve dhe rreziku nga “veshja me ar” (investimet e panevojshme ose improvizimet përmes të cilave tentohet të rritet vlera e aseteve). ROR është qartazi një mekanizëm me nxitje të nivelit të ulët. Një mënyrë e thjeshtë për të inkorporuar nxitjen për efikasitet në një regjim të ROR-it, është që rregullatori të sfidojë (të sigurojë saktësinë) të gjitha kostot e deklaruara nga ndërmarrja e rregulluar dhe t’i përputhë “efikasitetin” e shifrave të dorëzuara të kostos. Për shembull, rregullatori mund të vërë në pyetje fuqinë e raportuar punëtore për kryerjen e një procesi ose detyrë të caktuar, dhe të kërkojë që ndërmarrja e rregulluar t’i ulë shifrat e raportuara. Në këtë mënyrë rregullatori përpiket të imitojë konkurrencën dhe të aplikojë presion në kostot e kompanisë. Një çështje që megjithatë mbetet ende e hapur, është baza për sfidimin e shifrave të kostove të raportuara nga ndërmarrjet e rregulluara. Në këtë fazë në Kosovë, raportet (raciot) dhe krahasimet (benchmarking) e thjeshta të industrisë, rezultatet nga studimet simuluese dhe informatat nga konsulentët teknikë/ekonomikë, mund të merren parasysh dhe të pozicionohen për të siguruar bazë për sfidimin e shifrave.

Një tjetër çështje, është që ROR nuk shikon drejt së ardhmes. Ajo shqyrton koston e vitit paraprak për të nxjerrë kërkesat e të ardhurave. Një problem në këtë qasje, veçanërisht në rastin e Kosovës ku pritet të realizohet një CAPEX (shpenzime kapitale) i madh në afat të shkurtër dhe të mesëm, në mënyrë që të rifitojë dhe zgjerojë rrjetet, është se kërkesa e të ardhurave mund të përfundojë duke u luhatur prej njërit vit në tjetrin, duke detyruar kështu ndryshime të shpejta të tarifave. ZRrE-ja do të dojë të zbusë këto ndryshime (në fakt ngritje të tarifave) duke inkorporuar disi CAPEX-in e pritur në kërkesat e të ardhurave. Për këtë këndvështrim, ROR-i duhet të marrë parasysh disa informata nga vështrimet për të ardhmen, në lidhje me CAPEX-in e ri. Një mënyrë e thjeshtë për të arritur këtë, është që të bëhet një lejim, madje i përafërt me kërkesën për të ardhurat e secilit vit, për një pjesë të CAPEX-it të pritur.

Përparësi kryesore e Rregullimit të Bazuar në Nxitje, është se ky rregullim është qartë një mekanizëm i fuqishëm, pasi ai në mënyrë eksplicite i inkorporon nxitjet përmes faktorit X, por gjithashtu edhe konsideratat e tjera siç janë lejet cilësore përmes faktorit Q, në formulën e vendosjes së çmimit. Nga ky këndvështrim, ky është një mekanizëm superior ekonomik. Për më tepër, me formulën hibride, nxitjet e mëtejshme për rritjen e qarkullimit dhe zgjerimin e rrjetit mund të jenë eksplicite në vënien e çmimit “tavan”. Përparësi tjetër shtesë e vendosjes së çmimit “tavan” është se kjo është një qasje me shikim kah e ardhmja meqë vënia e çmimit “tavan” bazohet në projeksionet e ardhshme të OPEX-it (shpenzimet operative) dhe CAPEX-it (shpenzimet kapitale), që është e përshtatshme për një industri e cila ndryshon dhe zgjerohet me shpejtësi. Megjithatë, përparësitë e lartëpërmendura vijnë me një kosto shtesë të përdorimit të një formule më të sofistikuar dhe më të vështirë për tu kuptuar, shfrytëzimit të shënimeve të kualitetit më të madh dhe më të lartë në mënyrë që të maten për shembull faktorët X dhe Q, teknikat e avancuara statistike dhe ekonometrike, informata të sakta me vështrim kah e ardhmja mbi planet e biznesit, OPEX dhe CAPEX. Në Kosovë nuk ka ndonjë “Plan Biznesi” kuptimplotë nga shërbimet deri më tash, ose diç që është “me vështrim në të ardhmen”.

Për këto arsye, ZRrE-ja e ka mendjen që **të nis me regjimin e Normës së Kthimit (ROR) për periudhën e shkurtë tranzitore deri në tri vjet** me perspektivë të lëvizjes në një regjim të sofistikuar të tavanit hibrid më pas. Kjo do t’ia mundësojë edhe ZRrE-së edhe kompanive që të “fillojnë lojën” me një mekanizëm të thjeshtë të vënies së çmimeve, të vendosin një proces rregullativ, të mësohen me dëgjimin dhe konsultimet, të vendosin llogaritë rregullative, modelet e tyre të dorëzimit, definimin e variableve, teknikat për analizimin e variableve kyçe matëse

ekonomike, etj. kështu që ato të jenë në pozitë që ti fusin në përdorim dhe ti inkorporojnë të gjitha këto në formulën e ardhshme të vënies së tavanit në çmime. Si shtesë ky regjim mund të ndihmojë një proces potencial të privatizimit, duke lejuar krahasimet e ofruesve sipas normës së tyre të kërkuar të kthimit dhe inkurajon interesin e investuesve privatë në procesin e privatizimit, duke ofruar indikacione për normat e kthimit që ata mund të presin.

Rreth çështjes së caktimit të kostos ZRrE-ja përqendrohet në bazë e madhësisë së vogël të sistemit dhe thjeshtësisë së metodologjisë për zbatimin e rrjetit të tarifave të “pullave postare”, ku konsumatorët në një regjion të caktuar do të përballen me çmim të ngjashëm pavarësisht nga lokacioni i tyre gjeografik. Natyrisht, kostot e transmetimit dhe shpërndarjet “rrjedh” mbi nivelet e voltazhit të rrjetit në proporcion me ngarkesën e përgjithshme të lidhur, që reflekton humbjen ekonomike.

ZRrE-ja mendon se Tarifat e Rrjetit të Transmetimit do të vendosen sipas Ngarkesës së Kërkesës në bazë të metodës “Kulmi Rastësor i Sistemit”. Sa i përket pagesës së detyrimeve, edhe pse një qasje instiktive do të ishte që vetëm të caktohen pagesat e detyrimeve për entet e Ngarkesës për çështje të thjeshtësisë (komponenti “G” e Tarifës së Transmetimit = 0), fakti se një proporcion i madh i Kapacitetit Gjenerues do të jetë i orientuar kah eksporti (nëse sikur që shpresohet një Prodhues individual i madhe të zhvillohet në Kosovë), do të duket jo e drejtë që konsumatori t’i bartë të gjitha kostot e një sistemi të Transmisionit që në masën më të madhe nuk përdoret (nga ata). Prandaj çështja e ndarjes mes komponentëve G/L të tarifave të rrjetit ende mbetet pa përgjigje në pritje të shqyrtimeve në të ardhmen.

Rreth çështjes së çmimit të Kyçjeve, ZRrE-ja mendon se duhet zbatuar një metodologji të “kyçje gëlltitëse” të caktimit të çmimit ku konsumatorët janë përgjegjës që të paguajnë çmimet që reflektojnë koston vetëm për kyçjet e tyre të drejtpërdrejta në sistem derisa kostoja e përf forcimeve tjera potenciale të sistemit që kërkohen si rezultat i hyrjes së këtij konsumatori në sistem do të shoqërohen me tarifën. Kjo metodologji është e thjeshtë dhe i shmanget efektit të “vozitjes së lirë” nga konsumatorët e ardhshëm, por nuk i çkurajon anëtarët e rinjë.

Rreth çështjes së regjimit të balancimit, ka një dallim që duhet bërë këtu mes prokurimit nga TSO-ja të energjisë balancuese për operacionet e drejtpërdrejta në sisteme dhe çmimit që u vihet përdoruesve të sistemit, të cilët vetë janë jashtë balancit. Tregu për balancimin e energjisë pritet të jetë jolikuid dhe i koncentruar, prandaj ZRrE-ja do të vendos çmime “ex-ante” të rregulluara (administruara) që reflektojnë koston.

Përshtatshmëria e Prodhimit

Për një vend në zhvillim, asnjë sistem i rregullatorit të energjisë, pa marrë parasysh sa i mirë duket në letër, nuk mund të shikohet si sukses përveç nëse e ndihmon vendin që të arrijë progres konkret ekonomik. Nëse sistemi i rregullatorit nuk ndihmon në prodhimin e investimeve të nevojshme me një kosto të arsyeshme, atëherë ai nuk e ka arritur qëllimin e vet primar.

Në kapitujt paraprak është përshkruar papërshtatshmëria e tmerrshme e kapacitetit në Kosovë, që rezulton me kufizim të ngarkesës dhe importe të shtrenjta. Me rëndësi kulmore për zhvillimin ekonomik të Kosovës, është nevoja për të tërhequr investimet private në ndërtimin e kapaciteteve të reja të prodhimit dhe shfrytëzimit të kualitetit të pasur dhe të mirë të rezervave të linjtit që janë në dispozicion. Më poshtë janë hulumtuar disa nga opsionet dhe mekanizmat që ZRrE-ja mendon t’i vendosë në mënyrë që të ndihmojë këto investime aq të nevojshme.

Në një treg konkurrent, likuid dhe të pjekur me shumicë, çmimet do të kenë tendencë të ngrihen në koston e hyrjes së re pasi “kushtet për furnizim të shtrënguar” të perceptohen, kështu që pritja është që kapitali i rrezikuar do të ndërtoj prodhim të ri nëse një dalje profitabile për energjinë është në perspektivë. Megjithatë, mund të ketë barriera për anëtarin e ri duke e bërë investimin ose tepër të shtrenjtë ose tepër të rrezikshëm, me barrierat që bien gjerësisht në kategoritë e rrezikut rregullativ dhe rrezikut të çmimit;

Rreziqet Rregullative në Kosovë:

- Pasiguria e KEK-ut në të ardhmen ka lejuar çmimet me shumicë dhe mungesë të tregut me shumicë;
- Regjim i paqartë i të drejtave për import/eksport;
- Pasiguritë rreth pronësisë për shkak të statusit të pazgjidhur të sovranitetit kombëtar;
- Ndryshimet e ardhshme në Ligjet ose Rregullat;

Rreziqet e Çmimeve në Kosovë:

- Konkurrenca nga energjia me kosto të ulët në mbarë regjionin;
- Dështimi i kërkesës rajonale për të rritur presionin ndaj çmimeve me shumicë;
- Paaftësia për të eksportuar energji të mjaftueshme për shkak të mungesës së infrastrukturës së transmetimit ose ndalesave rregullative (Rregulla jo të favorshme për Menaxhim të Kongestionit);
- Importe të subvencionuara;

Janë disa mjete në dispozicion të ZRrE-së për të zbutur këto rreziqe për investuesit perspektivë. Sipas Ligjit cilido PPA i nënshkruar nga Furnizuesi Publik nuk bën të jetë më i gjatë se sa 5 vite pas së cilës kohë kushtet duhet të rishqyrtohen nga ZRrE-ja. Një periudhë e tillë e shkurtër sjell pak ngushëllim për investimet në centralet me bazë djegëse të linjtit, përveç faktit se Furnizuesi Publik paraqet një “kundër-palë të rrezikshme” tepër të lartë në cilindo rast.

ZRrE-ja po i shqyrton disa opsione për ti vendosur si pjesë e mekanizmit të tregut. Një opsion i tillë janë “Biletat e Vëllimit” në formë të detyrimeve ndaj Furnizuesit(ve) për të riblerë një proporcion të caktuar të shitjes së tyre të përgjithshme nga një projekt i pranueshëm (IPP-ja e re). Kjo natyrisht mbetet një subvencion i paguar nga konsumatori me një vendim qendror që merret rreth asaj se çfarë niveli duhet të jetë ky subvencion dhe kush do të duhej ta përfitoj atë. Një tjetër model i ri ndërtimi mund të jetë përmes një Garancie të të Ardhurave. Kjo do ta obligonte KEK-un (ose Qeverinë) që të paguaj çmimin “e fundit të poshtëm” për prodhimin nga IPP-ja e re, në rast se ajo nuk i fiton kontratat alternative (me çmime më të mira). Një tjetër opsion mbetet vendosja administrative e nivelit të kërkuar të Sigurisë së Furnizimit (Margjinave Rezerve) dhe vënia e detyrimeve tek TSO-ja që ta siguroj këtë si Shërbim Ndihmës. TSO-ja do të sigurote kapacitetet e nevojshme shtesë në kontratat bilaterale, dhe do t'i bënte këto të disponueshme për tregun në kushtet ekstreme. Ky kapacitet do të mund të ofrohet në mekanizmin balancues ose ndryshe do të mund të ngarkohet si një “ngritje” për tregun.

ZRrE-ja do ti publikoj rregullat e tregut dhe do të iniciojë procedurat autorizuese për kapacitetet e reja gjeneruese. Sipas Ligjit dhe nga këndvështrimi i situatës kritike në sigurinë e furnizimit, nëse procedurat autorizuese nuk prodhojnë asnjë rezultat, ZRrE-ja mund të organizoj, monitoroj dhe kontrolloj tenderin për kapacitete e reja.

3.8 Linjat-ndërlidhëse dhe Menaxhimi i Kongestionit

Qasja e palës së tretë (QPT) është një parakusht fundamental për të krijuar një ambient të përshtatshëm për hyrjen e mundshme të pjesëmarrësve të tjerë të tregut, në bizneset e prodhimit ose furnizimit të energjisë. Në kapitullin më larët 3.7 është prezantuar se si ZRE-ja do të sigurojë qasje të lirë në rrjetin e përgjithshëm për prodhuesit/tregtarët/furnizuesit e ndryshëm me rregullim të legjislacionit sekondar dhe kodeve adekuate. Këto rregulla me procedura të definuara në bazë të të cilave do të lëshohen licencat e veprimit për kompanitë ekzistuese dhe ato të tjera të energjisë, mund të lëshohen, dhe kodet do të sigurojnë që rrjetat (e sistemet të transmetimit dhe shpërndarjes)shfrytëzohen në mënyrë jodiskriminuese dhe nën kushte të njëjta për të gjithë të licencuarit.

Në të kaluarën linjat ndërlidhëse kryesisht janë ndërtuar për të rritur sigurimin e furnizimit dhe mundësitë e koordinim në mes të sistemeve fqinje. Në kushtet të tregut të lirë është e kuptueshme që linjat e forta të ndërlidhëse luajnë një rol parësor, duke siguruar një disponueshmëri të mjaftueshme për kapacitetin transferues të rrjetit, për rrjedhat ndërkufitare të energjisë që mund të jetë kërkesë e tregtimit ndërkufitar.

Intensifikimi i shitblerjes dhe rrjedhat e paparashikueshme të energjisë elektrike, për shkak të transaksioneve në mes të palëve, kërkojnë qasje të ndryshme në planifikimin e kapaciteteve të transmetimit dhe shfrytëzimit të ST-së për shkak të shfaqjes së mundshme të fenomeneve të njohura si “rëndim i rrugëve të sistemit të transmetimit”. Me anë të Administrimit të rrugëve të rënduara të sistemit të transmetimit të gjitha “kufizimet” në sistemin e transmetimit të energjisë duhet të zgjidhen me qëllim që të mirëmbahen rrjedhjet e pranueshme të energjisë dhe siguria e rrjetave sikur edhe përmbushja e kërkesave të pjesëmarrësve në treg deri në masën e mundshme. Transparenca në QPT kërkon gjetjen e një metodologjie efikase përzgjedhjen e kufizimeve në rrjet. Tregtimi e Rritur Ndërkufitar (ShRN) i energjisë elektrike, ka rezultuar gjatë 3-4 vjetëve të fundit me shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit të Kosovës edhe nga pjesëmarrës të tjerë për transit për rajonet e tjera kontrolluese..

Ligjet e miratuara të energjisë në Kosovë në mënyrë të hollësishme kanë parashikuar disa rregulla specifike dhe kode para se të bëhet fillimi i plotë i QPT-së, Administrimi i Rrugëve të Rënduara (ARR) dhe Tregtimi Ndër-Kufitar (TNK) janë detyrat me të cilat duhet të ballafaqohen dhe të përshtaten gjatë veprimit në të ardhmen OST-ja dhe ZRRE-ja. Ngjashëm, metodologjitë përkatëse duhet të gjinden dhe të harmonizohen në lidhje me zbatimin e TNK dhe ARR në nivel rajonal.

Ndërlidhjet në tensionin e lartë me vendet fqinje, aktualisht përbëhen nga tre (3) linja njëfishore që operojnë në tensionin 400 kV (me Serbinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë), dhe në nivelin 220 kW (me Shqipërinë dhe Serbinë), përderisa dy linja të tjera ndërlidhëse në nivelin 220 kW me Maqedoninë janë dëmtuar dhe janë jashtë përdorimit që nga konflikti (Figura 4.3). Mundësia më e mirë e zgjerimit të kapacitetit ndërlidhës, është me gjasë linja e re ndërlidhëse 400 kW me Shqipërinë në afat të mesëm, bazuar në mundësinë e bashkëpunimit hidro-termal kapaciteteve gjeneruese, në mes të Shqipërisë dhe Kosovës si dhe në rast të zgjerimit gjithëpërfshirës të mëvonshëm të prodhimit të energjisë, të orientuar kah eksporti.

Aktualisht në Kosovë, Rrjeti i ashtuquajtur Horizontal (pjesë e rrjetit të transmetimit të përdorur për transit të rrjedhjeve të energjisë të shkaktuara nga transaksionet e palës së tretë) bazuar në ngarkesat aktuale të vitit 2004 në mënyrë të konsiderueshme është shumë afër vlerave të limitit.

Në procesin e zhvillimit të Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike (TREE) në SEE, ETSO (Operatori i Sistemit të Transmetimit të Evropës) ka themeluar Grupin Punues të përbashkët të SEE-së Operuesit e Sistemit të Transmetimit (SEETSO TF)) me qëllim që të merret me

Administrimin e Rugëve të Rënduara të Sistemit të Transmetimit dhe të vendosjes së mekanizmit të uniform ndërmjet-OST-ve të një skeme të kompensimit për kostot e shkaktuara nga rrjedhjet e tranzitit për shkak të transaksioneve të palëve të treta (TNK).

Pjesëmarrja e UNMIK-ut/KEK-ut SEETSO TF, është sfiduar nga përfaqësuesi i EPS-së (Serbi) dhe si rezultat i kësaj UNMIK-u/KEK-u është përjashtuar nga nënshkrimi i marrëveshjes për TNK në mes OST-ve të inkuadruar. Një marrëveshje e tillë është nënshkruar në mes të: Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Bullgarisë, Rumanisë, Serbisë, dhe Maqedonisë.

Mekanizmi i Zhvilluar i kompensimit të TNK është simuluar që nga 1 janari 2004 dhe zbatimi i vërtetë ka filluar që nga 1 qershori i vitit 2004.

Parimet e mekanizmit të TNK të SEE-së mbështeten në:

- Caktimin e kufijve të rajonit të TNK të SEE-së.
- Definimin e Rrjetit Horizontal.
- Kalkulimi i çelësit të Transinit.
- Definimin e kostos së HN.
- Kalkulimi i kostos së kërkuar në fondin e TNK-së të SEE-së.
- Financimi i fondit të kompensimit TNK-së të SEE-së.
- Sqarimi i Procesit dhe zgjedhja e dallimeve.


Kërkesa për kompensim varet nga vlera e kyçjes tranzitore, e cila në rastin e Kosovës mbetet shumë e konsiderueshme si rezultat i vlerës relativisht të lartë të energjisë së tranzituar. Çelësi i transitit i kalkuluar duhet të jetë e shumëzuar me vlerën vjetore të HN për të përcaktuar kërkesën ndaj fondit të kompensimit. Në rastin e Kosovës Çelësi i transitit mund të ndryshoj shumë, përafërsisht nga 30% deri në 50% ndërsa kostoja vjetore e rrjetit horizontal është i vlerësuar në rreth € 8,000,000.

Që nga zbatimi i mekanizmit të TNK të SEE-së nga 1 Qershori 2004, KEK-u nuk ka realizuar ndonjë të hyrë nga energjia e tranzituar përmes rrjetit të saj të transmetimit. Vlerësimet paraprake për të hyrat e humbura të Kosovës për shkak të përjashtimit të saj nga TNK e SEE-së, ndryshojnë në mes € 3-4 milion/në vit.

3.9 Prospektet dhe Çështjet e Sistemeve të Transmetimit dhe Shpërndarjes

Që të dy këto rrjete të sistemit të Kosovës vuajnë nga mungesa e kapacitetit të mjaftueshëm, topologjisë jofavorizuese (sistemit të gjatë radial me rezervë të varfër N-1) çka rezultojnë në standarde shumë më të ulëta se ato Evropiane (UCTE) të kualitetit të furnizimit me energji. Kjo në mënyrë të vazhdueshme shpie në mbingarkesa, kushte të dobëta të tensionit, kufizime të ngarkesës, dhe eventualisht humbje të jashtëzakonshme teknike (përafërsisht 18%, burimi: BB - ESTAP I). Për më shumë, posaçërisht sistemet e shpërndarjes janë shpesh duke operuar nën kushtet minimale teknike, nganjëherë të shoqëruara me standarde të papranueshme të sigurisë, duke shkaktuar rreziqe të mëdha për profesionalistët që operojnë (KEK) si dhe duke rrezikuar shëndetin e konsumatorëve.

Figura3. 11 Sistemi i Transmetimit të Kosovës



Bazuar në analiza shumë të detajuara të secilit nga (7) njësitë rajonale të shpërndarjes të KEK-ut të kryera nga ESTAP I, gjendja e tanishme teknike e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes të KEK-ut mund të gjykohej më së miri nga nevoja e jashtëzakonshme për investime në një vlerë gati prej € 542 milion deri në 2015 me qëllim të uljes së humbjeve të përgjithshme teknike deri në nivelin real prej 13-15% si dhe kthehet rrjeti në një gjendje të ngjashme me standardet e tanishme në Evropë. Nga kjo shume, 98 € milion janë paraparë për zhvillimin e sistemit të transmetimit edhe 444 milion € për zhvillimin e sistemit të shpërndarjes.

Performancat e tanishme financiare të dobëta të KEK-ut nuk e lejojnë ndërmarrjen që të bëjë ndonjë investim të dukshëm në sistemin e rrjetit çka do të përmirësonte karakteristikat e përbushjes në mënyrë të konsiderueshme. Megjithatë, për shkak të pamundësisë së investimeve të KEK-ut, përderisa të mos merret përkrahje substanciale nga jashtë (BKK, donatorët), do të jetë e pamundur që sistemet e T&D të vihen në vijë me standardet Evropiane/UCTE ashtu siç është përcaktuar nga Traktati i ECSEE-së. Në vazhdim, ripërtëritja teknike e sistemit të rrjetit duhet të shoqërohet me ristrukturimin institucional të ndërmarrjes së energjisë (KEK) me qëllim që të përbushen kërkesat e tregut të ardhshëm të “liberalizuar” energjisë elektrike. Siç u përmend më herët dhe për shkak të “kostos së mosshfrytëzimit të plot të aseteve, sistemet e transmetimit dhe Shpërndarjes janë të njohura si “monopole natyrore”, dhe për këtë arsye i nënshtrohet çmimeve të rregulluara. ZRE-ja e vetëdijshme për sfidat që bizneset e rrjetit po ballafaqohen, do të lejojë çmime (të bizneseve të rrjetit të ristrukturuar dhe të ndara), që plotësisht të mbulohen shpenzimet e justifikueshme duke përfshirë programin ambicioz për shpenzimet kapitale plus përfitimet. Metoda e duhur e rregullimit ekonomik dhe kodet e zhvilluara nga ZRE dhe ndërmarrja, respektivisht, në vitin 2005 dhe të adoptuara nga ZRE-ja, do të ndihmojnë në arritjen e atyre që presin konsumatorët – për kualitet më të mirë teknik dhe ekonomik të energjisë së furnizuar.

3.10 Linja 400 kW me Shqipërinë

Aktualisht ekziston linja 220 kW në mes të Shqipërisë dhe Kosovës. Përveç kapacitetit të transferimit të vlerësuar prej afërsisht 200 MW, kushtet e vërteta të rrjetit lejojnë një transferim të energjisë jo më të madh se 100 MW. Është e qartë që nën kushte të tilla është shumë e vështirë që të optimizohen të dy sistemet.

Sic u përmend më sipër në këtë raport, është një mundësi e vetme për koordinim në mes të energjisë bazë-termale në Kosovë me sistemin Shqipërisë të bazuar në hidro, përmes sforcimit të kapacitetit të transmetimit ndërlidhës me ndërtimin të linjës 400 kW në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.

Kështu, shfrytëzimi dhe planifikimi i të dy sistemeve mund të jetë i optimizuar, shkëmbimet e konsiderueshme të energjisë mund të jenë të mundshme, që të gjitha qojnë në shpenzime me të ulëta dhe tarifa më të mira për konsumatorët në të dy vendet. Projekti i ndërlidhjes së 400 kV është vështuar si investim me prioritet parësor në Masterplanin e Transmetimit të BB-s ESTAP I për Kosovën i kryer në vitin 2002, dhe së dyti një plan i njëjtë për Shqipërinë, i kryer në Shqipëri në vitin 2003. Në të njëjtën kohë, prioriteti i parë i Shqipërisë (ndërlidhja me Malin e Zi – linja Elbasan - Podgoricë) tashmë është sjellë në fazën e zbatimit.

Brenda kornizës së paketës tjetër të BB-së (ESTAP II), studimi i realizueshmërisë për linjën 400 kV i filluar në vjeshtë të vitit 2004, me datën e dëshiruar për përfundim të Korrikut 2005. Objektiva e studimit është e dyfishtë; (i) të zgjidhet rruga optimale dhe të përgatitet një raport i detajuar i realizueshmërisë në formë të projektit të kualifikuar për bankë për varantin e zgjedhur, dhe (ii) të analizohen karakteristikat operative të dy sistemeve plotësuese të sistemit të energjisë dhe të përgatitet një draft marrëveshje për bashkëpunim komercial në mes tyre. Theks i veçantë në analiza, është dhënë në studimin e ndikimit pozitiv të linjave të reja të shkëmbimit të energjisë në rajon dhe mundësitë për bartjen e energjisë nga termocentralet e reja të parapara në Kosovë për të ardhmen (pas 2010). Kur të kompletohet dhe të aprovohet, raporti do të prezantohet tek institucionet ndërkombëtare të financimit për mbështetje të investimit.

Në mes të 4 alternativave të studiuara, varianti i Kasharit (Tirana) – Vau i Dejës – Kosova B është zgjedhur nga Komiteti Drejtues i përzier i përbërë nga Kosova-Shqipëria në baza të analizave tekniko-ekonomike, duke ofruar variantin e preferuar. Tash kjo do t'ju nënshtrohet analizave përfundimtare të detajuara. Linja duhet të jetë në veprim kah viti 2010 me së voni.

Varianti i zgjedhur do të kushtojë rreth 50,904,000 €, nga të cilat, shpenzimet brenda territorit të Kosovës janë vlerësuar të jenë 19,643,000 € dhe në Shqipëri, 31,261,000 €.

3.11 Termocentrali i ri për djegien e Linjtit

Është e qartë që furnizimi i mjaftueshëm i thëngjillit është parakusht për shqyrtimin e një termocentrali të ri. Në përkrahje të AER-it, një konsorcium evropian në mes të muajt prill 2005 ka dorëzuar një draft raport përfundimtar për Planin e Minierës Kryesore të Sibovcit (minierë e re). Sipas Raportit, resurset gjeologjike të Sibovcit janë vlerësuar në një lartësi prej 990mt në një hapësirë prej 19.7 km². Kualiteti i mirë i linjtit në minierën e Sibovcit është karakterizuar me përcjelljen e vlerave mesatare: përmbajtje e hirit - 13.9%, vlera më e ulët e djegies - 8,150 kJ/kg, lagështia - 47.8%, sulfur - 0.9%, dhe mbingarkesa shumë favorizuese e fuqisë së thëngjillit dhe dendësia e thellësisë. Janë studiuar gjashtë variantet kryesore. Varësisht nga varianti përfundimtar i zgjedhur, niveli i prodhimit vjetor, dhe sa a të përdoren pajisje të reja apo ato të vjetrat, shpenzimet më të ulëta janë kalkuluar në një kufi prej 5.9/t € - 6.8/t €, përderisa në disa raste ato mund të shkojnë deri në 7.7/t € (është aplikuar vlera e zbritjes prej 12%).

Letra e Bardhë⁴ ofron udhëzime për zhvillim afat mesëm deri në afatgjatë të sektorit të energjisë dhe vendos udhëzime specifike që sigurojnë kualitetin dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike. Sipas Letrës së Bardhë linjite i vendit në dispozicion duhet të ofroj mundësi për zhvillimet dhe veprimin e një TC të ri. Për më tutje, Prodhuesit e Pavarur të Energjisë (PPE-të) inkurajohen që të investojnë në sektorin e energjisë duke furnizuar tregun e energjisë për shtëpiake duke ju lejuar atyre eksport të energjisë elektrike me shumicë në tregun rajonal.

Sfondi Teknik

AER-i do të financoj studimin e para-realizueshmërisë për termocentralin e ri të linjtit, fillimi i të cilit është planifikuar për mesin e muajt maj të vitit 2005, me datë për përfundim fundin e vitit 2005. Studimi do të ndërtoj në një studim të sapo përfunduar duke adresuar planifikimin afat mesëm dhe afat gjatë të minierave të minierave të linjtit duke përfshirë hapjen e minierës(ve) së re të Sibovcit. Punët në minierën e Sibovcit duhet të fillojnë në vitin 2006 me qëllim që të mundësohet nxjerrja tregtare e linjtit e deri në vitin 2008/2009.

Objektiva specifike e studimit të realizueshmërisë është që të ofroj për palët e interesuara (IFI, investuesit, zhvilluesit, etj.) me udhëzime kryesore për zhvillim të TC të ri për djegien e linjtit që do t'i kontribuojë edhe sigurisë së energjisë në Kosovë si dhe tërë rajonit të EJL-së.

Rezultatet e pritura do të përfshijnë:

- Vlerësimin e situatës aktuale dhe draftimin e metodologjisë krahasuese dhe analizave organizative për evaluimin e mundësive alternative të zhvillimit për një TC të linjtit;
- Rekomandimin për vendin më të përshtatshëm për zhvillimin e TC të mundshëm të linjtit të kapacitetit 1000 MË;
- Hartimi themelor i opsioneve të alternativave të TC-së të linjtit me një kapacitet prej 1000 MË parashihet që gradualisht të zhvillohet dhe të përbëj 2–5 blloqe;
- Mundësitë ekonomike dhe financiare të zhvillimit alternative të TC-së së ri;
- Një plan aksionar për zhvillimet e një Termocentrali të ri të linjtit në Kosovë.

Sfondi Ligjor dhe Rregullativ – Licencat dhe Lejet për Kapacitet të ri Prodhues

Rregulla për licencim do të themelojë kriteret e përgjithshme që kanë të bëjnë me lëshimin e lejeve për ndërtimin e objekteve të reja të energjisë dhe linjave direkte të energjisë elektrike dhe kycjeve të ngrohjes qendrore (“linjat direkte”). Udhëzime të ndara (në tekstin në vazhdim “Udhëzimet”) e lëshuara nga ZRrE-ja do të vendosin kriteret e detajuara, me të cilat ZRrE-ja do të jap leje për ndërtimin e objekteve të reja dhe linjave direkte.

ZRrE-ja ka autoritet që të jap ose refuzoj një kërkesë për leje ose licencë, dhe të modifikoj, ndërpres ose lëshoj sanksione për të licencuarit ekzistues dhe poseduesit e lejeve, sipas dispozitave të vendosura në këtë Rregull, Ligjin për Energji, Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energji Elektrike dhe legjislacionin për ngrohje qendrore si dhe rregulloret e tjera të aplikueshme të lëshuara nga ZRrE-ja dhe të vendosura në ligjet e aplikueshme në Kosovë.

Rregulla për Licencim ofron kornizën e përgjithshme për parashtrim të kërkesës në ZRrE për leje. Ashtu siç thuhet në Kapitullin 1, Neni 1, udhëzimet e veçanta, të lëshuara nga ZRrE-ja, vendosin

⁴ Letra e Bardhë është draft Politika e Energjisë për Kosovën dhe Letra e Strategjisë që është përgaditur nga Zyra e Energjisë nën NJQRR dhe është dorzuar në shtator 2003 tek zyra e Kryeministrit (ZKM) për aprovim. Në vitin 2004, një version i shkurtër i quajtur Strategjia e Energjisë së Kosovës është përgaditur nga Zyra e Energjisë nën ZKM. Asnjë nga verzionet nuk është aprovuar deri më tani.

kriteret e detajuara, me të cilat ZRrE-ja jep lejet. Udhëzimet jepen në bazë të principeve objektive, transparente dhe jodiskriminuese, dhe janë të vendosura në përputhje me Programin për Zbatimin e Strategjisë, të përgatitur dhe miratuar nga Ministria e Energjisë dhe Minierave.

Kriteret për dhënien e lejeve mund të qojnë në:

- a) Siguri dhe besueshmëri të sistemit të energjisë, instalimeve dhe pajisjeve të ndërlidhura;
- b) Mbrojtje të sigurisë dhe shëndetit publik;
- c) Mbrojtje të mjedisit;
- d) përdorim të tokës dhe qëndrim;
- e) Përdorim të pronës publike;
- f) efikasitet të Energjisë;
- g) Lloji i burimit primar të energjisë i aplikuar për marrëdhënie të qëllimeve ekzistuese të politikave për nevojat e sektorit;
- h) Karakteristikat e veçanta të aplikuesit, siç janë ato të aftësive teknike, ekonomike dhe financiare;
- i) Përmbushje e masave në lidhje me detyrimet e shërbimit publik dhe mbrojtjen e konsumatorëve;
- j) Ndonjë skemë e projektuar për nisjen e aktivitetit të energjisë.

ZRrE-ja do të nxjerr një pëlqim për ndërtim të ri kur aplikuesi të zotërojë resurse teknike dhe financiare për të ndërtuar një objekt të energjisë dhe përmbush të gjitha kërkesat e vendosura në këtë Rregull dhe në udhëzimet.

Një parashtrues i kërkesës për leje për ndërtim të rrjetit duhet ti bashkëngjisë kërkesës së tij për ZRrE, një studim të realizueshmërisë që përfshin kalkulimin e ndikimit të projektit në ngarkesat e rrjetit, dhe përshtatjen e tij me planin e zhvillimit të rrjetit të aprovuar.

Para kërkesës formale për leje, subjekti ligjor që kërkon të ndërtoj një objekt të ri të energjisë mund të kërkojë aprovimin preliminar për leje nga ZRrE-ja.

Një parashtrues i kërkesës për leje do të dorëzojë tek ZRrE-ja dokumentet në vazhdim:

- a) Një pëlqim mjedisor nga Ministria përkatëse në përputhje me Ligjin e Ambientit Nr. 2002/8 të 16 janarit 2003, ashtu siç është nxjerrë nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/9 e 15 prill-it 2003;
- b) Një Liçencë ose leje për shfrytëzim të thëngjillit ose të karburanteve të tjera e lëshuar nga autoriteti përkatës;
- c) Një skemë e kryerjes së projektit dhe data e fillimit;
- d) Në rast të hidrocentralit, një leje për shfrytëzim të ujit;
- e) Të gjitha dokumentet e tjera ashtu siç specifikohet në Udhëzime.

Të gjitha aplikacionet për leje për objektet e prodhimit do ti nënshtrohen procesit të dëgjimit publik, në përputhje me procedurat e vendosura nga ZRrE-ja në udhëzimet e saj, para çfarëdo vendimi të marrë nga ZRrE-ja për lëshimin e lejes.

Të gjitha lejet e lëshuara nga ZRrE-ja duhet të parashohin periudhën kohore të lejuar për fillimin dhe kompletimin e ndërtimit. Koha e tillë do të jetë mandat i ZRrE-së, në përputhje me skemën e përgatitur nga poseduesi i lejes.

Në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe vetëm në rast se procedura për autorizimin e bazuar në treg nuk ka rezultuar në ndërtimin e mjaftueshëm të objektit për energji, ZRrE-ja do të lëshojë një tender për ndërtim të objekteve të reja të energjisë.

ZRrE-ja do të publikoj në buletin e saj dhe në website-in arsyen për nevojën e tenderimit dhe do të specifikoj llojin e investimit që kërkon procesin tenderues për ndërtim të ri.

ZRrE-ja do të përgatisë një përshkrim të detajuar të të gjitha dokumenteve që kërkohen për dorëzimin e aplikacionit të lejes dhe do të rendisë ato si pjesë të specifikacionit të tenderit.

Tenderuesi i suksesshëm duhet të plotësojë të gjitha kriteret e tenderit. ZRrE-ja duhet të shqyrtoj kriteret e tilla ashtu siç janë të vendosura në Ligjin e Rregullatorit dhe të gjitha ligjet e aplikueshme në Kosovë.

ZRrE-ja do të informoj me përpikmëri të gjithë tenderuesit me shkrim për vendimin për dhënien e tenderit.

Me dhënien e tenderit, tenderuesi i suksesshëm, brenda kohës së arsyeshme, do të dorëzoj në ZRrE të gjitha dokumentet e kërkuara në Kapitullin 5 dhe në Udhëzimet për aplikacionin e lejes, përveç nëse këto dokumente janë dorëzuar më herët në ZRrE, në përputhje me Nenin 8.3. Menjëherë pas dorëzimit në ZRrE të të gjitha dokumenteve që kërkohen për leje, ZRrE-ja do t'i japë tenderuesit të suksesshëm lejen.

Pas përfundimit të ndërtimit të objektit të energjisë sipas lejes, ndërmarrja e energjisë të cilës i është dhënë leja duhet të dorëzojë në ZRrE të gjitha dokumentet e kërkuara për licencë.

Kur poseduesi i lejes të ketë përmbushur të gjitha kushtet e përcaktuara nga ZRrE-ja dhe, pas përfundimit të ndërtimit, të ketë përmbushur të gjitha kërkesat e dokumentacionit të parapara në këtë rregull, ZRrE-ja do të lëshoj një licencë për veprim të objektit.

3.12 Prodhimi i fiksuar – Hidro Centralet

“Prodhimi i fiksuar” normalisht përfaqëson një shkallë të vogël të centraleve që janë pronë ose operohen nga njësitë e shpërndarjes ose ndërmarrjet private / sipërmarrësit. Prodhimi i tyre i energjisë elektrike futet/shitet në rrjetin e tensionit të mesëm (10 kV, 20/35 kV) të rrjetës së shpërndarjes. Sa i përket teknologjisë ato mund të jenë centrale industriale të bashkë prodhimit (shesin tepricat që kthehen në rrjet) ose hidrocentrale. Regjimi i tyre i prodhimit është i përcaktuar nga procesi industrial ose i dakorduar në mes të operuesit të centralit dhe operuesit të sistemit. Nëse ekzistojnë mundësitë teknike (p.sh. deponimi i ujit), centrali mund të përcjell preferencat e sistemit dhe të kontribuojë në ngarkesën e pikut, e cila rrit sasinë e energjisë së prodhuar dhe kapacitetin në dispozicion. Se a duhet të jetë kapaciteti të instaluar më të madh 5 MW, një objekt i tillë i prodhimit duhet të ketë licencë për veprimin e tij sipas ligjit.

Aktualisht, është vetëm një hidrocentral në Kosovë i këtij lloji, veprimi i të cilit duket se do të filloj kah fundi i vitit 2005 pasi që rehabilitimi, i cili është në vazhdim të jetë përfunduar – HC Kozhnjer në rajonin e Deçanit. HC së pari është mandatuar në vitin 1957. Veprimi i tij është ndalur në vitin 1998, kur edhe është shkëputur dhe demoluar gjatë dhe pas konfliktit. Bazuar në iniciativën e investuesit privat nga diaspora Kosovare, një marrveshje afat gjatë ndërlidhëse (20 vjet) dhe një marrveshje 5 vjeçare për shitblerjetë energjisë (MSHB – sipas Ligjit) janë nënshkruar me KEK-un/AKM-n në vitin 2005. Në përputhje me Ligjin ZRrE-ja duhet të shqyrtoj dhe aprovoj MSHB-në, gjë të cilën ZRrE-ja e ka bërë dhe kadhënë pëlqimin në lidhje me të. Pas rehabilitimit, HC do të jetë në gjendje që të ofroj 2x4 MVA dhe të prodhoj përafërsisht 26,000 MWh/vit. Vlenë të theksohet se kjo është iniciativa e parë e një investuesi privat në sektorin e energjisë të Kosovës pas konfliktit (Financimi i Projektit).

Përveç Kozhnjer-it, janë disa HC të vogla që kanë nevojë për rehabilitim (HC Dikanc - 1.56 MVA, HC Radavc – 280 kVA dhe HC Burim – 560 kVA), para se të ristartohen. Për shkak të kapacitetit të tyre të vogël, këto centrale nuk kanë nevojë për ndonjë licencë prodhimi nga ZRrE-ja.

4. Zhvillimet e ardhshme në Sektorin e Energjisë në Kosovë

4.1 Ndarja e KEK-ut – Themelimi i OST-së

Në kornizën e tregut të liberalizuar të energjisë elektrike, efikasiteti i volitshëm ekonomik dhe alokimi i kostos, Akces I Palës së Tretë me kushte të barabarta dhe menjanim ndër-subvencionimit e që kërkon ristrukturim të kompanive të integruara vertikalisht, posaqërisht ndarjen e funksioneve të transmetimit dhe shpërndarjes të KEK-ut. Ky gjithashtu është një detyrim i vënë nga traktati i ECSEE-së.

Katër funksionet konvencionale të transmetimit janë:

- Pronësia e Rrjetit (planifikimi afatgjatë dhe zgjerimi)
- Veprimi i Transmetimit (Mirëmbajtja dhe planifikimi afat-shkurtër)
- Veprimi i Sistemit (dispeçingu në kohën e reale dhe kontrolli duke përfshirë balancimin)
- Veprimi i Tregut (Programimi i transaksioneve të energjisë elektrike, Administrimi i Rrugëve të Rëndura, Qartësimi pasë rrjedhave reale të energjisë))

Për shkak të konfliktit të qartë të interesave, është evidente që dy funksionet e fundit duhet të ndahen nga çdo ndërmarrje e energjisë që kontrollon prodhimin ose furnizimin për shkak të objektivitetit, drejtësisë dhe transparencës. Kjo është arsye se pse ndarja e aktiviteteve ka qenë kërkesë e legjislacionit për ristrukturim. Që nga fillimi, ristrukturimi i industrisë së Energjisë Elektrike dhe derregullimi ka nxjerrur debat më të madh përtej “temës së nxehtë” se a duhet ët ndahet Pronësia e Sistemit të Transmetimit nga Veprimi i Sistemit të Transmetimit. Që të dy metodat janë lejuar nga Direktiva Evropiane, përderisa të kenë pamvarsi menaxheriale në vendimmarrje dhe të jenë të ndara m ligj. Ky raport nuk ka për qëllim që të intervenoj në zgjatjen e debatit, i cili gjithashtu është duke u marrur në konsideratë në Kosovë, megjithatë ZRE-ja ka preferencë të qartë për model të “Kompanisë së Integruar të Transmetimit – OST” i cili trashëgon asetet e transmetimit të ndërmarrjes në detyrë, përderisa pretendohet përgjegjësia për Veprim të sistemit, me qëllim që të lehtësohet konkurrenca nën kushtet e bazuara të tregut. ZRE-ja beson që një operues jo profitabil – por jo pronar i linjës së transmetimit (Operatori i Pavarur i Sistemit) ka nevojë për strukturë të iniciativave që kërkohen për tu përgjegjur kushteve të tregut dhe kështu ka mosefikasitete të trashëguara, që i përmban brenda vetes. Si vazhdim, transferi i kontrollit të aseteve – por jo pronësia – tek një agjension me iniciativë të vogël për të maksimalizuar fitimin e këtyre aseteve ka pak kuptim nga prespektiva e biznesit. Megjithatë qështja e modelit të zgjedhur të strukturës përfundimtare nuk është që ZRE-ja të merr vendim por të inkuadrohet në vendimin politik (MEM) dhe natyrisht edhe të vet KEK-ut. Ristrukturimi i kërkuar i funksioneve të transmetimit të KEK-ut (Strategjia dhe Planifikimi) është shqyrtuar nën projektin rajonal të SEETEC-ut të përkrahur nga CIDA e Kanadës (të kompletuar në janar 2005). Rekomandimet e këtij veprimi do të ndihmojnë organet e IPVQ-së si dhe BB-në (ESTAP III) dhe konsulentët e

AER që të vazhdojnë me hartimin përfundimtar të OST-së së ardhshme të Kosovës dhe gjatë fazës së zbatimit të themelimit të OST-së

Procesi deri sa OST-ja të bëhet tërësisht funksionale do të përcillet si skema drejtuese në vazhdim:

- AER: AT për korporatizimin e NP-ve (TSO-KEK mund të inkorporohet si subjekt i ndarë ligjor, ose si një ISO me pajisje që mbesin nën “komani mbajtëse” KEK), fillon: janar 2005 (shih Pjesën 4.2);
- BB: AT për OST, fillon: mesi i vitit 2005 (Përpilimi i Kodit të Rrjetit për OST/korniza e politikës së transmetimit) fillon në mes të vitit 2005 (shih gjithashtu Pjesën 2.6);
- EAR: AT për Përkrahje të Ndërtimit Institucional për ZRrE-në (detyrë e ndërlidhur: Modeli i Tregut dhe Metodologjia e Tarifave);
- BB: AT për Zhvillimin e tarifave (transmision, shitje me pakicë, etj.) fillon: mesi i vitit 2005 (shih gjithashtu Pjesën 2.6); dhe
- AER: zbatimi / themelimi i OST-s (Përshkrimi i punës nuk është ende në dispozicion).

Në vitin 2004-2005, ZRrE-ja ka marrë pjesë në Komitetin Drejtues(KD) të ESTAP III si dhe në KD të “Projektit i korporatizimit” të AER-it. Sipas legjislacionit primar të energjisë, ZRE është e ngarkuar me monitorimin e menaxhimit dhe llogarive të ndara në KEK. Gjithashtu, me mungesën aktuale të Operuesit të Tregut në Kosovë, ZRE-ja ka marrë udhëheqjen në përgatitjen e Hartimit fillestar të Tregut të Energjisë për Kosovë, ku është me rëndësi vendimi për modelin strukturues të OST-së.

Bazuar në konkluzionet e takimit në mes të Enteve përgjegjëse, në shkurt të vitit 2005, do të themelohet një GDKE (Grupi Drejtues i Komunitetit të Energjisë Energji), me synimin që të lehtësohet zhvillimi i ndryshimeve të ndjeshme institucionale, në kohën e duhur dhe në mënyrë të mirë-koordinuar. Kohët e fundit, çështja e koordinimit është konsideruar si e mangët nga disa donatorë. Në GDKE, do të marrë pjesë aktivisht edhe ZRrE-ja.

4.2 Inkorporimi i NP-ve (KEK-u dhe Kompanitë e NQ-së)

Në shkurt të vitit 2005 AER-i ka filluar projektin për inkorporim të ndërmarrjeve publike (NP-ve) duke përfshirë KEK-un dhe kompaninë e NQ-së në Prishtinë (Termokos). Kjo është një parakusht për ndarjen e KEK-ut dhe themelimin e Operatorëve të Transmetimit dhe të Tregut ashtu siç parashihet nga ligji. Siç është shpjeguar më gjerësisht më lartë, një Operator i Sistemit të Transmetimit (OST) i fortë me pronësinë e aseteve është opsion i preferuar për OST-në në Kosovë, së pari për shkak të trajtimit paanshëm të ndërmarrjes ekzistuese (KEK) dhe ndonjë PPE në të ardhmen. Planifikimi i paanshëm dhe veprimi i Sistemit të Transmetimit, alokimi i kapaciteteve ndër-kufitare, trajtimi i menaxhimit të kongestionit, dhe qasjet në rrjetet e transmetimit është bazë për besueshmërinë e investuesve. Si vazhdim, për shkak të sferës së vogël të pjesëmarrjes së tregut të energjisë elektrike në Kosovë në të ardhmen, për të maksimizuar sinergjinë dhe të përdoren në mënyrë optimale resurset dhe infrastruktura ekzistuese, funksioni i Operatorit të Tregut duhet gjithashtu të mbetet me OST-në. Si pasojë, rekomandohet që Operuesi i Pavarur i Tregut dhe i Transmetimit (OPTT) të themelohet në Kosovë sa më shpejt që është e mundur. Një OPTT e tillë do të ketë nevojë për dy licenca të veprimit nga ZRrE-ja, për OST dhe OM.

Në prill/maj 2005, një raport fillestar do të përgatitet nga konsulentët, ku do të përgatitet një mënyrë e detajuar e inkuorporimit. Duke ju nënshtruar aprovimit nga Komiteti Drejtues, ku ZRrE-ja është e përfaqësuar gjithashtu, KEK-u gjithashtu duhet të inkuorporohet deri në fund të vitit 2005.

4.3 Emërimi i Konsumatorëve të Privilegjuar – Hapja e Tregut

‘Konsumatorët e Privilegjuar’ nënkupton konsumatorët që janë të lirë të blejnë energji elektrike nga furnizuesit sipas zgjedhjes së tyre ashtu siç përshkruhet në “definicionet” e Direktivës së BE-së; 2003/54/KE, dhe Ligjit të Kosovës për Energji Elektrike 2004/10.

Kriteret e Privilegjit:

Kërkesat e privilegjit mund të jenë:

- *Teknike:*
 - niveli vjetor i konsumit të energjisë elektrike
 - kycja në nivelin e tensionit të lartë ose të ulët
- *Ligjore:*
 - statusi i banimit ose banimit të përhershëm
 - të mos ketë imunitet nga persekutimi lokal
 - mundësia që të persekutohet në emrin e tij
- *Ekonomike dhe financiare:*
 - pagesa e faturave të energjisë elektrike deri në ditën e fundit;
 - aftësia kreditore, i përcaktuar me indikatorët financiar të kalkuluar bazuar në të dhënat nga bilanci dhe llogaria e profitit dhe humbjes.
 - Likuiditeti aktual
 - Aftësia e pagesës
 - vlera e fitimit bruto

Në përputhje me Nenin 22.2 të Ligjit për Energji Elektrike, MEM-I do të përshkruaj kushtet për përcaktimin e konsumatorëve të privilegjuar në një udhëzim implementues që do të miratohet jo më vonë se me 31 janar të secilit vit. Kriteret do të përfshijnë zgjerimin e konsumit të tyre të energjisë elektrike dhe proporcionin e shpenzimeve të energjisë me çmimet e produkteve dhe shërbimeve të tyre.

Emërimi i Konsumatorëve të Privilegjuar

Një konsumator mund të marr statusin e konsumatorit të privilegjuar duke u përgjigjur në shpalljen publike që Zyra e Rregullatorit për Energji do të nxjerr çdo vit (Neni 22.3 i Ligjit për Energji Elektrike).

Të drejtat e konsumatorëve të privilegjuar

- Të drejtën që të lidh kontrata me: Furnizuesit, tregtarët, prodhuesit, sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes

- Të ketë mundësi që të furnizohet nga furnizuesi publik sipas procedurave të themeluara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

Detyrimet ndaj rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes

Konsumatori i privilegjuar duhet të njoftoj operuesin e rrjetës së transmetimit më herët për kontratat që do të nënshkruaj për furnizim të energjisë elektrike, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në Kodin e Tregtisë (Rregullat e Tregut) të lëshuar nga operatori i tregut dhe të aprovuar nga ZRE-ja (Neni 22.5 i Ligjit për Energji Elektrike).

4.4 Perspektivat për Burimet e Energjisë së Ripërtitëshme

Bazuar në vlerësimet e publikuara në raportet e ESTAP i të BB-së, Kosova ka potencial të vogël të hidrocentraleve (1982 TWh/a), biomasës si dhe burimeve gjeotermale me temperature të ulët, dhe potencial të vogël të erës dhe energji solare.

Posaçërisht, biomasa/druri është një resurs i rëndësishëm që përdoret për ngrohje në shtëpitë individuale. Sipërfaqja totale me drunj është më shumë se 4,000 km², me rezerva të drurit prej 30 milion m³. Rritja vjetore e rezervave të drurëve është rreth 1.0 milion m³, krahasuar me konsumin e vlerësuar (viti 2000) prej rreth 1.0 milion m³ vetëm të drurit për ndezje. Më shumë drunj janë prerë për shfrytëzim në sektorin e gjallëruar të ndërtimit. Këto të dhëna tregojnë që konsumi i lëndës djegëse të drurit në Kosovë ka arritur nivelin gati të njëjtë me ri-rritjen e pyjeve, kështu që në vitet e ardhshme konsumi i drurit duhet të mbahet nën kontroll me qëllim që të parandalohet zbrazja e pyjeve.

Ashtu siç është dëshmuar më lartë, prodhimi nga hidrocentralet është në një shkallë mjaft të vogël. Hidrocentralet i planifikuar i Zhurit në disa skenarë, me përafërsisht 292 MW kapacitetit të instaluar dhe total të prodhimit vjetor përafërsisht 400 GWh, përfaqëson gati 60% të prodhimit potencial të hidro-energjisë teknike të realizueshme në Kosovë. Përveç disa rrjedhjeve në të cilat do të ishin të mundura teknike ndërtimet e shkallës së vogël / mikro hidro centrale, një tjetër rajon i mundshëm është zona e Bjeshkëve të Rugovës në afërsi të Pejës. Nëse problemi kryesor i ndërlidhur me HC Zhuri është relativisht i një kostoje të lartë për prodhimin e energjisë elektrike, lugina e Rugovës është shumë e ndjeshme dhe e diskutueshme nga aspekti mjedisor.

Energjia gjeotermike është në dispozicion në pjesën veriore të Kosovës, në Malishevë, Klllokot etj. Megjithatë, resurset nuk janë zbuluar ende për shkak të mungesës së punëve hulumtuese në të kaluarën.

Resurset e erës janë llogaritur të jenë të vogla për shkak të lokacionit specifik të Kosovës të rrethuar me bjeshkë zinxhirore në shumicën e drejtimeve. Deri më tani potencialet nuk janë vlerësuar si duhet.

Ngrohja solare në një kontest merret si potencial i burimit të temperaturave të ulëta. Bazuar në të dhënat meteorologjike për Kosovën dhe efikasitetin e mbledhësve modern solar është e arsyeshme që të merret parasysh kapaciteti i pikut të prodhimit në muajt korrik dhe gusht prej përafërsisht 300 W/m² dhe prodhimi i përgjithshëm vjetor prej përafërsisht 360 kWh/m²/vit. Megjithatë, për shkak të kostonë së saj energjia solare mund të merret në konsiderim nëse ka nxitje të duhura (taksa më të ulëta ose dogana të importit për shembull). Nëse do të ndodhte kështu, ngrohja solare mundësisht do të përdorej për të zvogëluar kërkesën për energji elektrike që aktualisht përdoret për ngrohje.

4.5 Perspektiva e Liberalizimit të Sektorit të Energjisë së Kosovës

Konkurrenca, rregullimi dhe pjesëmarrja e sektorit privat janë faktorët kyç për performancë të mirë të sektorit të energjisë.

Disa karakteristika tipike të tregut të liberalizuar të energjisë:

- Numri i konsumatorëve të privilegjuar (dhe përqindja e totalit të kërkesës), çka tregon nivelin e hapjes së tregut;
- Sa Konsumatorë të Privilegjuar kanë furnizues të ndryshëm, çka tregon nivelin e konkurrencës së lirë;
- Pa sjellje monopoliste, keqpërdorim të tregut ose çmime të larta të pa arsyeshme - ekzistimi i konkurrencës në të gjitha nivelet, përfundimisht qon në çmime më të ulëta tek konsumatorët e fundit;
- Qasje e lirë në rrjete në bazë të rregullave jo-diskriminuese dhe tarifa të publikuara;
- Trajtim i njëjtë i kushteve të detyruara – menaxhim i kongestionit dhe kontesteve.

Për shkak të sistemit të vogël të energjisë në Kosovë, mund të themelohet një treg i efektshëm, likuid, i liberalizuar me llojllojshmëri të prodhimit – në afat të mesëm – në nivel nën-rajonar me një bashkëpunim të ngushtë dhe harmonizim të kornizës së rregullatorit me rregullat e tregut të sistemeve fqinje. Rregullat për qasje në rrjet dhe në kapacitetin ndërlidhës janë veçanërisht të rëndësishme, prej të cilëve do të përfitonin shumë sisteme fqinje, pasi ato janë të çmueshme në shumë aspekte. ZrRE-ja do të punoj në promovimin e themelimit të tregut nën-rajonar në afat të shkurtër si dhe natyrisht pjesëmarrja në procesin e SEEREM.

Në të ardhmen pjesëmarrja e sektorit privat kërkohet posaçërisht në biznesin e shpërndarjes dhe furnizimit me qëllim që të ofrohet konkurrenca për KEK-un dhe nxitja për uljen e humbjeve jo-teknike shumë të larta dhe atyre të rrjetit. Përveç tjerash, ka opsione tjera me qëllim që të përmirësohet performanca në sektorin e energjisë si, marrëveshjet kontrata/kongestion (duke shtuar kapitalin privat) kontratat menaxhuese (transferim i njohurive) dhe/ose privatizimi i mundshëm në të ardhmen – të gjitha këto do të rrisin efikasitetin dhe përfitimet e të licencuarve të ardhshëm të ZRRE-së.

4.6 Procesi i Athinës

Qysh në fillim të vitit 2002 KE mori iniciativën që të zhvilloj dhe të harmonizoj kornizën rregullative në EJK (SEE), në mënyrë që të lehtësohen investimet, të përforcohet siguria e furnizimit për tërë rajonin dhe të kontribuohet në shpejtimin e ngritjes ekonomike. Ky është quajtur “Procesi i Athinës”. Në emër të Kosovës të Administruar nga UN-i, UNMIK/ shtylla e BE-së ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit (MeM) për Tregun Rajonal të Energjisë Elektrike (më pas të quajtur Komuniteti i Energjisë i Evropës Jug Lindore – KEEJK ECSEE) në Prill të vitit 2002 dhe versionin e ripunuar në Dhjetor të vitit 2003. Duke vepruar kështu, Kosova është bërë partner i barabartë dhe lojtar në themelimin e KEEJK.

UNMIK-u në emër të Kosovës tashmë ka iniciuar në Mars të vitit 2004 Traktatin (Marrëveshjen) që themelon “Komunitetin e Energjisë për Evropën Jug Lindore” (Traktati i KEEJK-së) dhe po

planifikon të nënshkruaj atë në korrik të vitit 2005. Inicim nënkupton të gjitha palët janë tani në Marrëveshje me Tekstin, përderisa hyrja e tij në fuqi është planifikuar për fillimin e vitit 2006, nëse ka sukses procesi i ratifikimit nga Komisioni Evropian dhe 6 palët kontraktuese. Pjesëmarrja në Traktatin KEEJL është një mekanizëm i rëndësishëm për të implementuar politikat e lartpërmendura sfiduese të sektorit të energjisë.

Traktati do të nënshkruhet në mes të Komunitetit Evropian në një anë dhe Palëve Kontraktuese në anën tjetër (që tash e tutje do të quhen palët Anëtare). Janë dhjetë (10) palë të tilla: Republika e Shqipërisë, Republika e Bullgarisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Kroacisë, ish Republika e Jugosllave e Maqedonisë, Republika e Malit të Zi, Rumania, Serbia, Republika e Turqisë dhe Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë si pasuese e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Qëllim kryesor i Traktatit, është që të themelohen marrëdhëniet e kufizuara me ligj mes Palëve, me qëllim që të krijohet korniza ligjore dhe ekonomike e harmonizuar e ndërlidhur me Rrjetet e Energjisë. Palët kontraktuese janë zotuar të miratojnë *Acquis Communautaire (Pajtimet e Komunitetit)* të Unionit Evropian për Energji, Mjedis, Burime të Renovueshme, dhe Konkurrencë.

Gjithashtu, objektivat specifike janë:

- Të krijojë një kornizë stabile dhe rregullative të tregut që është e mjaftueshme për tërheqjen e investimeve në Sistemin e Energjisë.
- Të krijojë hapësirë të vetme rregullative për tregti në rrjetin e energjisë, do të mjaftojë për arritjen e zgjerimit gjeografik të tregjeve për prodhimeve në fjalë,
- Të rrisë sigurinë e furnizimit në një hapësirë të vetme rregullative, duke ofruar një klimë të qëndrueshme për investime, ku mund të zhvillohet hyrja në rezervat e gazit Kaspik, Afrikës Veriore dhe Lindjes së Mesme, si dhe të bëhet zbulimi i rezervave vendore të gazit natyror dhe thëngjillit,
- Të përmirësojë gjendjen e mjedisit në raport me Rrjetin e Energjisë, të rrisë efikasitetin e energjive përkatëse, të kujdeset për përdorimin e energjisë së rinovueshme dhe të vendosë kushtet për tregtimin e energjisë në një hapësirë të vetme rregullative,
- Të zhvillojë konkurrencën e tregut të Rrjetit të Energjisë në shkallën e kufinjve gjeografikë dhe të zbulojë e shkallën e zhvillimeve ekonomike.

Për të arritur pajtueshmëri me legjislacionin e BE-së, *Acquis Communitarie* e Traktatit (Marrëveshjes), do të plotësojë kriteret specifike për: Energji; Mjedis; Konkurrencë; dhe burime të Rinovueshëm.

Shumica e legjislacioneve për energji dhe mjedis të BE-së, janë në formë Direktivash. Direktivat janë hartuar për vendosur detyrime mbi Shtetet Anëtarë, të cilët duhet të jenë mjaft fleksibël në implementimin e kërkesave të Direktivave, duke përdorur sistemet e tyre ligjore dhe administrative (Shtetet Anëtarë).

Legjislacioni i BE-së për energji përmban direktivat, rregulloret dhe vendimet në vazhdim:

- Direktiva 2003/54/KE e 26 Qershorit 2003, për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike, që shfuqizon Direktivën 96/92/KE; Direktiva 2003/55/KE e 26 Qershorit 2003, në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror, që shfuqizon Direktivën 98/30/KE; Direktiva 2001/77/KE e 27 shtatorit 2001, për promovimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e energjisë së rinovueshme në tregun e brendshëm të energjisë elektrike,


- Rregulloren (KE) Nr 1228/2003 të 26 Qershorit 2003, për kushtet e qasjes në rrjet për shkëmbim ndërkufitar të energjisë elektrike (CBT)
- Vendimi 2003/796/KE i 11 Nëntorit 2003, për themelimin e Grupit të Rregullatorëve të Evropës për Energji Elektrike dhe Gaz, Vendimi 1229/2003/KE i 26 Qershorit 2003, për vënien e një sërë udhëzimeve për rrjete të transmetimit të energjisë Evropiane dhe fuqizimin e Vendimit shfuqizues Nr. 1254/96/KE, Vendimi Nr. 1230/2003/EC i 26 Qershorit 2003, me adoptimin e programit shumëkombësh për veprim në sferën e energjisë: ‘Energji inteligjente – Evropë’ (2003 – 2006)

Shumica e Legjislacionit mjedisor të BE-së në lidhje me energjinë është në Direktivat në vazhdim të BE-së:

- Direktiva 2001/80/KE, për kufizimin e rrjedhjeve të disa ndotësve të ajrit nga termocentralet e mëdha të djegies; Direktiva 1999/32/KE, në lidhje me uljen e përmbajtjes së sulfurit të disa karburanteve të lëngshme, dhe plotësimi i Direktivës 93/12/KEE; Direktiva 96/62/KE, për vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis; Direktiva 1985/337/EEC për vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private për mjedis; Direktiva 79/409/EEC për mbrojtjen e zogjve të egër.

Institucionet e Komunitetit të Energjisë, duhet të menaxhojnë Procesin Rregullues të Athinës, ashtu siç janë treguar në skemën e Figurës 4.1.

Figura 4.1: Institucionet e Komunitetit të Energjisë



4.7 Detyrimet e Palëve Kontraktuese të Traktatit të KEEJL duke përfshirë Kosovën

Detyrimet specifike të Palëve Kontraktuese⁵ të Traktatit⁶ janë si në vazhdim:

- Implementojnë *Acquis Communautaire* për Energji:
 - o Implementojnë direktivat e BE-së n^r 2003/54 dhe 2003/55, dhe Rregulloret e KE n^r 1228/2003 brenda gjashtë muajve pas hyrjes në fuqi të Traktatit;
 - o Palët kontraktuese duhet të sigurojnë që konsumatorët e privilegjuar janë:
 - (i) Që nga 1 janari 2008, të gjithë konsumatorët jo shtëpiakë; dhe
 - (ii) Që nga 1 janari 2015, të gjithë konsumatorët.
- Ofrojnë skemën kohore (gjashtë mujore) për zbatim të *Acquis Communautaire* për Mjedis;
- Miratojnë Protokollin e Kiotos (një vit);
- Ofrojnë një plan për Komisionin Evropian të zbatimit të Direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE të Komunitetit Evropian për burimet e energjisë së ripërtëritshme,
- Miratojnë planet e zhvillimit që do t'i sjellin sektorët e tyre të energjisë, në nivel me Standardet e Përgjithshme të aplikueshme të Komunitetit Evropian, një vit pas përgatitjes së kësaj liste standardesh prej Sekretariatit dhe miratimit nga Këshilli i Ministrave, (për detaje mbi organet e KEEJL, shih Figurën 4.1);
- Të miratojnë gjendjet e sigurisë së furnizimit që përshkruajnë shumëllojshmërinë e furnizimit, sigurinë e teknologjisë, origjinën gjeografike të karburanteve të përmirësuara dhe elementeve të tjera (brenda një viti). Deklaratat e gjendjes duhet t'i komunikohen Sekretariatit të KEEJL (të vendosur në Vjenë), dhe do të jetë në dispozicion të secilës palë⁵ të traktatit. Ato duhet të rifreskohen çdo dy vjet. Sekretariati do të japë udhëzime dhe ndihmë në lidhje me këtë.

Në vazhdim të detyrimeve të lartpërmendura të nxjerra drejtpërdrejt nga Traktati i KEEJL-së, mes të tjerash, Kosova duhet të:

- Krijojë një kornizë stabile rregullative dhe kornizë të tregut që lejon veprim efikas të Rrjetit të Tregut të Energjisë dhe aftësinë për të thithur investimet në sektorin e energjisë;
- Marrë masa dhe përkrahë ndërmarrjet e energjisë që të përmirësojnë përmbushjet e tyre teknike dhe financiare;
- Themelojë një Operator të Pavarur të Sistemit të Transmetimit (OST) ose një OST të ndarë nën një organizatë të energjisë të integruar vertikalisht të KEK-ut (6 muaj pas hyrjes në fuqi të traktatit);
- Marrë masa për të përmirësuar kapacitetet e sistemit të transmetimit dhe ndërlidhjet;
- Ministria e Energjisë dhe Minierave vendos kriteret për konsumatorët e privilegjuar;

⁵ UNMIK-u duke qenë Palë Kontraktuese megjithatë nuk ka nevojë për ratifikim pasi që Traktati të jetë nënshkruar nga PSSP-ja i UNMIK-ut.

⁶ Draft – Verzioni përfundimtar i datës 22 shkurt 2005.

- Sigurojë që nuk ka detyrime doganore dhe kufizime sasiore në importin dhe eksportin e rrjeteve të energjisë (energji elektrike dhe gaz).

4.8 Hartimi i Tregut Standard – Prospektet për Tregun e Energjisë Elektrike të Evropës juglindore (EJL) dhe Pozita e Kosovës në një Treg të tillë

Ashtu siç është përmendur në kapitujt e mësipërm, “Procesi i Athinës” është duke kërkuar krijimin e një tregu konkurrent rajonal për energji elektrike në Evropën Jug lindore, ku të gjithë konsumatorët gëzojnë furnizim të vazhdueshëm me energji elektrike dhe mund të zgjedhin furnizuesin e tyre. Tregu i energjisë elektrike duhet të sjellë energji me çmim të arsyeshëm dhe nivel të lartë të shërbimeve për konsumatorin e fundit. Që të arrihet kjo objektivë, Komisioni Evropian ndërmerr iniciativa siç janë përshkruar, për të theksuar kërkesat themelore për palët nënshkruese KEEJL, që të miratojnë sa më parë legjislacionin dhe të ndërtojnë kapacitetin institucional dhe rregullat që do t’u mundësojnë që të jenë në nivel me *Acquis Communautaire*.

Megjithatë, Tregjet e Energjisë nuk zhvillohen gjatë një nate, vetëm duke i vendosur rregullat, por si rezultat i një hartimi të kujdesshëm. Vetëm duke e bërë futjen e konkurrencës, nuk krijohet një treg i tërë efikas, por ekziston nevoja e krijimit të rregullave, kombinimeve dhe marrëveshjeve tregtare të dizajnuara me kujdes. Një treg tërësisht konkurrent dhe i suksesshëm (në nivelin rajonal), është rezultat përfundimtar i kalimit nëpër etapa ku duhet të ekzistojnë parakushtet e nevojshëm për formimin e tij. Që tregjet të jenë konkurrense elementet që duhet të vendosen dhe të funksionojnë si duhet janë:

- Shumë Blerës dhe shumë shitës – mungesë e kompetencës së tregut nga të dy anët;
- Kërkesa dhe Furnizimi përkatës për çmimin;
- Vende të tregjeve Likuide (që absorbojnë lehtës tepricat ose humbjet e cilitdo lojtar pa njoftim për çmimin e tregut), dhe efikase (nëse pjesëmarrësit nuk mund të parashikojnë nga cila anë do të lëvizin çmimet);
- Qasje Transparente dhe jo diskriminuese në çdo pajisje esenciale (rrjete);
- Trajtimi i subvencioneve dhe kontrolleve të mjedis në mënyrë që të mos ndërhyjnë me punët e tregjeve.

Për të arritur të gjitha të lartpërmendurat në energji elektrike, skicimi është një punë thelbësore, kryesisht për shkak të karakteristikave fizike të saj, dhe aftësisë së mosruajtjes, duke rrjedhur nëpër rrugën e rezistencës më të vogël, që transmetimi i rrymës nëpër rrjet t’i nënshtrohet një rrjedhe të ndërlikuar ndërveprimesh fizike. Në këtë mënyrë, ajo që mund të ndodhë në njërin anë të sistemit, ndikon në kushtet e rrjetit shumë kilometra më larg dhe përfundimisht përhapet me shpejtësi të dritës. Karakteristika e parë bën që të kuptohet se Operatori i Sistemit i cili ka përgjegjësi për veprim në kohë reale, duhet të merret me **mosbalancim**; Karakteristika e dytë tregon që ndërveprimet e energjisë elektrike në rrjet, mund të ndikojnë në ndonjë ose në të gjitha ndërveprimet e tjera, duke kërkuar **Menaxhim të Kongestionit** nga OS-; karakteristika e tretë kërkon prodhimin e shërbimeve të tjera – **Shërbimet Ndihmëse** – të nevojshme që të bëhet integrimi dhe i gjithë sistemi të futet në veprim; dhe së fundmi, karakteristika e katërt nënkupton që OS duhet të jetë i ngarkuar me luhatjet nevojave të furnizimit dhe kërkesës, çekuilibrimet, kongestionin dhe varësitë e ndërsjella komplekse përmes procesit të **Skematizimit dhe Dispeçimit** në kohë reale. Rregullat e tregut që merren me katër tiparet e energjisë elektrike të sapo përmendura, janë katër shtyllat e një hartimi të mirë të tregut. Të gjitha aspektet e tjera të hartimit të tregut bëhen dukshëm më të hapura sapo të vendosen:

- Mosbalancimet;
- Menaxhimi i kongestionit;
- Shërbimet Ndhmëse;
- Skematizimi dhe Dispeçimi.

Tregu i plotë përfshin:

- **Tregjet Momentale** – Për shumicën e artikujve këto janë tregje për dërgim të menjëhershëm. Megjithatë në rastin e energjisë elektrike dhe për shkak të karakteristikave të saja natyrore, tregjet momentale zakonisht zhvillohen në baza të “**Një Ditë Para**” (“**Day Ahead**”) (p.sh. kërkesat dhe ofertat dorëzohen 24 orë më herët për tu kryer dërgesa ditën tjetër), zakonisht në regullimin prej një ore ose gjysëm ore. Energjia e kontraktuar kurrë nuk mund t’iu përgjigjet kërkesave aktuale në kohë reale, të pjesmarrësve të tregut, për këtë arsye Tregu Momental luan një rol të tregut “Një Ditë Para” – i cili u lejon pjesmarrësve të tregut, që rregullojnë pozitat e tyre dhe të lehtësojnë kontraktimin para kohës reale. Gjithashtu përdoret për të thjeshtuar dhe lehtësuar zgjidhjen e transaksioneve në mes të pjesmarrësve të tregut. Roli i Tregjeve Momentale të energjisë elektrike luhet nga **Bazenet** dhe gjithnjë e më shumë nga **Shkëmbyesite Energjisë Elektrike**. Shkëmbyesit e Energjisë Elektrike (Electricity PXs), janë “tregje të vetme të energjisë” pasi ata nuk marrin parasysh ndonjë aspekt teknik, dhe nëse zhvillojnë rrjetshmëri të përshtatshme, mund të ofrojnë në baza rajonale (muje) të treguesit të çmimeve publike, ku theksohet kulmi i vlerës së mallit (MËh), që ofrojnë etapë transparente për transaksione bilaterale dhe qëllimet e kufizuara. PXs janë të zhvilluar si pasojë natyrore e kërkesës së shprehur nga të gjithë Pjesmarrësit e Tregut në mënyrë që të ketë një treg të organizuar i cili lehtëson tregtinë e shkurtër, ku transaksionet anonime (një konsideratë e rëndësishme në ambientin e konkurrencës) mund të bëhen nën rreziqe të vogla të krediteve, pasi të gjitha transaksionet mbulohen nga qendrat llogaritëse të PXs. Palët që kontrollojnë rrejtat kur të ndodhë ndonjë kontratë e shkëmbimit (ose program i deklaruar në rast të DAM), dhe nuk mund të tregtohen më tej, do të kërkohet që të japë ose të pranojë energji në rrjetin TL (HV) të sistemit të Operatorit, ose t’i ekspozohet çmimit të mos-ekuilibrit. Çdo marrëveshje ndërkufitare, ose tregtare, ose tranzitore, që parasheh këtë, do të jetë përgjegjësi e këtyre palëve dhe jo e shkëmbimit.
- **Tregu Bilateral** – Sasia kryesore e transaksionit në energji elektrike, bëhet përmes kontratave bilaterale të shumë llojeve të të ashtuquajturit treg “mbi banak”– OTC. Energjia elektrike është prodhim i homogjenizuar (MWh) i blerë dhe shitur si artikull përmes kontratave. Kontratat mund të jenë fike (për dorëzim), ose kontratat financiare (për shmangie), megjithatë të gjitha kontratat ndajnë 4 karakteristika: periudhë e definuar, sasi e definuar e energjisë elektrike, lokacion i definuar dhe çmim.
- **Tregu i Parashikuar** është tregu ku dërgesa bëhet në një kohë të caktuar në të ardhmen. Furnizuesit për shembull, blejnë më herët duke përdorur kontratat afatgjata të lidhura më herët, për të mbuluar konsumin e tyre, dhe pengojnë paqëndrueshmërinë e çmimeve.
- **Tregu i së ardhmes** është një lloj i tregut të parashikuar që ndodh në një SHE (shkëmbim të energjisë). Mbështetet në kushtet e kontratës së standardizuar – e vetmja pikë që mund të ndryshojë është çmimi – kështu që tregu për këtë kontratë të parashikuar është likuid dhe lehtëson tregtinë. Mjetet e Menaxhimit të Rrezikut përfshijnë kontratat, SWAPS, sigurimin, pengesat dhe mundësitë.

Kontratat e parashikuara dhe tregjet janë të dobishme për blerësit pasi që zgjedhin çmimin më herët, ulin rreziqet e çmimit për të dy palët dhe ofrojnë likuiditet, çka ndihmon në parandalimin e kostos së zgjerimit. Tregjet e ndryshme zhvillojnë përzjerje të ndryshme të kontratës dhe pikave të shitjes, në varësi të oreksit të pjesëmarrësve për rrezik dhe nga natyra themelore e prodhimit.

Ka pasur mjaft modele alternative të Hartimit të tregut të energjisë Elektrike dhe vlerësimi përfundimtar i shkallës së tyre të suksesit ende nuk është kryer. Një përshkrim i plotë i të gjitha modeleve ose mënyra më e mirë për t'i kategorizuar ato, është jashtë sferës së këtij raporti, megjithatë janë dy shkolla mendimi për klasifikim; Një është e bazuar në marrëveshjet për skematizim dhe dispeçim që bëjnë dallim mes modelit “të detyrueshëm” të **Rrjetit të Plotë (Gross Pool)** përmes të cilit e tërë energjia tregtohet me çmime shitëse të tregut, dhe mes **Tregtimit Bilateral ose Rrjetit të Grumbullimit (Net Pool)**, ku ka një vetëvendosje dhe pjesa më e madhe e energjisë tregtohet drejtpërdrejtë mes prodhuesve dhe furnizuesve përmes kontratave bilaterale, derisa rrjeti i grumbullimit përdoret për të pastruar energjinë e mbetur ose çfarëdo kërkesë të pakontraktuar. Shkolla e dytë dhe më moderne e mendimit për klasifikimin e modelit të tregut të rrymës, bazohet në nivelin me të cilin aranzhimet operationale dhe komerciale për skematizim dhe dispeçim, disbalanc, kongjestion dhe shërbime ndihmëse integrohen me tregjet në vend dhe bëjnë dallimin mes **modeleve të integruara, modeleve rrotulluese dhe atyre të decentralizuara**.

Nën **modelin e integruar** (PJM, NY, New Zealand, NORDPOOL), Operatori i Sistemit dhe i Tregut (OST), përgatit kontratat e parakohshme me kërkesën e shitësve, por gjithashtu merr oferta nga shitësit për të modifikuar kontratat e skematizuara dhe për të parandaluar disbalancin, menaxhimin e kongjestionit dhe shërbimeve ndihmëse. OST-ja drejton tregun në vend duke përdorur program të gjerë të optimizimit dhe në këtë mënyrë, OST minimizon shpenzimet e përgjithshme të këtyre shërbimeve.

Nën **modelin rrotullues** (pjesa tjetër e SHBA-ve), një ndërmarrje e integruar me prodhimin e vet udhëheq veprimin e sistemit dhe të transmetimit; ofron qasje për transmetim nga kontratat e skematizuara me kërkesë të shitësve, pasi të ketë skematizuar burimet e veta për ngarkesën e vet. Ndërmarrja kujdeset për disbalancet dhe menaxhon kongjestionin dhe shërbimet ndihmëse me çmime të rregulluara. Nuk ka vende formale të tregjeve.

Sipas modelit të decentralizuar, (UK, Kaliforni, Teksas), OS-ja gjithashtu i skematizon kontratat e shitësve, por qëllimi është që OS të jetë jashtë pikave të tregjeve. OS-ja duhet të administroj rregullimin e disbalanceve. Shitësit sa më shumë që është e mundur udhëheqin pikat e tregut dhe menaxhojnë kongjestionin; rregullime të veçanta bëhen për shërbimet ndihmëse.

Nga e gjithë sa u tha më lart, del që parakushti i parë e më i rëndësishëm në zhvillimin e një tregu të energjisë elektrike, është themelimi i menjëhershëm i një tregu të detajuar të shitjes me shumicë, i cili për të qenë i suksesshëm duhet të shoqërohet me qasjen e rregulluar të moderuar të Palës së Tretë, ndarje e plotë ligjore dhe funksionale e transmetimit dhe shpërndarjes dhe themelimi i mekanizmave jodiskriminues, të mekanizmit balancues të rregulluar, dhe në rrugë të duhur për balancimin e tregut.

Tregjet Efikase të Shitjes me Shumicë sjellin përfitime gjithëpërfshirëse për konsumatorët. Tregjet Likuide të shitjes me shumicë përdoren për të zbuluar shpenzimet e vërteta të energjisë në horizontet kontraktuese “të së ardhmes” dhe prandaj do të pengojnë dhe menaxhojnë rrezikun e çmimit. Liberalizimi me efektivitet, ka krijuar një funksion të tregut gjithëpërfshirës ose “shitblerës” në tregjet e energjisë elektrike. Çmimet e tregut të shitjes me shumicë të energjisë elektrike, kanë tendencë të jenë tepër të paqëndrueshëm dhe çmimet kulmore (të pikut), shpesh mund të jenë disa herë më të lartë se sa çmimi mesatar. Tregtuesi do të ofroj çmimin e fiksuar për

periudhat e së ardhmes duke i lejuar prodhuesit dhe shitësit që ti mbyllin margjinat e tyre para furnizimit,

Pjesëmarrësi në tregun me shumicë përmbush funksionet themelore në vazhdim:

- Mbledh një dosje të blerjeve të prodhimit nga një shumëllojshmëri e burimeve (përfshirë importet) për furnizim në një të ardhme; dhe më pas bën
- Ndarjen apo “ripaketimin” e asaj dosjeje në shitje paraprake për shitësit me pakicë dhe ata konsumatorë që mbulojnë kërkesat e veta;
- Për dallim nga shumë industri të tjera, rryma është një mall ku një MWh është identik me MWh-në tjetër, që lejon energjinë elektrike me shumicë të tregtohet si një produkt standard në tregjet likuide parapake dhe ato momentale. Derisa konkurrenca shtohet, një gamë e produkteve standarde të përcaktuar paraprakisht nga periudha kohore dhe gjeografia, janë bërë tregues aktivë. Si u përmend më lart, në tregjet e pjekura evropiane, energjia elektrike blihet dhe shitet hapur, si produktet në vijim: gjysmë-orët individuale; gjashtë blloqe ditore prej tetë periudhave gjysmë-orëshe; ditë individuale; blloqe të ditëve të javës dhe fundjavës; muajt individualë; sezonet; dhe kontratat vjetore për disa vjet në të ardhmen.

Kjo është një ndarje tipike e prodhimeve në tregun e liberalizuar dhe konkurrent të energjisë. Kontratat tregtohen bilateralisht, përmes ndërmjetësve dhe në tregjet elektronike dhe në çmimoret e energjisë, me rezultatin që çmimet për blerjen dhe shitjen e këtyre produkteve të mund të shihen nga pjesëmarrësit në treg. Kjo i lejon të gjithë pjesëmarrësit – përfshirë tregtarët – që të marrin vendime, të informuar rreth asaj se kur dhe si të përmbushin kërkesat. Lojtarët e integruar vertikalisht, prodhuesit e pavarur, shitësit e pavarur dhe shitësit me shumicë garojnë për të blerë dhe shitur në këto tregje. Derisa konkurrenca rritet mes këtyre lojtarëve, këto tregje të përparuara bëhen tejet të rrjedhshme, dhe pjesëmarrësit në treg mund të blejnë ose shesin sasi të mëdha, pa ndonjë ndikim material në çmimin e tregut. Në anën tjetër, hapësira mes çmimeve të blerjes dhe shitjes (d.m.th. “premia” që paguhet nga pjesëmarrësit në treg për menaxhim të rreziqeve të tyre në tregun me shumicë) ngushtohet. Kjo rezulton më kursime të mëdha në efikasitetet përgjatë zinxhirit të vlerës për prodhimin dhe shitjen e energjinë elektrike. Këto kursime në efikasitet mund të ndahen gjërisht si vijon:

- **Veprimi efikas dhe mirëmbajtja.** Prodhimi burimin në koston më të ulët. Gjatë periudhave afat-gjata, çmimet e tregut të ndjekur, japin sinjale për kohën më të leverdisshme për t’i nxjerrë nga puna gjeneratorët dhe t’i mirëmbajnë. Në të njëjtën mënyrë, konsumatorët e mëdhenj me tarifa të lidhura me çmimet e shitjes me shumicë, mund të zgjedhin që të mos konsumojnë në kohë të caktuara të ditës ose vitit në mënyrë që të mënjanojnë çmimet relativisht të larta. Rezultat i përgjithshëm është një model i efektshëm ekonomik i prodhimit dhe konsumit.
- **Menaxhimi i efektshëm i rrezikut.** Tregjet e Avancuara u lejojnë pjesëmarrësve të tregut që të blejnë dhe shesin energji elektrike gjatë shumë periudhave të ndryshme, dhe të rregullojnë aksionet e tyre ashtu siç ndryshojnë kërkesat e tyre. Shitblerësit lehtësojnë procesin e tyre duke shtuar likuiditet dhe duke ulur shpenzimet e shitjes dhe blerjes së energjisë (në të vërtetë tregtarët mund të përfitojnë vetëm nëse mund të menaxhojnë këto rreziqe më lirë se pjesëmarrësit fizikë të tregut). Tregjet likuide përcjellëse, u lejojnë pjesëmarrësve të tregut që të ulin vlerën e tyre dhe rrezikun e çmimit, i cili në mënyrë të duhur bën rrjedhje të qëndrueshme parash (cash flows) dhe rezulton në shpenzime financiare të ulura.

- **Konkurrencë efektive në prodhim dhe shitje me pakicë.** Prezenca e tregut likuid me shumicë, zvogëlon dukshëm pengesat për hyrjen e prodhimeve të pavarura dhe shitësve me pakicë. Edhe prodhuesit e vegjël dhe ata të shitjes me pakicë, do të kenë qasje në tregjet efikase për shërbimet e menaxhimit të rrezikut, pa nevojën për të ndërtuar pasuri të qëndrueshme aksionare ose dhe konsumatorët mund t'i menaxhojnë këto rreziqe në mënyrë të brendshme. Kjo do të promovoj konkurrencën e shitjes me pakicë dhe prodhimit dhe do të ju ofroj më shumë përfitime konsumatorëve.
- **Investimi efikas dhe siguria e përmirësuar e furnizimit.** Tregjet likuide të shitjes me shumicë ofrojnë shenja disa vjet më herët në lidhje me nivelin dhe modelin e çmimeve. Kjo ofron shenja efikase se kur të investohet në prodhimet e reja për të përmbushur kërkesën. Investimet e reja do të ndodhin atëherë, kur çmimet e përcjella ngrihen për të llogaritur ngushticën e rritur mes kërkesës dhe kapacitetit në dispozicion. Kjo siguron që është ndërtuar kapaciteti adekuat i prodhimit. Për më shumë, në afate më të shkurta kohore, mundësia që çmimet e tregut të ngrihen për të reflektuar mungesat, mund të japë shenja efikase për të sjellë prodhues shtesë, mirëmbajtje të përsheptuar, shtyrje të shpenzimit, etj. Transparenca e sinjaleve të çmimit të tregut ofron nxitje direkte financiare për të pranuar sigurinë e furnizimit.
- **Përdorimi efikas dhe zgjerimi i infrastrukturës së transmetimit.** Tregjet transparente, likuide rajonale të shitjes me shumicë, ofrojnë sinjale efektive të çmimeve të energjisë elektrike në tregjet rajonale. Si pasojë, këto sinjale sigurojnë vlerë të ndërlidhjeve mes tregjeve rajonale të shitjes me shumicë. Atëherë kur pjesëmarrësit e tregut mund të kenë qasje lirisht në kapacitetin ndërlidhës, energjia transferohet në mënyrë efikase në mes të rajoneve, dhe kongestionin në këto ndërlidhje menaxhohet në mënyrën më të suksesshme. Sipas rregullit, kjo jep sinjale afatgjata efikase për vlerën e zgjerimit të kapaciteteve të transmetimit, që mundëson fluks më të madh mes rajoneve. Kjo mundëson ndihmesë të paçmueshme ndaj kompanive të transmetimit dhe rregullatorëve, për të orientuar zgjerimin e kapaciteteve transmetuese, të cilat sipas rregullave e përforcojnë sigurinë e furnizimit.

Tregjet konkurruese të shitjes me shumicë sjellin kursime të efektive për konsumatorët. Zhvillimi i tregut likuid transparent, është vendimtar për realizimin e këtyre përfitimeve. Tregjet efikase kërkojnë Transparençë më të madhe të informatave për të gjithë pjesëmarrësit e tregut. Megjithatë, transparenca e plotë e informatave në nivelin e shitjes me shumicë për të gjithë pjesëmarrësit e tregut, edhe ata “ex ante” edhe “ex post”, në lidhje me kapacitetin e transmetimit në dispozicion/ shfrytëzim, nevojiten niveli i kërkesës dhe mundësia e prodhimit/fuqisë.

Një tjetër pre-rekuizitë për zhvillimin e Tregut të shitjes me shumicë në baza rajonale është bashkëpunimi Ndërkufitar në mes të qeverive, rregullatorëve dhe OST-të; Standardet ligjore divergjente, posaqërisht në qasjen e transmetimit dhe të prodhimit të energjisë elektrike, mund të shkaktojnë shtrembërime në konkurrencë. Një shkallë e caktuar e harmonizimit kërkohet për të siguruar fushën e kërkuar të nivel-pjesëmarrjes në tregun rajonal të energjisë elektrike, posaqërisht në rregullat për transmisionin ndërkufitar dhe alokimin e kapacitetit të transmetimit në kufijë si dhe në masat që qeverisin hapjen e tregut, qasjen e palës së tretë dhe ndarjen. Këto masa do të përfshijnë:

- Jo restriksion në import/ eksport;
- Nuk ka transaksione të ndërlidhura me tarifat e transmetimit ndërkufitar; kjo implikon vendosjen e mekanizmit uniform të Tregut Ndërkufitar (CBT) për rimbullim nga OST-të rajonale të shpenzimeve të shkaktuara për shkak të rrjedhjeve të tranzitit. Që nga 1 korriku 2004 një skemë e kompensimit e propozuar nga SETSO TF janë vendosur së

bashku me linjat e hartimit conceptual njejt si të mekanizmit ETSO CBT të Evropës Përendimore. Është shumë me rëndësi që të theksohet që **Kosova dhe asetet e saj të transmetimit nuk janë përfshirë në këtë skemë** dhe as në atë të propozuar për vitin 2005. Në vend të kësaj asetet e transmetimit të operuara nga KEK-u, janë vendosur në rrjetin horizontal të EPS-it, ndërmarrje e energjisë të Serbisë. Kosova nuk merr ndonjë kompenzim për tranzitin e rrjedhjave përmes rrjetës së saj, në vend të kësaj ato janë të grumbulluara në rrjetën e tranzitit të EPS-it. Për më shumë EPS-i nga një anë ka ndërprerë pagesën për kompenzimet e rrjedhjes së tranzitit bazuar në marrveshjen bilaterale në mes të KEK-ut dhe EPS-it, e cila është nënshkruar në vitin 2002 dhe ishte në zbatim. Disa përpjekje në nivelin më të lart politik (KE-ja dhe Qeveria e Serbisë) janë kryer në vitin 2004 dhe në shkurt të vitit 2005 duke mos pasur asnjë rezultat pozitiv deri më tash për shkak të refuzimit nga EPS-i për të pranuar përfaqësuesit e Kosovës në SETSO TF. Në mungesë të bashkëpunimit nga EPS-i, Kosova mund të mos ketë zgjedhje tjetër përveç se të vendos mekanizmat e veta të “pagesave të tranzitit” për rrjedhat që shkaktojnë humbje dhe shpenzime në paisjet e transmetimit të operuara nga KEK-u.

- Njohje e ndërsjellë e licencave të furizimit, të shitjes me pakicë dhe shumicë;
- Shkëmbim i hapur i informatave në mes të OST-ve sa i përket rrjedhave të modeluara, rrjedhave që priten, nominimeve dhe parashikimeve të kongestionit;
- Menaxhim i koordinuar tërësisht i kongestionit ndërkufitar duke përdorur metodat e bazuara në treg. Prap ka filluar SETSO TF për të propozuar një skemë të koordinuar bazuar në principet e tregut dhe prap Kosova është përjashtuar nga diskutimet me insistimin e EPS-it
- Koordinim mes OST-ve për të përfshirë marrveshjet për të menaxhuar kongestionin larg nga kufinjët kudo që është e mundur me, p.sh, ri-dispeqingu i gjeneratorëve, kundër-tregtimit
- Procedura të harmonizuara të caktuara nga OST-të, kohë dhe blloqe të sasisë për tregtim dhe mbyllje të dyerve, balancim dhe marrëveshje Brenda-ditës;
- hartim kompatibil i tregut.

Në lidhje me hartimin e tregut rajonal të ETL-së (SEE), Komisioni gjithashtu beson që themelimi i tregut rajonal të energjisë elektrike është një process evolutiv gradual dhe fillimisht fton të gjitha vendet të procesojnë me reformat esenciale të tregut të enrgjisë elektrike në nivele shtetërore, të gjitha në linjë me formatin e parashtruar nga CEER. Në mars të vitit 2003 CEER propozoj një strategji dhe principe themelore të modelit për zhvillim të një REM, të ashtuquajtur Hartim Standard i Tregut – SMD. Secili vend duhet të zhvilloj legjislacionin e vet të sektorit të energjisë në mënyrë që në fazën e ardhshme tregu rajonal i energjisë elektrike mund të operohet. Objektiva përfundimtare është që të krijohen tregje të energjisë elektrike që funksionojnë mirë, të cilat janë të hapura për shitblerje. Hartimi i tregut kombëtar të energjisë elektrike duhet të jetë i bazuar në supozimet në vazhdim:

- Themelimi i autoritetit të Pavarur Rregullativ;
- Themelimi i një Operuesi të Pavarur të sistemit (OST);
- Definimi i rregullave jo-diskriminuese dhe transparente për TPA-të për rrjete, përfshirë edhe ndërlidhësit;
- Themelimi i tarifave për përdorim të rrjetit;
- Kompetenca të mjaftueshme për OST;

- ndarje ligjore e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes/furnizimit;
- Definimi i konsumatorëve të privilegjuar;
- Krijimi i Tregjeve të Shitjes me Shumicë deri në dhjetor të vitit 2005 dhe të atij rajonal prej dhjetorit të vitit 2007; Themelimi i tregjeve konkurruese për prodhim dhe furnizim të konsumatorëve të privilegjuar dhe furnizuesve për konsumatorët e fundit.

Duke pasur parasysh hartimin e tregut të shitjes me shumicë rekomandohet që secili vend pjesëmarrës duhet të:

- Themeloj model konkurrues kryesisht të bazuar në kontratat bilaterale;
- Blerësit me shumicë (furnizuesit e konsumatorëve të fundit dhe konsumatorëve të mëdhenjë, drejtëpërdrejt të lidhur në rrjetin e shpërndarjes ose atë të transmetimit) mund të zgjedhin furnizuesin e tyre duke sjellur konkurrencë në prodhim dhe furnizim me shumicë;
- Themeloj një mekanizëm të përshtatshëm bilancues i cili është i favorshëm për furnizuesit e rinjë, duke marrur parasysh strukturën e tregut të prodhimit në vendin përkatës
- Themeloj dhe zbatoj rregullat, të cilat lejojnë krijimin e tregut konkurrues jodiskriminues të shitjes me shumicë të favorshëm për investime.

Të gjitha reformat duhet të bëhen në përputhje me standardet e legjislacionit Evropian, posaqërisht KE 2003/54 Direktiva dhe Rregullorja (KE) 1228/2003. Prandaj, rregullatorët e energjisë duhet të jenë të pavarur nga çfardo interesi i industrisë. Detyrë kryesore e rregullatorëve është që të krijojnë dhe implementojnë një system të rregullimit me pikësynim që të sigurojnë funksionim të duhur të sektorit dhe të tregut të energjisë elektrike sa i përket efikasitetit, konkurrencës, transparencës dhe mbrojtjes së konsumatorëve. Rregullatori duhet të nxjerrë metodologjitë për të themeluar tarifatat për sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes të energjisë elektrike dhe të përcaktojnë rregullimet e bilancit. Gjithashtu duhet të mbikqyrë veprimin e sistemit, shërbimet ndihmëse, tregun me shumicë të energjisë elektrike dhe tarifatat e kuptueshme që iu ngarkohen konsumatorëve të energjisë elektrike. Tarifatat duhet të reflektojnë koston dhe të sigurojnë mbulim adekuat të kostos, duke përfshirë krahasim të arsyeshme të profitit me rrezikun e tregut të aktivitetit të rregulluar. Për më shumë, rregullatori duhet të përgatisë një system jodiskriminues, transparent dhe të drejtë për dhënien e licensave.

Njejt edhe OST-ja duhet të jetë e pavarur nga çfardo interesi komercial në tregun e energjisë (prodhuesit, furnizuesit, ose konsumatorët e privilegjuar) së paku nga aspekti i formës ligjore, organizimi dhe vendimarrja. Veprimet e OST-së dhe vendimet në lidhje me zhvillimet e rrjetit vendor dhe të inter-konektorëve me vendet fqinje duhet të ndikohen me kërkesën për të siguruar përkrahje fizike ekonomike efektive të tregut rajonal të energjisë elektrike me shpenzime të justifikueshme ekonomikisht.

Prandaj qasja etapore ashtu siç është propozuar nga Komisioni inkuadron një ndërtim institucional në fazën e parë, duke përfunduar në dhjetor të vitit 2005, gjatë të cilës rregullat legjislative, rregullative, dhe teknike për zhvillimin e secilit treg kombëtar në rajonin e EJT-së do të vendosen. Në fazën e dytë që do të përfundohet deri në dhjetor të vitit 2007, do të përfshihet zhvillimi tërësisht i detalizuar i marrëveshjeve të tregut për shitëblerje dhe pasqyrimet në mes të OST-ve dhe operuesit të tregut rajonal. Faza e tretë, që fillon nga janari i vitit 2008, është veprimi aktual në kohë reale i tregut rajonal të energjisë së EJT-së.

Hartimi i tregut për rajonin është një opcion. Hartimi i tregut mund të jetë ose një sistem unik në rajon ose një seri e tregjeve kompatible kombëtare me shitblerje rajonale. Karakteristikat kryesore të propozimit të shkurtër të CEER janë si në vazhdim:

Hartimi Standard i Tregut

Struktura e Tregtimit: Një bazen i përzier dhe treg i bazuar në kontratë, në dy nivele (rajonale dhe kombëtare) përfshinë:

Kontratat Bilaterale me dërgesë fizike

- Lloj i standarizuar, kryesisht i parregulluar, përveq nëse furnizuesi është i rregulluar;
- Kontrolli “Ex-post” në nivel kombëtar/lokal (por i harmonizuar) përkundër pozitës së jashtëzakonshme dominante;
- Dorzëon ofertat e balancuara për Tregun e Një Dite më Parë (Day Ahead) – Varësisht nga marrëveshjet për balancim;
- Në mënyrë të preferuar përmes rajonit të EJM-së – Transmission Quota Reservation.

Tregu Rajonal i një dite para (Day-Ahead), të operuar nga Operatori Rajonal i Tregut ORT (RMO)

- Bazeni i pjesërisht joobligativ – merret kryesisht me rrjedhjet rajonale të shitblerjes;
- Përkrahja e Likuiditetit me ad hoc masa (detyrimet për blerje të obligueshme të pjesërisht dhe ofertim të detyrueshëm të pjesërisht të resurseve të prodhimit, si hidro).
- Dispeçimi në kohë reale dhe rrjedhjet e menaxhuara nga OST-të vendore dhe bashkëpunimi i tyre me organizatën rajonale (SEETSO).
- Rregullat e thjeshta të kontabilitetit për çmimet e balancit;
- Sqarim në dy-nivele: rajonal dhe vendor;
- Kontrata e OST-së për energjinë rezervë dhe shërbimet ndihmëse.

Tregu rajonal mund të bëhet operativ që nga dhjetori 2007. Transaksionet do të kryhen ose përmes kontratave bilaterale, me dërgesa fizike, ose përmes tregut rajonal të Një Dite më Parë (Day Ahead) të EJM-së të shitjes me shumicë (DAM).

Hartimi i Tregut me shumicë

Është e natyrshme, e pritur dhe e mirëseardhur, që fillimisht tregtia do të përmbushet në baza të kontratave bilaterale në mes të prodhuesve dhe furnizuesve (ose shfrytësuesve të fundit) dhe në mes të furnizuesve dhe furnizuesve të tjerë dhe/ose shfrytësuesve të fundit në rajonin e EJM-së. Kontratat bilaterale do të jenë gjithmonë një nga shtyllat e liberalizimit të tregut të EJM-së, posaqërisht në fazat e para të zhvillimit të tij. Vetëm është menduar, përmes ekzistimit të kornizës së përkrahur që kontratat bilaterale në mes të pjesëmarrësve të vendeve të rajonit (dhe gjithashtu në mes të vendeve të rajonit dhe palëve nga jashtë) do të udhëhiqen dhe implementohen në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese, pa e shtrembëruar konkurrencën ose ushtrimin e kompetencës së tregut nga zyrtarët e rajonit. Bazuar në kontratat e standardizuara të tregut, duhet të themelohet një shkëmbim kontraktues funksional, duke vepruar gjithashtu si mekanizëm qartësues. Kjo mund

të krijoj likuiditet në tregjet e energjisë, gazit dhe karbonit dhe gjithashtu ofron çmime rajonale etapore. Donatorët (EBRD) mund të ndihmojnë në sigurimin e rrezeve pa-market qëndërlidhen me tregun nga mekanizmat e pagesës.

Njohja e ndërjellsë e licencave mund të aplikohet në këtë fazë. Nëse transportuesi është i licencuar në një vend, licenca e tij mundet gjithashtu të njihet në vendet tjera pjesëmarrëse në baza kombëtare. Bordi Rregullativ mund të themeloj kriteret minimale për dhënie të licencës siç është qëndrueshmëria e kreditimit.

Tregjet e një dite Para (Day-Ahead - DAM) në nivel kombëtar dhe rajonal. Përveç kontratave bilaterale me furnizuesit fizikë, poaq e rëndësishme për projektin e tregjeve është vendosja e një tregu të një dite më parë (Day-Ahead) rajonal që do të jetë i ndërlidhur ngushtë me balancimin në kohë reale. DAM është treg jo i detyrueshëm i energjisë elektrike ku asnjë (me përjashtim të furnizuesve të RFT-së të obliguar të blejnë 10 % të furnizimit të tyre përmes këtij tregu për arsye të likuiditetit) nuk është i obliguar që të blejë ose shes përmes tij. DAM kryen likuidimin e nxitur nga çmimi të ofertave të shitjes së energjisë elektrike të bëra nga Prodhuesit dhe importuesit në kombinim me ofertat për blerje të dhëna nga Furnizuesit, eksportuesit dhe përdoruesit finalë. Tregu barazon çdo orë, një ditë para ditës së kohës reale. DAM-i rajonal drejtohet nga SEEMO. Bashkë me kontratat bilaterale, DAM trajton dorëzimin fizik të energjisë elektrike, dhe do të operojë në baza rajonale me opsionin e ndarjes së tregut. Importet dhe eksportet po ashtu do të trajtohen nga DAM. Të gjitha transaksionet e shkëmbimit të fuqisë të energjisë (furnizimi dhe kërkesa) do të planifikohen përmes DAM-it rajonal. Kjo do të bëhet në mënyrë që të lejohet veprimi efikas i rrjetave të energjisë elektrike në nivelin rajonal, për ditën e ardhshme (plani preliminar i termocentraleve, forma e parashikuar e veprimit të ndërlidhësve, etj.). Kjo po ashtu do të sigurojë për OST-të (përmes bashkëveprimit të tyre me SEEMO-në) një indikacion të saktë për atë se cilat do të jenë nevojat e balancimit në nivelin kombëtar/lokal (dhe rajonal) ditën e nesërme. Së fundi, ai do të sigurojë pjesëmarrësit e tregut me informata transparente rreth tregut real për ditën e nesërme dhe do të përgatis ata si duhet. Çështjet e besueshmërisë së informatave komercialisht të ndjeshme, do të trajtohen brenda kodeve operative të SEEMO-së dhe OST-së.

Tarifat e Rregulluara të shfrytëzuesve të fundit gjatë Fazës së Tranzicionit

Konsiderohet që një tranzicion gradual në një treg konkurrent është i domosdoshëm dhe se kjo duhet të fitohet duke e ndarë tregun e energjisë elektrike në dy komponentë. Secili vend duhet të caktoj:

- Një tarifë të shitjes me pakicë (Furnizimi Publik), që rregullohet dhe bazohet në transparencën dhe shkarkimin e kostos dhe tarifës. Është e qartë që ky segment i tregut duhet të definohet mirë dhe të përfshijë shtëpitë dhe bizneset e vogla. Rregullatorët mund të ftohen që të definojnë pragun e pranueshmërisë;
- Një treg të shitjes me shumicë, që është treg konkurrent për kontrata bilaterale me sasi dhe çmime të negociuara për konsumatorët e pranueshëm.

Një Regjim i Rregulluar i Tarifave Fikse (RTF) që do të lejojë një tranzicion të butë dhe do të mbrojë kategoritë e konsumatorëve nga goditja me çmime

Nën RTF:

- a) Çmimet e energjisë të lidhura (me transmision, distribucion dhe kosto të tjera) në RTF janë të rregulluara në një nivel kombëtar dhe përfshijnë për shkak të proporcionit të kostos të ndodhur nga TSO-ja kombëtare për energji, balancim dhe shërbime ndihmëse;

- b) Furnizuesit e Rregulluar (FR) licencohen nga Autoriteti Rregullator relevant. Ata i nënshtrohen rregullimit që vendos një detyrim të posaçëm për kapacitet për furnizimin e konsumatorëve të tyre. Kushtet dhe dispozitat e sakta të veprimit të tyre do të nënshtrohen rrethanave kombëtare (p.sh. kontratave standarde bilaterale përmes tenderimit publik, çmimeve të rregulluara për konsumatorët, etj.). Ata do të detyrohen të ndjekin procedura transparente dhe jodiskriminuese për mbylljen e kontratave bilaterale (p.sh. përmes proceseve të tenderimit publik);
- c) Rregullimi mbi kontratat bilaterale, gjithashtu do të sigurojë qëndrueshmërinë financiare edhe të Prodhuesve edhe të Furnizuesve të Rregulluar.

Pas dhjetorit 2007, çfarëdo zgjerimi i mëtejshëm i definimit të konsumatorit të përshtatshëm – për të lejuar më shumë pjesëmarrës në tregun me shumicë – do të duhet të adresohet në përputhje me kërkesat e Udhëzimit 2003/54 dhe Marrëveshjes KEEJL.

Balancimi i Tregut & Shërbimeve Ndhmëse

TSO-të janë përgjegjëse për veprim në kohë reale të tregut. Në fazën fillestare të zhvillimit të tregut, zbatimi i një mekanizmi të bazuar në treg për balancimin dhe rezerva nuk është zgjidhje e përshtatshme. Një mekanizëm për balancim në kohë reale dhe sistem i shërbimeve ndihmëse do të zbatohet në nivel kombëtar. Çmimet administrative do të ekzistojnë për të zgjidhur devijimet dhe për të paguar shërbimet ndihmëse, bazuar në koston reale të hasur dhe në metodologjitë “ex-ante”.

Qendra Tregtare Rajonale

Aplikimi i mekanizmit të CBT-së dhe menaxhimi i koordinuar i ngjeshjes janë parakushte por jo edhe adekuate për zhvillimin e tregtimit efikas rajonal. Një treg qendror do ta ndihmonte më së shumti këtë tregti. Për këtë arsye tregtia efikase rajonale që kërkon rritje konkurrense të mekanizmave të tregtimit dhe infrastrukturës është ndihmuar në vendet e avancuara (sikur që është përmendur më lartë) duke zhvilluar pikat për tregtim, shkëmbim dhe grumbullim të energjisë që më tej janë përkrahur nga institucionet kredituese, sikur që janë zyrtar qendrore dhe bankat kreditore.

Vendosja, brenda vitit 2005, e Qendrës Tregtare të EJT-së, është propozuar, bazuar në infrastrukturë, njohuri bazë dhe përvojë në tregjet më të avancuara të rajonit (Slloveni, Rumania – përkatësisht, “Borzen” dhe Opcom”) me pjesëmarrje të çdo operatori të tregut kombëtar që tashmë është duke operuar në vendet e regjionit të EJT-së. Roli i kësaj Qendre Tregtare do të jetë të veprojë ngjashëm me Shkëmbimin e Energjisë për transaksionet e shkëmbimit të Energjisë elektrike mes lojtarëve të tregjeve rajonale. Pjesëmarrësit e këtij tregu mund të jenë të gjithë gjeneratorët rajonalë të energjisë, të gjithë tregtarët ose ndërmjetësit e regjistruar nga secili vend i rajonit dhe gjithashtu, të gjithë konsumatorët e përshtatshëm nga çdo vend i rajonit. Tregtimi përmes kësaj Qendre Tregtare duhet të bëhet vullnetarisht. Në fazat fillestare të zhvillimit, Qendra Tregtare mund të ofrojë produkte të thjeshta, siç janë kontratat bilaterale OTC, ku dy entitete pajtohen të tregtojnë një sasi të madhe të Energjisë elektrike në sesione kohore që mund të ndryshojnë. Ajo po ashtu mund të zhvillojë një standard të kontratave (produkteve) të tregtueshme për shkëmbimet multi-rajonale, të tregtuara për të ardhmen.

Qendra Tregtare do të përkrahet nga Zyra Qendrore për pjesëmarrësit, që gjithashtu kryen llogaritjen dhe zgjidhjen e transaksioneve të kryera në tregun e organizuar. Ajo do të veprojë si kundër-palë qendrore në secilin transaksion të kryer, dhe do të sigurojë përmbushjen e detyrimeve financiare ndaj pjesëmarrësve. Për këtë qëllim, ajo do të kërkojë garanci financiare nga

pjesëmarrësit, dhe do të bashkëpunojë ngushtë me institucionet bankare të komunitetit Donator (p.sh. sipas propozimit të EBRD-së)

Përshtatshmëria e Kapacitetit Gjenerues

Një nga çështjet kyçe të veprimit të një tregu të energjisë elektrike, është aftësia e planit të saj që të sigurojë përshtatshmëri të kapacitetit për prodhim afatgjatë dhe transmetim. Për këtë qëllim, Autoritetet Rregullative në EJL duhet të koordinojnë në mënyrë që të analizojnë nevojat dhe mbetjet e rezervave rajonale dhe të bashkëpunojnë me EC-në, qeveritë dhe OST-të rajonale dhe aksionarët e tjerë. Në mënyrë që të sigurohet përshtatshmëria e mundësisë së prodhimit, OST-të dhe SEETSO-do të kryejnë studime periodike të Përshtatshmërisë së Kapaciteteve, që janë aprovuar nga rregullatorët/qeveritë, dhe që shërbejnë për të definuar mbetjen e kapacitetit dhe rezervat e detyrueshme të energjisë, që duhet të kontraktohen nga OST-të.

- Furnizuesit e Rregulluar (nën RTR) do të duhet të mbajnë një dosje të kapaciteteve dhe kontratave të rrymës, në varësi nga mbetja e kapacitetit, baza e konsumatorëve të tyre dhe nga kuota e tyre për detyrimet e blerjes së detyruar, nga Tregu rajonal i Një Dite më Parë (Day-Ahead).
- Furnizuesit që nuk janë të rregulluar, nuk janë të obliguar, por as nuk janë të mbuluar nga ofertat prej rezervave të energjisë të OST-së, përveç nëse ata kontraktajnë një shërbim të tillë.
- Në rast të një parashikimi për mangësi të kapacitetit, TSO-të do të jenë të obliguara që të blejnë (pas një tenderi) një vijë minimale të kontratave për kapacitetet që korrespondojnë me centralet e reja të prodhimit, derisa kostoja do të kthehet pjesërisht përmes faturave balancuese, pjesërisht përmes Tregut rajonal të Një Dite më Parë (Day-Ahead). Masat e tilla duhet të jenë me përdorim të limituar dhe kurrë mos të mbulojnë plotësisht të gjitha rreziqet e ndërlidhura me investimet e reja për prodhim.

Dyktimësia financiare

DAM dhe sistemi i përshtatshmërisë së kapacitetit ndihmojnë zhvillimin e shkëmbimit të energjisë elektrike dhe instrumenteve të dyktimësisë financiare, duke siguruar likuiditet të mjaftueshëm dhe një bazë të poshtme të tregut, p.sh. një çmim të tregut që mund të përdoret si referencë për menaxhimin e rrezikut të ndërlidhur me çmimin. Në anën tjetër, shkëmbimet e energjisë dhe instrumentet e dyktimësisë financiare, ndihmojnë hyrjen e gjeneratorëve dhe furnizuesve të rinj, sikurse edhe një zhvendosje drejt strukturave të tregut që detyrojnë një sjellje me më shumë rrezik, por me efikasitet më të lartë. Kjo është esenciale për zhvillimin e konkurrencës, ofrimin e shërbimeve stabile dhe të sigurta për konsumatorët e fundit dhe për stabilitetin e tregut. Edhe pse mund të ketë një apo më shumë Shkëmbyes të Energjisë që veprojnë për rajonin, ata do të menaxhohen në mënyrë të pavarur, ose përmes një dege të ndarë të SEEMO-së.

Veprimi i SMD-së në formë diagrami mund të shihet në figurat 4.2 dhe 4.3 më poshtë.

Fig 4.1 Struktura e Tregut SMD-së





Fig. 4.2 Struktura e Tregut në një Zonë të Vetme të Çmimit



Bazuar më sipër, Kosova me burimet e saj të pasura me lëndë djegëse bazë (linjit), pritet të përfitojë nga krijimi i një Tregu Rajonal me Shumicë dhe nga harmonizimi i marrëveshjeve dhe rregullave tregtare. Në njërin anë burimet me lëndë djegëse të Kosovës, janë të mjaftueshme për të ushqyer prodhimin, në masë më të madhe se kërkesa vendore. Rezervat e linjitit që do të shfrytëzohen 5 vjetët e ardhshme, janë në gjendje të furnizojnë deri në 2,000 MW të kapacitetit të ri prodhues për 25 vitet e ardhshme, plus kërkesat e Kosovës “B” për pjesën e mbetur të jetës së saj ekonomike, duke e bërë kështu REM-in një treg tërheqës për zhvilluesit e IPP-së, ndërsa në anën tjetër, një DAM “pikë” do të siguronte aftësinë shumë të nevojshme për përcjellje, të ngarkesës për Kosovën, ku Furnizuesit dhe Prodhuesit mund të “përshtatin” pozicionet e tyre një-orëshe, kundrejt centraleve lokale me ngarkesë bazike jofleksibile. Kosova, gjithashtu pritet të përfitojë në një treg të tillë rajonal në bazë të pozitës së saj qendrore gjeografike dhe ndërlidhjeve të mira, veçanërisht në perspektivën e linjës së re prej 400 kV mes Kosovës dhe Shqipërisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi, dhe IRJ të Maqedonisë dhe Shqipërisë.

Plani konceptual i tregut kombëtar të Kosovës, nuk ka filluar ende, por megjithatë në këtë etapë të hershme, ka mendime se do të miratohen edhe tregtimi bilateral, edhe -Tregu Një Dite më Parë- sipas pikave të parimeve të lartshënuara, duke krijuar kështu, një formë të Rrjetit Grumbullues (Net Pool). Disa elemente të planit për Treg janë ende duke u shqyrtuar:

- Çmime administrative uniforme për mosbalancim (devijime) (të vendosura “ex-ante” nga ZRE), në mënyrë që të reflektojnë kostot që duhet të ndahen për ata që shkaktojnë devijime dhe në atë mënyrë do të minimizojë koston e përgjithshme për sistemin.
- Çmime administrative për Shërbime Ndihmëse, bazuar në metodologjitë “ex-ante” të vendosura nga ZRO-të në bazë të kostove, dhe të siguruara nga TSO në mënyrë që të minimizojë kostot e përgjithshme.
- Pagesat e kapacitetit. Ligji për energjinë elektrike në Kosovë, thekson se asnjë Furnizues Publik (PPA), nuk mund të zgjasë më shumë se 5 vjet (periudha maksimale para se të rishqyrtohet nga ZRO-ja). Një garanci e shkurtër, mbulon pak terren për të lehtësuar shqetësimet rreth projeksioneve për rrjedhjet e garantuara të parave në të ardhmen, që bankat investuese zakonisht i kërkojnë për projektet e IPP-së, posaçërisht në rastet e centraleve me ngarkesë të ulët dhe me jetë të dobishme ekonomike prej 25 deri 30 vjet. Nëse një treg i vërtetë likuid zhvillohet në EJT atëherë çmimet likuiduese të tregut do të kenë tendencë të kthehen në kosto marginale që e bëjnë të vështirë kthimin e kostos reale të fiksuar (të kapacitetit) të IPP-ve me ngarkesë të ulët. Në mënyrë që të tërhiqet investimi i domosdoshëm i kapitalit privat, plani për tregun e Kosovës do të mund të përfshinte ndonjë formë të një “mekanizmi të kapacitetit”; ose duke garantuar pagesat nga TSO-ja për prodhuesit e rinj për ta bërë të mundshëm kapacitetin (që ata mund ta mbulojnë deri në një përqindje, të themi 70 % të kostos fikse, e pjesa tjetër pritet të mbulohet nga çmimi i energjisë në REM); ose përmes detyrimeve të kapacitetit që kërkojnë nga të gjitha entet shërbyese të ngarkesës që u shërbejnë konsumatorëve finalë, që të kërkojnë bileta kapaciteti nga Prodhuesit, në mënyrë që të mbulojnë ngarkesën e lartë të pritur të konsumatorëve të tyre, të shumëzuar nga $(1 + X)$; ($- X$ është vendosur administrativisht si tepriçë e kërkuar e rezervës). TSO-ja mund të veprojë si kundër-palë në blerjen paraprake të biletave të tilla, në emër të furnizuesve dhe konsumatorëve të së

ardhmes, në bazë të projeksioneve për mbetjet e rezervave. Në raste të tilla, kostoja e biletave të kapacitetit shoqërohet me tarifa. ZRO-ja preferon një masë të tillë administrative për periudhën e tranzicionit, për shkak të sigurisë së situatës me furnizim në Kosovë, që kërkon urgjentisht nxitjen e kapaciteteve të reja, ndërsa PPA-të afatgjata, tërheqin kapacitetin dhe kërkesën dhe pengojnë konkurrencën dhe likuiditetin.

- Madhësia e tregut, është dukshëm shumë e vogël pasi ka pak mundësi për konkurrencë dhe diferencim të kostove tepruese të prodhimit mbi tërë Lakoren e Kohëzgjatjes së Ngarkesës. Vendet e vogla këshillohen që të ndajnë DAM-në, Balancimin dhe Shërbimet ndihmëse.


Në mënyrë që Kosova të shfrytëzojë maksimumin nga rastet e paraqitura në madhësinë dhe likuiditetin e rritur të një tregu, diferencimit të lëndës djegëse dhe Prodhimit të përzier, pjesës optimale të rezervave dhe bashkëpunimit hidro-termal, në vend që të krijojë një DAM-i kombëtar, Kosova mund të marrë pjesë në një DAM « nën-rajonale » me sistemet fqinje.

Figura 4.4 më poshtë, tregon me diagram rrjedhjet fizike, emërimet dhe të dhënat e matura në një Treg të llojit të Rrjetit Grumbullues, ndoshta si ai që mund të propozohet për Kosovën.

Figura 4.4 Ndërlidhjet Ekzistuese dhe Perspektive në rajon



Fig. 4.5: Modeli i Tregut Konceptual –Rrjet Grumbullues



5. Licencimi

Aktivitetet e energjisë do të kryhen nga ndërmarrjet e energjisë bazuar në licencat e dhëna nga ZRrE-ja duke u bazuar në kritere që janë jo-diskriminuese, publike dhe transparente.

Licenca është autorizimi i dhënë nga ZRrE-ja që kërkohet për t'i mundësuar ndërmarrjeve të energjisë të kryejnë aktivitetet në sektorin e energjisë.

Licenca kërkohet për aktivitetet e energjisë ashtu siç është përcaktuar në Nenin 28.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Licenca kërkohet për aktivitetet e ndryshme të energjisë siç është prodhimi, transmetimi, distribucioni, furnizimi, shitja dhe transmetimi ndërkufitar (importi, eksporti, tranziti) i energjisë elektrike dhe gazit natyror dhe cilitdo operatori në rrjetin e transmetimit ose shpërndarjes, sipas kushteve të vendosura në Nenin 30 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Kërkesa për tu licensuar është përcaktuar me qëllim që të sigurohet funksionim efektiv i tregut të energjisë, të mbrohen konsumatorët në aspektin e parrezikshmërisë, sigurisë, dhe kualitetit të

shërbimeve të sistemit të energjisë elektrike, ngrohjes dhe gazit natyror dhe që të sigurohet mbrojtja e mjedisit dhe efikasiteti i energjisë.

Në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Bordi i ZRrE-së do të nxjerrë Rregullin për Liçensim i cili do të përshkruajë procedurën për lëshim, modifikim, ose ndërprerje të liçensave, si dhe të drejtat dhe detyrimet që duhet të përfshihen në licenca.

Që nga fundi i shkurtit 2005, ZRrE-ja ka finalizuar Rregullën e saj për Liçensim ku procedura për parashtrim të kërkesës, kushtet dhe detyrimet e të licensuarve si dhe të gjitha format përkatëse të kërkesave dhe deklaramit janë të përfshira. Rregulla i definon elementet themelor të detyrimeve dhe të drejtave të poseduesve të liçensave dhe ofron udhëzime për ndërmarrjet e tanishme dhe ato të ardhshme që aplikojnë për Liçencë. Gjithashtu vendos kërkesat e përgjithshme dhe ato specifike që do të ofrohen nga kategoritë e ndryshme të parashtruesve të kërkesave për Liçencë.

Korniza e përgjithshme për aplikim në ZRrE për leje për ndërtim të kapaciteteve të reja të prodhimit është e vendosur në Rregull dhe do t'i nënshtrohet Udhëzimit të veçantë, i cili do të ofroj udhëzime të detajuara për aplikuesin, bazuar në kriteret e vendosura në përputhje me Programin për Zbatimin e Strategjisë, të përgatitur dhe të miratuar nga MEM-ja.

Të gjitha ndërmarrjet e energjisë që operojnë në kohën e miratimit të Rregullës për Liçensim duhet të aplikojnë për licencë brenda katër muajve që nga data kur do të publikohet në website-in e ZRrE-së dhe të miratohet Rregulli. Kjo përfshin KEK-un, kompanitë e NQ-së dhe ndërmarrjet e tjera të energjisë.

6. Ngrohja Qendrore

6.1 Statusi Aktual dhe Kërkesat për Zhvillim

Aspektet e Tregut

Sektori i NQ-së në Kosovë është pak i zhvilluar dhe dukshëm i vogël, me shtrirje të pjesëshme në nivel vendor dhe i përbërë nga vetëm tre sisteme të NQ-së që mbulojnë qytetet e Prishtinës, Gjakovës dhe Mitrovicës.

Si pasojë e kësaj tregu që mbulon NQ-ja krahasuar me kërkesën e vlerësuar për shfrytëzim të ngrohjes është shumë e vogël, furnizon vetëm 5% të totalit të kërkesës për ngrohje.

Megjithatë roli i NQ-së në Kosovë konsiderohet mjaft i rëndësishëm, së pari si zëvendësim i shfrytëzimit të energjisë elektrike për ngrohje të sipërfaqeve dhe për ujë të ngrohtë sanitar, atëherë kur mund të hyjë në përdorim.

Arsyeja për shfrytëzim të vogël të NQ-së, është se Kompanitë e NQ-së nuk operojnë gjatë gjithë vitit për shkak të shfrytëzimit të NQ-së ekskluzivisht për ngrohje të sipërfaqes, (nuk furnizojnë me ujë të ngrohtë). Gjithashtu gjatë sezonit të ngrohjes, kompanitë e NQ-së veprojnë me ndërprerje gjatë natës.

Bazuar në analizat e dala nga ESTAP i BB-së, është vlerësuar që përafërsisht në vetëm 13% të rasteve, NQ-ja shfrytëzohet si burim i vetëm i ngrohjes, e renditur si e treta pas ngrohjes me dru (51%) dhe energji elektrike (32%).

Duke marrë parasysh teknologjitë në dispozicion dhe efikasitetin e tyre, si dhe çmimet e karburanteve për konsumatorët e fundit në vitin 2002, kostoja vjetore e sistemeve të NQ-së është vlerësuar në 186/a € (ESTAP I). Më pak e shtrenjtë ka qenë ngrohja me stufë të thëngjillit (98/a

€) dhe stufat me dru (160/a €), dhe më e shtrenjtë ka qenë ngrohja me energji elektrike (mesatarja e ngrohjes me akumulues dhe direkte) në 250/a €, ngrohësit me naftë (392/a€) dhe ngrohëset me gaz propan (510/a €). Kur Kosova të ketë qasje në gazin natyror, sistemet e NQ-së do të jenë të krahasueshme me sistemet e ngrohjes me gaz natyror (183/a €).

Aspektet Financiare

Në përgjithësi që të tri kompanitë e NQ-së ballafaqohen me vështirësi financiare që rezultojnë me jo-likuiditetit, dhe kryesisht për shkak të:

- Shkallës së ulët të inkasimit – një shkallë mesatare e inkasimit për sektorin e NQ-së në Kosovë për periudhën prej vitit 2000 deri më sot, që është vlerësuar të jetë në nivelin 35 – 45 %. Arsytet për këtë nuk mund të shpjegohen në mënyrë të njëtrajtshme, por është evident ndikimi i një sërë faktorëve të ndryshëm. Disa prej tyre janë të lidhur drejtpërdrejt me ndërmarrjet e NQ-së, siç është prodhimi dhe furnizimi, shërbimi për konsumatorë, efikasiteti i faturimit dhe inkasimit, ndërsa faktori tjetër është i lidhur drejtpërdrejt me gjendjen e përgjithshme ekonomike dhe financiare të popullatës, siç është mundësia dhe dëshira për të paguar, mungesa e administrimit banesor, masat e pamjaftueshme ligjore për trajtimin e konsumatorëve që nuk paguajnë.
- Niveli i lartë i kostos së kompanive të NQ-ve – është një ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në stabilitetin financiar dhe çmimin përfundimtar të ngrohjes. Për sektorin e ngrohjes qendrore të Kosovës si tërësi, mund të konkludohet që shpenzimet operationale janë të larta, posaçërisht në pjesën e ndryshueshme (mesatarja rreth 65 %) me përbërës kryesor karburantet (mesatarja 55% deri 60%). Një arsye tjetër për mos-efikasitetin, është edhe humbja teknike (në shkallën prej 30 – 35 %), që pavarësisht prej përmirësimit, mbetet ende mbi mesataren e vendeve me sisteme të avancuara të NQ-së (10 deri 15%).
- Statusi Ligjor dhe menaxherial i kompanive të NQ-së – Statusi ligjor si Ndërmarrje Publike, duket të jetë mbulesë e paarsyeshme për menaxhimin dhe funksionimin jo-komercial të kompanive të NQ-së.

Aspektet teknike

Karakteristikë e përgjithshme e tre sistemeve të NQ-së në Kosovë, është që ato përbëhen nga ngrohoret e pasura me kaldaja ku bëhet prodhimi i ngrohjes dhe rrjetet e shpërndarjet përmes të cilave kryhet furnizimi me ngrohje.

- Prodhimi i Ngrohjes bëhet në ngrohoret të pasura me kaldaja që përdorin mazutin në sasi më të madhe, dhe naftën dizel në një sasi më të vogël. Mesatarja e efikasitetit të kaldajave është vlerësuar të jetë në shkallë prej 70 – 75 %, e cila nuk mund të konsiderohet si tërësisht e saktë, pasi në shumicën e rasteve, prodhimi i ngrohjes nuk matet si duhet ose nuk matet fare në daljen nga kaldajat. Arsytet për efikasitet të ulët janë disa: jetëgjatësia e kaldajave; veprimi dhe mirëmbajtja jo e duhur që kanë shkaktuar dëmtime të cilat nuk kanë mundur të eliminohen edhe pas rehabilitimit të kaldajave; cilësia e dobët e karburantve që shumë shpesh nuk e jep vlerën e ngrohjes ashtu siç deklarohet;
- Rrjetet e Shpërndarjes mbulojnë zonat e qyteteve me popullatën më të dendur, dhe përbëhen nga rrjetet primare dhe sekondare, si dhe nënstacionet përmes të cilave ngrohja dërgohet tek konsumatorët. Rrjetet e NQ-së po transformohen nga sistemet me rrjedhje konstante, në sisteme me rrjedhje të ndryshueshme, pasi në shumicën e nënstacioneve janë instaluar matësit e ngrohjes dhe valvulat për kontrollimin e

rrjedhjes. Llogaritet që humbjet e shpërndarjes të jenë në nivel 20 – 25 %; nuk mund të jepet ende një shifër e saktë për humbjet e shpërndarjes, pasi sistemi i matësve të ngrohjes në nivelin e nënstacioneve, nuk është ende tërësisht funksional. Humbjet e mëdha janë rezultat i kushteve të këqija teknike të tubacioneve (rrjedhjeve, dhe mungesës së izolimit, gypave të dëmtuar të betonit), që pjesërisht janë zëvendësuar me gypa të para-izoluar. Instalimet ngrohëse të konsumatorëve në ndërtesa, janë të kualitetit të pranueshëm – gati të gjitha sistemet janë sisteme me 2 degëzime, me radiatorë të mirë dhe me valvula të zakonshme, që përbëjnë një bazë të mirë për paraqitjen e sistemit të faturimit bazuar në konsumin real dhe instalim të valvulave termostatike.

Rregullimi i sektorit të NQ-së

Në përputhje me legjislacionin e Kosovës për energji rregullimi i sektorit të energjisë duke përfshirë sektorin e NQ-së është bërë në nivel vendor nga autoriteti rregullativ për energji. Pasi që NQ-ja konsiderohet si monopol natyror ajo edhe i nënshtrohet rregullimit. Aktivitetet kryesore të rregullimit janë rregullimi ekonomik dhe rregullimi operacional.

Rregullimi ekonomik bëhet përmes vendosjes dhe aprovimit të tarifave të ngrohjes, të cilat shqyrtohen në baza vjetore. Kompanitë e NQ-së dorëzojnë në ZRRë kërkesat për aprovim të tarifave dhe çmimeve çdo vjet. Shqyrtimi/përcaktimi i tarifave bazohet në Normën e Rregulluar të Kthimit ose të ashtuquajturën metodologjia tarifore “kosto plus”.

Rregullimi operacional bëhet përmes liçensimit dhe monitorimit që do të fillojë të zbatohet sapo të jetë vendosur korniza rregullative. Liçensa për kryerjen e aktiviteteve të energjisë do të përmbajë kriteret specifike dhe kërkesat e ndërlidhura me sigurinë dhe kualitetin e furnizimit, mbrojtjen e mjedisit, dhe me kapacitetin e ndërmarrjeve të energjisë për veprim të efektshëm teknik dhe financiar.

Çfarë nevojitet për përmirësim – Bazuar në krahasimet ndërkombëtare

Krahasimi ndërkombëtar (krahasimi “benchmark” me vendet skandinave, Poloninë dhe Lituaninë), jep udhëzimet kryesore për masat që duhet të ndërmerren për përmirësim të dukshme në sektorin e NQ-së në Kosovë.

- NQ-ja në vendet e krahasuara është e zhvilluar mjaft mirë dhe e shpërndarë në gjithë vendin; përveç për ngrohjen e hapësirës, NQ-ja furnizon edhe me ujë të nxehtë sanitar, dhe në disa raste është e pranishme edhe ftohja qendrore. Si pasojë, pjesëmarrja e ngrohjes qendrore në tregun e ngrohjes, është dukshëm më e lartë, në një shkallë prej 25 deri në 50 %.

Zhvillimi i mëtejshëm i sektorit të NQ-së në Kosovë dhe rritja e shkallës së pjesëmarrjes në tregun e ngrohjes, janë të lidhura ngushtë me rritjen e nivelit të qëndrueshmërisë dhe cilësisë së furnizimit me ngrohje, si dhe me përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorëve. Kompanitë e NQ-së në Kosovë, duhet t’i përmbushin kushtet e përmendura më lart (përfshirë këtu një efikasitet më të lartë dhe kosto të zvogëluar), me qëllim që të promovojnë NQ-në si burimin më të përshtatshëm për ngrohje të hapësirës.

Për më tepër, kompanitë dhe palët tjera të përfshira, duhet të përpiqen për zgjerimin e tregut - rritjen e numrit të konsumatorëve (të bëhen kyçjet e reja aty ku është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur), duke e zgjeruar rrjetin dhe kapacitetet e prodhimit nëse nevojitet; të vlerësojnë mundësitë (financiare dhe teknike) për zhvillimin e NQ-së në qytetet e tjera dhe/ose distriktet e Kosovës me dendësi më të madhe të popullatës.

Ndarja e llogarive kontabël për aktivitet e NQ-së, me fokus në shërbimet e furnizimit me ngrohje dhe të mirëmbajtjes, si dhe sigurimi i qasjes së palës së tretë, është me rëndësi thelbësore për paraqitjen e konkurrencës.

- Qasja e miratuar në mënyrë të përgjithshme në vendet që janë krahasuar, është se kompanitë e NQ-së, duhet të operojnë në baza tregtare “për përfitim” në një treg të rregulluar me elemente të tregut të lirë dhe konkurrues, ose në tregje të hapura dhe konkurrencte. Duke marrë parasysh këtë, përmirësimi i aktivitetit të përgjithshëm të kompanive të NQ-ve, është një sfidë e vazhdueshme.

Duke pasur parasysh vështirësitë financiare me të cilat po ballafaqohet aktualisht sektori i NQ-së në Kosovë, rekomandohet si vijon:

Me qëllim që të ngrihet shkalla aktuale e inkasimit, kompanitë duhet të implementojnë sa më shpejt që është e mundur, matjen e ngrohjes tek pikat e furnizimit në nënstacione, gjë që do bëjë të mundur kalimin nga tarifa nominale (për metër katror), në tarifën e bazuar në konsumin e vërtetë të ngrohjes. Kjo do t’u japë konsumatorëve nxitje për zvogëlim dhe kontroll të konsumit. Kjo duhet të pasohet me zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi të avancuar të faturimit dhe inkasimit, të integruar me Sistemin Informativ të Menaxhimit (SIM), për t’i përcjellë pagesat dhe vërejtjet për mospagesë. Këto çështje organizative, duhet të zgjidhen nga kompanitë me qëllim që të përmirësohet raportimi i brendshëm dhe i jashtëm: Duhet të krijohet një sistem gjithëpërfshirës i rregullt raportues (I fokusuar në kosto dhe të hyra), të dhënat e konsumatorëve duhet të rifreskohen, d.m.th. lista e plotë e nënstacioneve me listën e plotë të konsumatorëve të kyçur në nënstacionet individuale (sipërfaqja e përgjithshme e ngrohur / metër katror dhe kapaciteti i hartuar).

Nga kompanitë e NQ-së kërkohet të përmirësojnë efikasitetin dhe të ulin koston duke i ulur humbjet. Të ndërmarrin masa afatshkurtra për uljen e koston duke pasur çmime më të ulëta të blerjes së karburanteve, dhe duhet të merret parasysh në plan afatgjatë, mundësia e përdorimit të llojeve të tjera të burimeve parësore të energjisë duke kërkuar karburante më të lira (gaz natyror, thëngjill, burime të ripërtëritshme të energjisë), si dhe të shqyrtohet bashkë-prodhimi.

- Përmirësimi i përgjithshëm i veprimit të pajisjeve të sistemeve të ngrohjes qendrore, duke përfshirë edhe impiantet e prodhimit të ngrohjes dhe rrjetet e shpërndarjes, do të rrisë cilësinë dhe qendrueshmërinë e furnizimit të ngrohjes, si dhe do të kontribuojë në uljen e koston.

Nga kompanitë e NQ-së, kërkohet që të përmirësojnë efikasitetin dhe ulin koston, duke marrë masat në vazhdim: Reduktimin e humbjeve të prodhimit (kaldajës) dhe reduktimin e humbjeve të shpërndarjes; kjo do të arrihet duke investuar edhe më tutje në rehabilitimin e ngrohtoreve dhe rrjeteve.

Duhet të vendoset menjëherë një sistem matës gjithëpërfshirës nga kompanitë e NQ-së për të përfshirë:

- Monitorimin e furnizimit me karburante (matësit e rrjedhjes);
- Matjen e konsumit të karburanteve (në ngrohtore, preferohet në hyrje të kaldajës);
- Matja e prodhimit të ngrohjes (matësit e ngrohjes në ngrohtore, preferohet në dalje nga kaldaja);
- Kontrolli i furnizimit të ngrohjes, (matësve të ngrohjes dhe valvulave për kontrollin e rrjedhjes në nënstacionet e shkëmbimit të ngrohjes).

- Në mënyrë që të bëhet përcaktimi i njëjtë dhe i drejtë i tarifave për konsumatorët, në planin kohor afat-mesëm, kompanitë e NQ-së duhet të marrin parasysh instalimet e njehsorëve individualë (alokatorët e ngrohjes) në sistemin sekondar të konsumatorëve.

6.2 Legjislacioni në Përgatitje e Sipër

Legjislacioni Primar

Ligji për NQ-të është hartuar në korrik 2004 dhe i është dorëzuar Kuvendit për miratim dhe shpallje. Megjithatë, ai nuk është miratuar ende.

Ligji për NQ-të vendos standardet dhe kushtet për kryerjen e aktiviteteve të prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit të ngrohjes në sektorin e ngrohjes qendrore në Kosovë. Ai gjithashtu vendos kushtet për veprim të ngrohtoreve dhe pajisjeve të tjera relevante.

Qëllimi i këtij Ligji është që të:

- Sigurojë dhe garantojë kushtet për zhvillimin e një tregu të qëndrueshëm të hapur për NQ-të, sipas parimeve të barazisë dhe konkurrencës.
- Garantojë furnizim të sigurt, të besueshëm dhe efikas të ngrohjes, për konsumatorët, mbajtjen e temperaturës së brendshme në një nivel të përshtatshëm gjatë sezonit të ngrohjes, dhe përfundimisht, të sigurojë gjatë gjithë vitit furnizimin me ujë të nxehtë për konsumatorët.
- T'u japë konsumatorëve finalë të drejtën për t'u lidhur me rrjetin e shpërndarjes për një furnizim me ngrohje të një cilësie të specifikuar me çmim të arsyeshëm.

Legjislacioni Sekondar / Rregulloret, Urdhërat, Kodet, Udhëzimet

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRrE është përgjegjëse për hartimin (përgatitjen) dhe nxjerrjen e legjislacionit sekondar. Shumica e rregullave tashmë janë të hartuara. Për sa i përket NQ-ve, disa nga rregullat duhet të zhvillohen ndaraz, ndërsa të tjerët përmbajnë pjesën nga NQ-të.

Rregulloret e Veçanta për NQ

- Rregullorja për Vendosjen e Çmimit dhe Tarifave në Sektorin e NQ-së në Kosovë. Versioni i fundit është bërë në tetor 2004. Ky rregull vendos parimet dhe rregullat për llogaritjen dhe aprovimin e çmimeve dhe tarifave të ngrohjes në tregun e rregulluar të NQ-ve, si vijon:
 - o Llogaritja e çmimeve nga ndërmarrjet e NQ-së;
 - o Modifikimi i çmimeve fillestare të aplikuara nga ndërmarrjet e NQ-së
 - o Aprovimi i strukturës së tarifave; dhe
 - o Mbikëqyrja e aplikimit të çmimeve.

Po ashtu, rregullorja vendos procedurat për të rregulluar si vijon:

- o Çmimet dhe tarifat e ngrohjes së furnizuar tek konsumatorët e lidhur në rrjetin e shpërndarjes;
 - o Çmimet për lidhjen në rrjetin e shpërndarjes.
- Metodologjia e Tarifave në lidhje me tarifat dhe çmimet e ngrohjes, versioni i fundit i hartuar është i tetorit 2004. Metodologjia përcakton rregullat e detajuara për:

- o Formimin dhe llogaritjen e tarifave nga ndërmarrjet e ngrohjes, që prodhojnë, shpërndajnë dhe furnizojnë ngrohjen;
- o Zgjidhjen e llogarive mes ndërmarrjeve të ngrohjes dhe konsumatorëve;

Rregullat e përbashkëta për sektorin e energjisë që po ashtu përfshijnë pjesën e NQ-së:

- Rregullorja për Liçencim të Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Rregullorja për Çkyçje;
- Rregullorja për Procedurën e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Kushtet e Përgjithshme për Furnizimin e Energjisë janë ende në përgatitje dhe do të mbulojnë rrymën dhe NQ-në.

Modeli mostër i Liçencës për Veprim të Ndërmarrjes së NQ-së dhe forma e Aplikacionit për Liçencë për Shërbime të NQ-së, janë hartuar në tetor 2004.

Për kompletimin e kornizës ligjore dhe rregullative të qeverisë me sektorin e NQ-së, siç është përcaktuar me dispozitat e projekt-ligjit për NQ-në, ndërmarrjet e NQ-së duhet të hartojnë dhe nxjerrin dokumentet / kodet teknike si në vijim, që do të aprovohen nga ZRrE-ja:

- Kodin për Mbrojtjen e Konsumatorit, që i përcakton të drejtat dhe detyrimet e furnizuesit dhe konsumatorit në sektorin e NQ-së;
- Kodin e Shpërndarjes, që i përcakton rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ngrohjes;
- Kodin për Pajisje të Ngrohjes, që i vendos standardet për zgjedhjen e pajisjeve në sektorin e ngrohjes qendrore;
- Kodin për Matje, që i përcakton rregullat dhe procedurat në lidhje me matjen, faturimin dhe mbledhjen e pagesave në sektorin e ngrohjes qendrore;
- Kodin për Enët nën Presion, që do të jetë versioni kosovar i rregullores ndërkombëtare për enët nën presion.

6.3 Shqyrtimi (Përcaktimi) i Çmimit për vitin 2004-2005

Përgatitja e ZRrE-së për shqyrtimin e çmimit të NQ-së për sezonin e ngrohjes 2004-2005, ka nisur në fillim të shtatorit 2004, me përgatitjen e udhëzimeve të përkohshme:

- Udhëzimi i Përkohshëm Nr. 01/2004 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Çmimeve dhe Tarifave në Sektorin e NQ-së në Kosovë për Sezonin 2004/2005”, në të cilin janë përcaktuar parimet dhe procedurat për llogaritjen dhe aprovimin e çmimeve dhe tarifave të ngrohjes, në tregun e rregulluar të NQ-së për sezonin e ngrohjes 2004-2005; dhe
- Udhëzimi i Përkohshëm Nr. 02/2004 “Mbi Kushtet dhe Procedurat për Lidhje të Reja në Rrjetin e Shpërndarjes së NQ-së”, në të cilin janë përcaktuar kushtet dhe procedurat për lidhje të reja në rrjetin e shpërndarjes të NQ-së.

Procesi i Shqyrtimit të çmimit, që është paraprirë nga bashkëbisedimi me kompanitë e NQ-së për shpjegime dhe qartësime të mëtejshme të Udhëzimeve, ka filluar me dorëzimin e aplikacioneve ZRrE-së nga kompanitë e NQ-së “Termokos Prishtina” dhe “Ngrohtorja Gjakova”, nga mesi i tetorit 2004, ndërsa “Termomit”, Mitrovicë, ka dështuar në dorëzimin e aplikacionit. Duhet të theksohet se aplikacionet e Termokosit dhe NQ Gjakovës ishin shumë më të kompletuara se sa në vitet e mëparshme dhe përgjithësisht në pajtim me Udhëzimin, me disa defekte dhe gabime që janë eliminuar pas intervenimeve dhe vërejtjeve të ZRrE-së.

Vlerësimi dhe përpunimi i aplikacioneve për tarifa ka rezultuar me një raport gjithëpërfshirës dhe të detajuar, që përmban metodologjinë e aplikuar të tarifave, procesin e shqyrtimit të rregulluar të çmimit dhe kalkulimet e tarifave.

Metodologjia e tarifave që është aplikuar është Norma e Kthimit (NeK) e Rregulluar ose i ashtuquajtur i rregullimi “kosto plus”.

- Shqyrtimi rregullativ i çmimit, ka përfshirë pozicionet që kanë ndikim më të madh në çmimin e ngrohjes siç janë: vlerësimi i objekteve (përcaktimi i Bazës së Rregulluar të Objekteve), dhe përcaktimi i shkallës së amortizimit; trajtimi i mospagesave dhe humbjeve të konsumatorëve që janë të mbuluara përmes subvencioneve qeveritare; verifikimi dhe përcaktimi i koston së lejuar (justifikuar) të veprimit – ZRrE-ja ka miratuar një qasje “nga lart-poshtë”; procesi i aprovimit të investimeve si “të përdorshme-dhe-të dobishme”; aprovimi i kapitalit punues; përcaktimi dhe llogaritja e normës së lejueshme të kthimit, si bazë për vendosjen e përfitimit të arsyeshëm për ndërmarrjet e NQ-së.
- Përllogaritja finale e tarifës është formuluar duke i pjesëtuar të ardhurat e përgjithshme të lejuara, me sasinë e përgjithshme të prodhuar të ngrohjes, por në rastin e Kosovës, kjo në fakt, është shuma e përgjithshme e sipërfaqes (metra katrorë) të pronës që shërbehen (furnizohen me ngrohje) nga Kompanitë e NQ-së. Në fakt, në sektorin e NQ-së në Kosovë, janë 2 grupe të konsumatorëve; banesorë dhe tregtarë, ndërsa kriteri bazë për vendosjen e dy grupeve të tarifave (banesorë dhe tregtarë), është kërkesa/konsumi i ndryshëm i ngrohjes për metër katror. Dy parametrat kryesorë që përcaktojnë kërkesën/konsumin e ngrohjes për secilin grup janë: kapaciteti specifik i nevojshëm dhe orët e ngarkesës së plotë nominale për ngrohje.

Duhet të përmenden disa çështje kryesore që ishin temë e diskutimeve dhe debateve me kompanitë e NQ-së:

- Mosdhënia e subvencioneve për mazut si një kosto e justifikueshme reale e veprimit për kompaninë – ZRrE-ja ndjek parimin se subvencioni nuk mund të shqyrtohet si një kosto reale për kompaninë, prandaj ai nuk mund të përfshihet në koston e lejuar vepruese.
- Meqenëse çmimi i lartë i blerjes së mazutit, ndikon më së shumti në rritjen e çmimit të ngrohjes (65 %), ZRrE-ja ka filluar ta shqyrtojë këtë duke marrë parasysh çmimin e naftës së rëndë në treg.
- Përcaktimi i Bazës Rregullative të Objekteve, ishte gjithashtu një proces i vështirë për shkak të informatave të pasigurta të kontabilitetit rreth vlerës në libra kontabël dhe (ri)-vlerësimit të objekteve.

Bazuar në procesin e lart-përshkruar të shqyrtimit (përcaktimit) të çmimeve, ZRrE-ja përfundimisht vendosi çmimin e ngrohjes për “Termokos Prishtina” dhe “Ngrohtoren Gjakova”, me Vendimin D_01_2004, si në tabelën e mëposhtme:

Section 1 : Shkalla e tarifave për sezonin e ngrohjes 2004-2005

Grupi i Konsumatorit	Kompania NQ “Termokos”	Kompania “Ngrohtorja Gjakova”
Banesor	€ 0.85 / m ² në muaj	€ 0.82 / m ² në muaj
Tregtar	€ 1.10 / m ² në muaj	€ 1.25 / m ² në muaj

Në rastin e “Termomitit”/Mitrovicë, pas dështimit të dorëzimit të aplikacionit, ZRrE-ja ka aplikuar krahasimin “benchmarking” me dy kompanitë e tjera kosovare të NQ-së, dhe gjithashtu ka marrë parasysh kushtet specifike të kompanisë siç janë: madhësia/kapaciteti i saj, numri i konsumatorëve, etj.

Section 2 : Shkalla e tarifave të “TERMOMIT” për sezonin ngrohës 2004/05

Grupi i Konsumatorit	Kompania e NQ-së “Termomit”
Tregtar	€ 1.20 / m ² në muaj

7. Bashkëpunimi Lokal dhe Ndërkombëtar

7.1 Bashkëpunimi Lokal

Duke qenë drejtpërdrejt të përfshirë në çështjet zhvillimore të sektorit të energjisë, ZRrE-ja kryen një rol pro-aktiv në nivel lokal sikurse edhe në atë ndërkombëtar dhe rajonal. Meqë disa nga aktivitetet ndërkombëtare të ZRrE-së janë përmendur në nën-seksionin e mëposhtëm, ZRrE-ja merr një rol pro-aktiv në lidhje dhe bashkëpunimin me trupat administrative të UNMIK-ut edhe të IPVQ-së, si dhe me aktorët e tjerë të sektorit të energjisë në Kosovë. ZRrE-ja bashkëpunon veçanërisht me ministrinë përkatëse (MEM), por gjithashtu edhe me MEF dhe MTI. Si rezultat i bashkëpunimit të mirë me Kuvendin dhe grupet e tij punues, në vitin 2004 u kompletua dhe u lëshua legjislacioni primar i energjisë. ZRrE-ja bashkëpunon gjithashtu me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zgjidhjen e çështjeve të konsumatorëve me gjendje të rëndë sociale.

Për sa i përket UNMIK-ut, ZRrE-ja brenda juridiksionit të saj, bashkëpunon veçanërisht me Shtyllën e IV-t të BE-së dhe me Shtyllën e I-rë, në aspektet e kontribuimit në përsheptimin e zhvillimit ekonomik, përkatësisht procedurave të përshtatshme në gjykata dhe polici. Përfundimisht, departamenti ligjor i ZRrE-së siguron lidhjen me zyrën e OLA-së sa herë që është e nevojshme. Në vitin 2005, një vëmendje e veçantë do t’i kushtohet bashkëpunimit me KPMM-në dhe MAPH-në (IPVQ), në mënyrë që të zhvillohet një procedurë e qëndrueshme e Autorizimit për ndërtimin e centraleve të reja të energjisë – një detyrë që kërkon shumë përkushtim dhe që ka rëndësi të jashtëzakonshme për Kosovën.

Për arsye se të gjitha ndërmarrjet e rregulluara (KEK-u, kompanitë e NQ-së) momentalisht kontrollohen nga AKM-ja, ZRrE-ja zhvillon diskutime të shumta me AKM-në rreth çështjeve të ndryshme profesionale. Për sa i përket bashkëpunimit me KEK-un, ZRrE-ja mban takime të rregullta mujore me një departament të posaçëm në KEK, që është i ngarkuar për bashkëpunim me rregullatorin. Së fundi, siç u përmend më lart, ZRrE-ja është edhe pranues/ përfitues i ndihmës së donatorëve (AER, SIDA, BB, etj.), si dhe anëtar i disa Komiteteve Drejtuese për disa projekte të rëndësishme strategjike, të përkrahur nga donatorët; për shembull: ESTAP II (Puna në linjën prej 400 kV me Shqipërinë) dhe ESTAP III (puna në tarifë, që të dyja BB), Përfshirja e POE-së (AER), e kështu me radhë.

Në vitin 2005, ZRrE-ja planifikon të rrisë bashkëpunimin me OJQ-të relevante, dhe veçanërisht me shoqatat e grupeve të ndryshme për mbrojtjen e konsumatorëve.

7.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar

UNMIK-u në emër të Kosovës, ka nënshkruar Marrëveshjen për Bashkësinë Energjetike (BEn) në Evropën Juglindore (EJL) (ECSEE). Institucionet e UNMIK-ut në Kosovë, kanë marrë pjesë në zhvillimin e Marrëveshjes, dhe ZRrE-ja ka qenë e përfshirë në institucionet dhe forumet e Marrëveshjes BEn; Kryesuesi i ZRrE-së ka marrë pjesë si përfaqësues i ZRrE-UNMIK në SEEER (Rregullatorin e Evropës Jug Lindore), Grupin Punues të CEER (Këshillit të Rregullatorëve Evropianë të Energjisë); stafi i ZRrE-së është i përfshirë në Grupet e ndryshme të Ngarkuara të GP të SEEER. Dy anëtarë të stafit të ZRrE-së, kanë marrë pjesë në mbledhjen e punës të ETSO (Operatorëve Evropianë të Sistemeve të Transmetimit) në Bruksel, si përfaqësues të ZRrE-UNMIK. ZRrE-ja gjithashtu kontribuon në “Procesin e Vjenës” për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, dhe ka një anëtar në grupin punues të “Dialogun për Energji”.

7.3 ZRrE-ja është bërë anëtare Shoqëruese e ERRA-s (Asociacionin e Rregullatorëve Rajonalë të Energjisë)

ERRA është një organizatë vullnetare, e përbërë nga trupat e pavarur të rregullatorëve të energjisë për Evropën Qendrore/Lindore dhe të vendeve të Bashkimit të Shteteve të Pavarura (BSHP). Qëllimi dhe Objektivat e ERRA-s, janë:

- Të përmirësojë rregullimin kombëtar të energjisë në shtetet anëtare;
- Të nxisë zhvillimin e Rregullatorëve të qëndrueshëm të energjisë dhe të kenë autonomi dhe autoritet;
- Të përmirësojë bashkëpunimin mes rregullatorëve të energjisë;
- Të ndihmojë në shkëmbimin e informatave, hulumtimeve, trajnimeve dhe përvojës, mes anëtarëve dhe rregullatorëve të tjerë në mbarë botën.

Më 14 prill 2005, Asambleja e Përgjithshme e ERRA-s (Asociacioni i Rregullatorëve Rajonal të Energjisë), pranoi ZRrE-Kosovën si Anëtar Shoqërues i ERRA-s. ERRA përbëhet nga 22 anëtarë të plotë (Shqipëria, Armenia, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Estonia, Gjeorgjia, Hungaria, Kazakistani, Republika e Kirgizstanit, Letonia, Lituania, Maqedonia, Mongolia, Polonia, Rumania, Federata Ruse, Republika e Sllovakisë, Turqia, Urahina) dhe 5 Anëtarë Shoqërues (Kosova – ZRrE-ja, Rumania - Autoriteti Rregullativ Kombëtar i Rumanisë për Gaz Natyror, Rumania – Autoriteti Rregullativ Kombëtar i Rumanisë për Shërbime Komunalet, Federata Ruse – Asociacioni Ndër-rajonal i Komisioneve të Energjisë i Federatës Ruse, dhe SHBA – Asociacioni Kombëtar i Komisionerëve Rregullatorë të Shërbimeve (NARUC)

7.4 Trajnimi i Stafit dhe Udhëtimet Studimore

Përvoja ka treguar se kontaktet e drejtpërdrejta me rregullatorët e tjerë, sidomos nëse rregullatorët e tillë trajtojnë probleme të ngjashme me ato të ZRrE-së, janë më se të dobishme dhe përfituese për të gjithë anëtarët e stafit.

Gjatë vitit 2004, ZRrE-ja ka marrë pjesë në disa udhëtime studimore. Kjo përvojë, ka qenë e dobishme jo vetëm për shkak të njohurive dhe kuptimit më të mirë të funksionit të rregullatorit, por edhe për shkak të materialit që është siguruar nga Rregullatorët, përfshirë; legjislacionin primar dhe sekondar, Kodet, Raportet dhe të tjera.

Udhëtimi Studimor në Shqipëri (20-23 qershor 2004)

ZRrE-ja ka aranzhuar një udhëtim studimor në Shqipëri. Stafi lokal, me kontrata të Shtyllës së BE-së dhe me kontrata të BKK-së, e kanë shfrytëzuar rastin për të shkëmbyer përvojën me kolegët e tjerë që kanë përvojë dhe praktika të ngjashme rregullative.

Gjatë udhëtimit studimor, stafi i ZRrE-së vizitoi Korporatën Elektro-energjetike Shqiptare (KESH), Operuesin e sapo-themeluar të Sistemit të Transmetimit (OST), dhe Rregullatorin e Energjisë (ERE).

Udhëtimi Studimor i mbajtur në Republikën Çeke (14-21 nëntor 2004)

Dy anëtarë të stafit të ZRrE-së kanë marrë pjesë në një udhëtim studimor 6-ditor, në këto institucione kryesore të sektorit të energjisë në Republikën Çeke:

- ERU, Zyra Rregullative e Energjisë e Republikës Çeke
- ČEPS – OST-ja çeke
- ČEZ – Kompania çeke e rrymës
- OTE – Operatori çek i tregut
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (përgjegjëse për sektorin e energjisë në RÇ)
- SEI – Inspektoriat i Energjisë

Gjatë vizitës në ERU, një diskutim i posaçëm u bë në lidhje me: Licencat, Çmimet dhe Tarifat, procedurat për zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, Kushtet për Furnizim të Energjisë, Cilësinë e Furnizimit, pyetje dhe përgjigje, mësimet e mësuara në lidhje me kushtet e furnizimit të energjisë dhe mospagesën nga konsumatorët në periudhën e para rreth 10 vjetëve, masat e ndërmarra nga Qeveria, etj.

Udhëtimi Studimor në Slloveni (5-12 shtator 2004)

Qëllimi i udhëtimit studimor në Slloveni, ishte takimi me institucionet dhe kompanitë kryesore Sllovene të sektorit të energjisë, me fokus të veçantë në rrymën dhe NQ-në, për të fituar njohuri shitesë, shkëmbyer përvojë dhe për të vendosur raportet bazë për bashkëpunim në të ardhmen.

Udhëtimi studimor mund të ndahet qartë në pjesë ku janë përpunuar sferat në vijim:

- **Institucionale, ligjore dhe rregullative;** vizita dhe takime me drejtoratin e Energjisë së Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe me Agjencinë e Energjisë (rregullatori) ku janë përpunuar: strategjia e energjisë, ligji i energjisë, struktura e sektorit të energjisë dhe zhvillimi i sektorit të energjisë në të ardhmen, si dhe rregullimi i sektorit të energjisë;

- **Hulumtimi & Studimi, Konsultime dhe Projektme;** vizita në Elektro-Institutin “Milan Vidmar” – hulumtim dhe planifikim i sistemit sloven të rrymës, IREET – kompani konsultimi për energji, ambient dhe teknologji, dhe IBE – kompani konsultimi, hartimi & projektimi. Temat e përpunuara: programet hulumtuese për studim në lidhje me sistemet e rrymës, problemet e ekonomisë së rrymës dhe mundësitë për zhvillim të sektorit të rrymës, makro-ristrukturimi i sektorit sloven të energjisë, me një fokus të veçantë në sektorin e rrymës, burimet e ripërtëritshme të energjisë elektike dhe prodhimit të ngrohjes.
- **Prodhimi i energjisë dhe sistemet e shërbimit;** vizita në termocentralin Šoštanj (TEŠ) në Velenje, DEM në Maribor – HC në lumin Drava, TE-TO Lubjana – central për prodhim të rrymës dhe ngrohjes, ELES (OST) – OST-ja slovene, Elektro Celje – Kompania për Shpërndarje të Rrymës, Borzen – Operatori i Tregut të Rrymës, PU Energjetika – shpërndarje dhe furnizim me ngrohje dhe gaz natyror në Lubjanë. Çështjet e përpunuara në lidhje me prodhimin e rrymës dhe ngrohjes, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin / tregtimin e rrymës, shpërndarjen dhe furnizimin e ngrohjes sipas kushteve të reja të hapjes së tregut.

Udhëtimi Studimor në Lituani dhe Suedi (5-12 dhjetor 2004)

Për anëtarët e stafit të ZRrE-së të përfshirë në çështjet e NQ-së, u siguroi një udhëtim studimor një javor, me qëllim kryesor rritjen e njohurisë dhe përfitimin e përvojës në lidhje me sektorin e NQ-së, veçanërisht “qarkullimin rrethor”, për komercializimin e sektorit të NQ-së, që u arrit në Lituani.

8. Raporti Vjetor Financiar i ZRrE-së, Ndarja e Kontributeve nga BKK’04

Siç është theksuar më parë, ZRrE-ja është themeluar në qershor 2004. Për të mundësuar fillimin e aktivitetit të saj, që prej themelimit, Zrre-ja është financuar nga BKK-ja dhe organizatat donatore. ZRrE-ja ende nuk ka nxjerrë ndonjë të ardhur prej veprimtarive të saj normale, si një trup i pavarur rregullativ. Prandaj, aspektet financiare të veprimit të ZRrE-së për vitin 2004 janë paraqitur me një deklaratë për Burimet dhe Aplikimin e Fondeve (Tabela 8.1)

Tabela 8.1: Deklarata për Burimet dhe Aplikimin e Fondeve (2004)

Zyra e Rregullatorit për Energji Burimet dhe Aplikimi i Fondeve <i>Të gjitha Shifrat janë ne EURO</i>	2004 BUXHETI I KK	2004 Aktual
BURIMET E FONDEVE		
Pagesa e Licencave dhe Lejeve	-	-
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës BKK	238,649	124,028
UNMIK (Shtylla e BE-së)	-	147,800
Organizatave Donatore		
USAID	-	102,000
SIDA	-	209,352
KFW	-	210,000
Totali i Organizatave të donatorëve	-	521,352
TOTALI I BURIMEVE TË FONDEVE	238,649	793,180
APLIKIMI I FONDEVE		
Shpenzimet e Stafit		
UNMIK (Shtylla e Be-së)	-	65,300
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës BKK	43,064	15,533
Shpenzimet totale te stafit	43,064	80,833
Mallrat dhe Shërbimet		
UNMIK (Shtylla e Be-së)	-	82,500
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës BKK	146,650	108,495
BKK reduktimi (10%)	(14,665)	-
Organizatave donatore	-	521,352
Totali i Mallrave dhe Shërbimeve	131,985	712,347
Shërbimet Komunale		
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës BKK	4,000	-
BKK reduktimi (10%)	(400)	-
Totali I Shërbimeve Komunale	3,600	-
Shpenzimet e Kapitalit		
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës BKK	60,000	-
Totali i Shpenzimeve Kapitale	60,000	-
TOTALI I APLIKIMIT TË FONDEVE	238,649	793,180
SUFICITI/ (DEFICITI)	-	-

Përkrahja për ZRrE-në nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës 2004 (BKK'04)

Siç u përmend më sipër, totali i aprovuar i BKK'04 për Zrre-në, fillimisht ka qenë 253,714 EURO. Megjithatë, me aplikimin e parimeve të solidaritetit për të kompensuar detyrimet shtesë buxhetore, që ishin pasojë e trazirave të Marsit të vitit 2004 në Kosovë, kjo shumë përfundimisht është ulur me 15,065 EURO. Buxheti përfundimtar në dispozicion ka qenë 238,649 EURO, nga të cilat:

- Paga: 43,064 EURO (18.0%);
- Mallra dhe Shërbime: 131,985 EURO (55.3%), pas buxhetit fillestar prej 146,650 EURO është ulur në 10%;
- Shërbime publike: 3,600 EURO (1.5%), pas shumës fillestare 4,000 EURO është ulur në 10%, dhe
- Shpenzime Kapitale: 60,000 EURO (25.1%).

Ndarja e buxhetit të aprovuar dhe aktualisht të shfrytëzuar BKK'04, është paraqitur në tabelën 8.2. Deri më 31 Dhjetor 2004, ZRRE-ja ka shfrytëzuar në total 124,028 EURO, ose vetëm 52% të buxhetit. Arsyeja kryesore për shfrytëzimin e më pak fondeve të BKK-së seç ishte planifikuar, është përshkruar më poshtë.

Tabela 1: Buxheti i aprovuar dhe i shfrytëzuar i BKK'04 (EURO)

Kategoria e Kostos	E aprovuar	Aktualisht e shfrytëzuar	Diferenca
Shërbimet dhe Mallrat	131,985	108,495	-23,490
Shërbimet Publike	3,600	0	-3,600
Pagat	43,064	15,533	27,531
Shpenzimet kapitale	60,000	0	-60,000
TOTALI	238,649	124,028	-114,621

Pagat

Parashikimi i buxhetit të pagave është bërë në përputhje me supozimin e NJQRR/ZRrE se ligji do të nxirret shumë më herët se sa Qershori i vitit 2004. Miratimi i vonuar i Ligjit, ka parandaluar ZRrE-në të bëjë punësimi më të shpejtë të disa punëtorëve. Pas miratimit të Ligjit, numri i anëtarëve të stafit të ZRrE-së, ka filluar të rritet me shpejtësi.

Në janar 2004, ZRrE-ja ka filluar me 9 anëtarë të stafit: 4 të mbështetur nga BKK-ja, 3 nga shtylla e BE-së/UNMIK dhe 2 këshilltarë nga donatorët:

- (4) pozita të BKK-së: Analist i Strukturës së Tarifave, Ekspert i Ngrohjes Qendrore, Analist i çmimeve dhe shpenzimeve, dhe Analist i Monitorimit të Licencave;
- (3) Pozitat e BE-së-UNMIK: Kryesues i Departamentit të Licencimit dhe Çështjeve Ligjore, Kryesues i Furnizimit me Energji dhe Strukturim të Tregut, dhe Përkthyes; dhe
- (2) pozitat e donatorëve: Ushtruesi i detyrës së Kryesuesit të ZRRE-së (KfW), dhe Këshilltari teknik për Ngrohje Qendrore (Sida).

Me miratimin e Ligjit, ZRrE-ja ka punësuar 4 anëtar të tjerë të stafit: në qershor të 2004 – Zyrtar Financiar, në Korrik 2004 – Zyrtar i Administratës, në Shtator – Zyrtar për Menaxhimin e të Dhënave, dhe në Dhjetor – Analist për Monitorimin e Tregut. Gjithë ky staf i ri ka ardhur në listën e pagave të BKK-së.

Gjithashtu, ZRRE-ja ka filluar që të plotësojë më shumë pozita të stafit të lartë, si kryesuesit e departamenteve dhe ekspertët teknikë. Këto (4) poste janë kontraktuar përmes Shtyllës së BE-së, posaçërisht: Kryesuesi i ZRrE-së (ndërkombëtar) (duke filluar nga Tetori 2004), Eksperti i Sistemit të Energjisë (nga Shtatori), Eksperti për Ngrohje Qendrore (nga Gushti), dhe Kryesuesi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (nga Nëntori). Eksperti i ri për NQ-në, ka zëvendësuar ekspertin e mëparshëm, i cili ka qenë në buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Në Dhjetor të vitit 2004, Kryesuesi i Departamentit të Furnizimit me Energji dhe Strukturë të Tregut, është larguar nga ZRRE-ja. Kështu, totali i numrit të stafit në ZRrE në fund të vitit 2004 ka qenë 15 (pesëmbëdhjetë).

Në janar 2005, numri i të punësuarve në ZRrE është rritur me 18 anëtarë të stafit (9 BKK, 7 nga shtylla e BE-së, 2 nga donatorët), për shkak të shtrirjes së konsiderueshme të punës. Rekrutimet e reja (3) janë mbështetur nga BKK-ja dhe nga Shtylla e BE-së. Këto janë:

- (2) pozitat e BKK-së: Asistent në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Zyrtar i Prokurimit dhe
- (1) Shtylla e BE-së: Kryesues i Zyrës së Administratës.

Që nga fundi i shkurtit 2005, postet vijuese kanë rritur numrin 23 anëtarë të stafit (12 BKK, 9 Shtylla e BE-së, 2 donatorë), ku në procedurë të rekrutimit, janë:

- (3) Pozita nga BKK: Zyrtar për Licencim dhe Jurisprudencë, Asistent për Ekspertin e Sistemit të Energjisë, dhe Sekretar, dhe
- (2) Shtylla e BE-së: Kryesues i Departamentit për Furnizim me Energji dhe Strukturë të Tregut, dhe këshilltar Ekonomiko-Financiar.

Duke e bërë këtë, personeli fillestar i ZRrE-së do të jetë gati i kompletuar. Që nga shkurti 2005, ZRrE-ja ende pret që 2 anëtarë shtesë, të emërohen nga IPVQ-ja dhe të caktohen nga PSSP-ja në Bordin e saj. Të vetmet 2 pozita të lira (shih figurën 2.1) do të mbesin Zëvendës Kryesuesi i ZRRE-së dhe Kryesuesi i Departamentit për çmime dhe Tarifa. Në fazën përfundimtare, numri i plotë i stafit do të jetë 27.

Në vitin 2004, për shkak të stafit të pakompletuar, ZRRE-ja ka shfrytëzuar një buxhet dukshëm më të ulët (15,533 EURO ose vetëm 36%) se sa ai që ishte dhënë nga BKK '04 (43,064 EURO). Shuma e mbetur nuk ka mundur të transferohet në vitin 2005.

Të gjitha pagat e stafit të mbështetura nga BKK-ja në vitin 2004 janë paguar duke ndjekur në mënyrë të saktë rregulloret e aplikueshme për pagimin e punëtorëve civilë, bazuar në koeficient, pavarësisht që stafi i ZRrE-së për shkak të mandatit të veçantë të saj si organizatë e pavarur, nuk mund të krahasohet me statusin e punëtorëve të tillë.

Mallrat dhe Shërbimet

Kjo kategori përfaqëson ndarjen më të madhe të buxhetit të KK-së 04 – 87%. E pasqyruar në bazë të shkallës që paraqet mënyrën e uljes (zvogëlimit) së kategorive kryesore të shpenzimeve, ajo përbëhet nga: pajisjet e TI-së (51,867 EURO), mobilie për zyra (12,765 EURO), mallra dhe shërbime të tjera (9,256 EURO), shpenzimet nga para në dorë (6,760 EURO), trajnime (6,392 EURO), shpenzimet e udhëtimit (5,083 EURO), furnizim për zyra (4,832 EURO), riparimi dhe

mirëmbajtja e automjeteve (4,302 EURO), shpenzimet e shërbimeve arsimore dhe trajnuese (3,446 EURO), karburante (3,137 EURO) si dhe furnizime të tjera (655 EURO). Detyrimet e zhvlerësimit lidhur me pajisjet e TI-së dhe mobilieve për zyra, janë llogaritur në përputhje me Rregulloren Nr. 2002/3 e cila është 9,501 €.

Një ftesë për oferta është lëshuar në Nëntor të vitit 2004 për ofrimin e asistencës teknike për ZrRE-në në sferën e këshillimit ekonomiko-financiar duke u fokusuar në tarifa. Megjithatë, nuk janë marrë më shumë se dy oferta, gjë që nuk ka qenë e mjaftueshme sipas rregullave të Prokurimit Publik, dhe si pasojë tenderi është anuluar. Prandaj, në vitin 2004 ZrRE-ja ka përdorur më pak buxhet (108,495 EURO ose 82%) se sa ai i përcaktuar (131,985 EUR). Shuma e mbetur nuk është transferuar në vitin 2005.

Shërbimet Publike

Në vitin 2004, ZrRE-ja ka operuar nën NJQRR të shtyllës së BE-së, i cili ka mbuluar shpenzimet e shërbimeve publike.

Megjithatë, kjo pjesë e buxhetit të BKK-së për 2004, (3,600 EURO) nuk është shfrytëzuar dhe nuk është transferuar në vitin 2005.

Shpenzimet Kapitale

Meqë ZrRE-ja nuk ka mjete transportuese, shpenzim i planifikuar ka qenë prokurimi i 3 automjeteve për zyrën. Në tetor 2004, është shpallur një tender publik dhe është zgjedhur ofertuesi fitues. Megjithatë, një nga ofertuesit është ankuar, dhe sipas procedurave të Prokurimit Publik, për këtë arsye, tenderi është anuluar. Në kushtet e pamjaftueshmërisë kohore për rishpalljen e tenderit, për këtë qëllim nuk është përdorur asnjë fond i BKK-së i 2004.

Meqë ZrRE-së nuk ka kërkuar sigurimin e automjeteve të reja në kërkesën e buxhetit të vitit 2005, ZrRE-ja ka kërkuar nga MEF, aprovimin e transferimit të 60,000 Eurove në vitin 2005, me qëllim që të përsëritet tenderi.

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Ndërtesa e Bardhë

Rr. Bajram Kelmendi Nr. 75

Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 38 2040 220

Fax: +381 38 2040 222

E-mail: info@ero-ks.org

www.ero-ks.org